



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË

Nr. 3426 prot.

Vlorë, më 20.03 2023

PROJEKT VENDIM

Nr _____ datë, ____ . ____ .2023

**MBI MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË VITIT 2022
(Buxheti i Pavarur, i Pakushtëzuar, Specifik, i Kushtëzuar)**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2023, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 44, neni 64/a, c, ç, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 62, 65, ligjit nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjen Vendore” neni 48, 51, udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit”, udhëzimin nr.22, datë 30.07.2018 “Për Procedurat Standarte të Monitorimit të Buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe udhëzimin plotësues nr.2 datë 19.01.2023 “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2023” pika 116.

V E N D O S I:

1. Të miratojë Buxhetin Faktik të vitit 2022 si më poshtë:
Të ardhura në dispozicion 1,371,535 mijë lekë.
Financuar nga të ardhurat e veta (çelur) Plan 1,210,235 mijë lekë
Fakt 886,334 mijë lekë
Nga këto:
 - a) Investime Plan 280,322 mijë lekë
Fakt 149,914 mijë lekë
 - b) Shpenzime të tjera Plan 929,913 mijë lekë
Fakt 736,420 mijë lekë
2. Të miratojë Buxhetin e Pakushtëzuar të vitit 2022 si më poshtë:
Financuar nga Buxheti i Shtetit Plan 760,265 mijë lekë
Fakt 568,885 mijë lekë
Nga këto:
 - a) Shpenzime të tjera Plan 760,265 mijë lekë
Fakt 568,885 mijë lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË

Nr. 3426 prot.

Vlorë, më 20.03 2023

RELACION

**MBI PROJEKT VENDIMIN PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK
TË VITIT 2022**

Të nderuar Këshilltarë,

Projekt Vendimi që po ju paraqesim për miratim është një analizë e plotë e realizimit të Buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2022. Në tekstin që shoqëron projekt vendimin janë pasqyruar në mënyrë të detajuar gjithë treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve të Bashkisë Vlorë për këtë vit. Megjithatë në këtë relacion po paraqesim një analizë shkurtimisht për treguesit kryesor të këtij buxheti.

Konkretisht nëse analizojmë të ardhurat e veta, ato për këtë vit janë realizuar në masën 1,221,477 mijë lekë ose 87.2% të planit të miratuar në fillim të vitit nga ky këshill. Theksojmë se si në vlerë absolute ashtu edhe në përqindje me planin, realizimi i të ardhurave gjatë vitit 2022 është më i lartë se çdo vit tjetër. Ndërkohë që kemi analizuar një për një burimet e këtyre të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se disa tregues janë realizuar në nivele të ulëta si taksa e biznesit të vogël e cila është realizuar në masën 11%, por kjo taksë i kalon Bashkisë Vlorë nga Drejtoria e Tatimeve. Gjithashtu taksa për ndërtesën është realizuar në masën 77%, taksa e tokës bujqësore në masën 38% etj. Kjo situatë kërkon që në vijim të vlerësohen më me përgjegjësi nga ana e administratës tatimore të Bashkisë.

Tek të ardhurat konstatohet se disa tregues janë realizuar mbi 100% gjë që mund të kërkojë gjithashtu për një vlerësim më të kujdesshëm të planifikimit të tyre si taksa e fjetjes në hotel 102%, taksa e ndikimit në infrastrukturë 102%, taksa e tabelës 162%, tarifa e parkimit 142%, të ardhurat nga T.A.P 331% etj. Për sa i përket të ardhurave nga granti i pakushtëzuar dhe ai sektorial ato planifikohen nga buxheti i shtetit sipas një formule të përcaktuar granti i pakushtëzuar dhe sipas shpenzimeve për programet përkatëse për funksionet e deleguara.

Nëse u referohemi shpenzimeve nga të ardhurat ato janë realizuar në masën 885,933 mijë lekë ose 73%. Këtu kanë ndikuar ndër të tjera miratimi me vonesë i Buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2022 sidomos në mosrealizimin e investimeve.

Po kështu janë pa paguar 108,413 mijë lekë si detyrime të prapambetura të kontabilizuara një pjesë prej 40,981 mijë lekë nga vitit 2021 si energji elektrike etj dhe diferenca nga vitit 2022. Ndërkohë një shumë prej 32,274 mijë lekë janë zbritur nga situacionet e subjektit të kontraktuar për pastrimin e qytetit për periudhën janar-korrik 2022 dhe 99,000 mijë lekë janë situacione të papaguara të po këtij subjekti për mosdakortësim të situacioneve mujore të

punimeve , por që nuk janë kontabilizuar pasi nuk janë pranuar nga Bashkia Vlorë faturat përkatëse të cilat subjekti i ka paraqitur me volume të plota pune shumë e cila në total është 131,274 mijë lekë detyrim.

Po ashtu nuk janë shlyer detyrimet për investimet e planifikuara në vitin 2022, por të papërfunduara si Rruga e Kërkovës, Rruga e Drithasit, shpronësimet e planifikuara ose investime të planifikuara të cilat për arsye të ndryshme nuk u realizuan si rikonstruksioni i pallatit të sportit në vlerën 10,000 mijë lekë, salla e këshillit në vlerën 44,500 mijë lekë, investime në shkollë 9 vjeçare në vlerën 25,000 mijë lekë, në shërbimin zjarrfikës, në shërbimin e pastrimit në NSHP, Bordin e Kullimit etj.

Gjithashtu mosrealizim ka edhe në shpenzimet nga granti i pakushtëzuar ku ndër të tjera nuk u arrit në kohë për shkak të vendimarrjes së vonuar të këshillit fondi për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, fondi për emergjencat civile etj.

Nga sa parashtruam më lart kërkojmë nga këshilli ta miratojë këtë projekt vendim pasi treguesit e cituar nuk mund të ndryshojnë. Kjo edhe për arsye se nga ana e Administratës së Bashkisë fondet të cilat nuk janë përdorur gjatë vitit 2022 do të paraqiten në një projekt vendim tjetër për miratim në Këshillin e Bashkisë me qëllim shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe diferenca do të përdoret kryesisht për investime, shpenzime operative ose paga dhe sigurime shoqërore referuar ndryshimeve të fundit ligjore etj.

Konceptoi: D. Zeraj



KRYETARI

Dritan LELI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

Nr. 3426 Prot

Datë 20.03.2023

Lënda: Raport i montorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën janar – dhjetor 2022

Të nderuar Këshilltarë,

Administrata e Bashkisë në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 44, neni 64/a, c, ç, Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", neni 62, 65, Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 48, 51, Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit", Udhëzimin Nr. 22, datë 30.7.2018 "Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", si dhe udhëzimi plotësues të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr.1, datë 10.01.2022 "Për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2022", pasi ka analizuar treguesit ekonomik dhe financiarë të viti 2022 referuar të ardhurave dhe shpenzimeve bazuar në aktë -rakordimet e Bashkisë dhe të institucioneve në varësi të saj me degën e thesarit Vlorë ka konstatuar se ecuria e zbatimit të buxhetit të vitit 2022 për Bashkinë Vlorë dhe institucionet në varësi në mënyre të përmbledhur është si më poshtë.

Realizimi i të ardhurave vjetore 2022

Bashkia Vlorë dhe në vecanti administrata tatimore vendore është angazhuar qysh në fund të vitit 2021 dhe fillim të vitit 2022, për evidentimin e subjekteve që operojnë në territorin e Bashkisë Vlorë e në vijim për mbledhjen e të ardhurave të vitit kalendarik por edhe atyre të prapambetura, duke zbatuar me korrektësi legjislacionin mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Për realizimin e detyrave funksionale, të përcaktuara prej akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe rregullores së funksionimit të administratës së bashkisë, përmendim si kryesore evidentimin e subjekteve tregtare, regjistrimin deri në shlyerjen e plotë të detyrimeve prej tyre, planifikimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore për çdo subjekt dhe në tërësi, e vjelja e tyre brenda afateve ligjore.

Sjellim në vëmendjen tuaj se viti 2022 krahasimisht me vitet e mëparshme por edhe në raport me planifikimin në këtë vitë realizimi i të ardhurave kishte një rritje të konsiderueshme në arkëtimin e detyrimeve të cdo subjekti, falë një pune më të mirë të administratës tatimore të bashkisë që me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm, arriti në realizimin e taksave dhe tarifave të cilat ndjek kjo drejtori.

Përmbushja e objektivave kryesore të Bashkisë së Vlorës lidhur me politikën dhe administrimin e taksave dhe tarifave vendore të cilat përfshijnë:

1. Forcimi i disiplinës fiskale në zbatimin e drejtë, të ndershëm dhe eficient të procedurave tatimore, si mjet kryesor për reduktimin e mospagesave të detyrimeve tatimore ndaj Bashkisë

2. Krijimi i sistemeve dhe rrjeteve të informacionit dhe ofrimi i shërbimeve ndaj taksapaguesve nëpërmjet teknologjisë së informacionit, si dhe të shërbimit në një sportel. Informatizimi dhe lidhja në një rrjet të vetëm i të gjithë informacionit brenda territorit të Vlorës (Struktura të Bashkisë, Njësitë e Bashkisë, Bankat e nivelit të dytë etj.)

3. Vendosja dhe zbatimimi i rregullave transparente në rekrutimin, karrierën dhe zbatimin e masave disiplinore për punonjësit në përputhje me rregullat bazë të Shërbimit Civil.

4. Edukimi fiskal i publikut dhe forcimi i marrëdhënieve me publikun taksapagues për rritjen e besueshmërisë ndaj administratës fiskale dhe zbatimin vullnetar të legjislacionit tatimor. Për këtë do të iniciohen programe edukative si dhe do të prodhohen guida dhe materiale të tjera informative.

Drejtorja e të Ardhurave Vendore punën e ka të organizuar në sektorë, sipas vendimeve të Kryetarit të Bashkisë Vlorë “Për strukturën organizative të bashkisë Vlorë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2022”, ku cdo specialist dhe inspektor ka ushtruar funksionet e tij në zbatim të akteve ligjore, nënligjore, rregullores, planeve mujore të punës apo urdhërave të kryetarit të bashkisë si dhe eprorit direkt, drejtorit të drejtorisë. Për vitin 2022, po paraqesim sipas sektorëve analizën e punës si më poshtë:

Spektori i kontrollit në terren:

Ky sektor, është një ndër sektorët më të rëndësishëm të drejtorisë në përmbushjen e objektivave dhe qëllimeve të saj, ku cdo inspektor i terrenit së bashku me inspektorët e taksës së pasurisë janë angazhuar për verifikimin, evidentimin dhe rregjistrimin e subjekteve fizik dhe juridik, që operojnë në territorin e Bashkisë Vlorë. Sikurse në cdo fund viti nga ana e tyre janë hartuar rregjistrat gjeografik për cdo rajon dhe njësi administrative për të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari tregëtare në territorin e Bashkisë Vlorë me qëllim vlerësimin tatimor për vitin fiskal. Përveç rregjistrat vjetor gjatë kësaj periudhe, janë ndjekur në terren subjektet e rinj, subjektet që aplikojnë për rregjistrim, pezullim apo riaktivizim, kjo sipas shkresave dhe emaileve për cdo muaj, të ardhura nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Po ashtu nga ana e inspektorëve ndiqet ecuria e subjekteve në rastet e ndryshimit të vendndodhjes së aktivitetit të tyre, hapjes së adresave dytësore, saktësim të sipërfaqeve të objekteve ku ushtrohet aktiviteti, plotësimin me dokumentacionin e nevojshëm në rastet kur mungojnë për vlerësimin tatimor, identifikimi i subjekteve që shfrytëzojnë hapësirë publike dhe ndjekjen e procedurës deri në njoftimin për pagesë të të gjithë zërave që ndiqen dhe arkëtohen nga DAV.

Specialistët e Sektorit të Pranimit dhe Përpunimit të të Dhënave,

Ky sektor është i përbërë nga specialist pranimit për cdo rajon, një specialiste për njësinë Orikum dhe një specialiste për njësitë e tjera administrative dhe subjektet e transportit, ku secili prej tyre kryen vlerësimin tatimor për subjektet taksapagues që ushtrojnë veprimtari tregëtare në territorin e bashkisë Vlorë, në varësi të ndarjes që ka cdo specialist. Sikurse jeni në dijeni, në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore prej disa vitesh është implementuar sistemi TAIS, ku në zbatim V.K.B-së nr. 79, datë 02.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë”, vlerësimi tatimor bëhet në bazë të nivelit të taksave dhe tarifave vendore si dhe afateve të miratuara. Nga ana e specialistëve të pranimit me qëllim njoftimin në kohë të detyrimeve tatimore për cdo subjekt, është mbajtur në vëmendje afatet ligjore (data 20 prill) për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet tregëtar në territorin e bashkisë Vlorë dhe afatet për subjektet e rinj të aktivizuara mbas datës 20 prill, 20 korrik dhe datës 20 shtator apo dhe subjekte që dorëzojnë dokumentacionin në vonesë.

Për subjektet të cilat kanë dorëzuar rregjistrin e fjetjes në hotel brenda datës 5 të muajit pasardhës, vlerësimi për taksën e fjetjes në hotel është bërë sipas përcaktimit të ligjit dhe vendimit të Këshillit të Bashkisë.

Gjithashtu vlerësimi tatimor për subjektet që operojnë në fushën e hoteleri turizmit dhe nuk dorëzojnë rregjistrin e fjetjes në hotel, afati i pagesës së detyrimit ishte data 20 gusht 2022.

Nga ana e cdo specialisti janë njoftuar me email dhe shkresë zyrtare subjektet, të cilët duhet të depozitojnë dokumentacionet në lidhje me vijimin e procedurës së vlerësimit tatimor për detyrimet e vitit 2022, përveç se ky njoftim kryhet edhe nga inspektorët e terrenit. Administrata e tatimeve të bashkisë, në shumë raste ka hasur vështirësi në marrjen e dokumentacionit të pronësisë për subjekte të ndryshme dhe kjo ka vështirësuar punën e specialisteve të pranimit për të kryer vlerësimin tatimor brenda afateve që ka përcaktuar ligji, por në cdo kohë që kryhet vlerësimi tatimor, periudha përket me momentin e hapjes së aktivitetit tregëtar dhe ky detyrim i vlerësuar me vonesë shkakton edhe gjenerimin e kamatvonesës në momentin që kryhet pagesa në bankë e detyrimit.

Sjellim në vëmendjen tuaj se gjatë kësaj periudhe të vitit 2022 ka patur aplikime në Q.K.B për ndryshime të statusit të disa subjekteve si: pezullime, riaktivizime apo rregjistrime. Ky informacion sipas shkresave të ardhura nga Q.K.B-ja, paraqitet në tabelën si më poshtë:

<i>Rajoni/njesia administrative</i>	<i>Çregjistrime</i>			<i>Pezullime</i>			<i>Riaktivizime</i>			<i>Total</i>
<i>Statusi</i>	<i>Fizik</i>	<i>Juridik</i>	<i>Total</i>	<i>Fizik</i>	<i>Juridik</i>	<i>Total</i>	<i>Fizik</i>	<i>Juridik</i>	<i>Total</i>	<i>Aplikime total</i>
Rajoni 1	25	0	25	29	9	38	10	2	12	75
Rajoni 2	80	3	83	124	23	147	96	8	104	334
Rajoni 3	100	1	101	97	31	128	41	9	50	279
Rajoni 4	31	0	31	48	9	57	30	3	33	121
Rajoni 5	56	1	57	42	12	54	25	5	30	141
Shushice	6	0	6	9	1	10	4	2	6	22
Novosele	14	0	14	15	6	21	6	2	8	43
Qender	3	0	3	26	3	29	26	3	29	61
Orikum	18	1	19	99	7	106	77	5	82	207
Transport	22	0	22	39	1	40	25	1	26	88
Total	355	6	361	528	102	630	340	40	380	1371

Sipas rakordimit me Degën e Thesarit Vlorë, arkëtimet për taksat dhe tarifatat e ndjekura nga DAV për zërat janë si më poshtë:

Totali i arkëtimeve për vitin 2022 të cilat ndjek DAV janë në vlerën 386,828 mijë lekë.


Te ardhurat vjetore të realizuara gjithësej per vitin 2022, të cilat ndiqen nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, janë në vlerën **386.828 mijë lekë**, kundrejt planit prej **345,312 mijë lekë**, duke përjashtuar taksën e pasurisë dhe tarifën e pastrimit-gjelbërimit që faturohen dhe arkëtohen tek Ujësjiellës-Kanalizime sh.a për kategorinë familje.

Realizimi i të ardhurave për taksat dhe tarifatat që ndjekin strukturat e DAV-së pa përfshirë Agjentët Tatimorë dhe drejtoritë e tjera në bashki është si më poshtë:

Nr.	EMERTIMI	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2022	Fakt 2022	Realizimi vjetor
I	Te ardhura nga taksat vendore	83,018	119,715	147,114	138,034	
1	Takse pasurie e paluajtshme ndërtesa biznes	60,980	80,879	105,000	89,015	85
2	Takse trualli	11,156	12,212	12,371	12,202	99
3	Takse e fjetjes ne hotel	5,469	14,915	18,743	19,033	102
4	Takse table + reklame	5,413	11,709	11,000	17,784	162
II	Te ardhurat nga tarifatat vendore	146,101	230,807	198,198	248,794	126
1	Tarife për zënien e hapësirave publike					
2	Tarife tregu	2,423	2,686	5,640	6,640	118
3	Tarife e zënies se hapësirave publike biznes	14,016	48,002	42,779	55,792	130
4	Tarife vjetore për pastrimin urban+ndriçim+gjelbërim	69,319	86,343	84,779	103,152	122
5	Tarife për leje dhe shërbim veterinar	19	220	0	0	0
6	Te ardhura nga zeri debi	60,324	93,556	65,000	83,210	128
7	Biletat e anijeve turistike		81	0	0	0
IV	TOTALI I TE ARDHURAVE (Taksa Tarifa)	229,119	350,522	345,312	386,828	112%

Grafikisht situata e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore të cilat ndiqen nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore për tre vitet e fundit paraqitet si më poshtë:

REALIZIMI / PLANIFIKIMIT 2022



Realizimi i të ardhurave (taksa dhe tarifa të DAV) për vitin 2022, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar është **36.306 mije lekë me tepër** dhe krahasuar me planifikimin e vitit 2022 është **112%**. Gjithashtu në totalin e të ardhurave të realizuara dhe të ndjekura nga DAV kemi një tejkalim në vlerën prej **41.516 mijë lekë**, kundrejt planifikimit vjetor 2022.

Të ardhurat e paraqitura në tabelën më lart, janë ndjekur duke zbatuar V.K.B-në 79, datë 02.12.2021, në të cilën janë miratuar strukturat të cilat ngarkohen për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore si dhe niveli i taksave dhe tarifave, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 4, dt. 31.01.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2022”, të ndryshuar si dhe aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Vlorë për periudhën janar – dhjetor 2022.


Në kreun I – Taksat vendore:

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme:

Kjo taksë për kategorinë biznese arkëtohet nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, kurse për ndërtesat e banimit nga Ujësjellës Kanalizime sh.a, ku ky institucion në cilësinë e agentit tatimor do të përfitojë 3% të shumës së arkëtuar. Përsa i përket arkëtimeve të taksës së ndërtesës për kategorinë familje, në bazë të rakordimit me Degën e Thesarit Vlorë dhe ndërmarrjes së Ujësjellës Kanalizime sh.a, situata për vitin 2022 paraqitet si më poshtë:

000/lekë

Emërtimi taksës		Plan 2022	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Realizimi vjetor %
Takse pasurise se paluajtshme ndërtesa	Subjekte	105,000	60,980	80,879	89,015	85%
	Familje	145,732	55,665	110,539	103,741	71%
Totali		250,732	116,645	191,418	192,756	77%



Taksa e ndërtesës për kategorinë familje, e cila faturohet dhe arkëtohet nga ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizime sh.a, sipas të dhënave të dërguara, nga ky institucion për periudhën janar – dhjetor 2022 dhe rakordimeve me Degën e Thesarit Vlorë, janë derdhur për llogari të bashkisë Vlorë taksë ndërtesë vlera prej **103.741 mijë lekë**, duke u mbajtur 3% e vlerës së arkëtuar nga U.K në cilësinë e agjentit tatimor, sipas V.K.B-së nr. 79, datë 02.12.2021.

Viti 2022	100% Arketim lekë	97% Arketim lekë	Likujduar Bashkise lekë	Diferenca lekë
Taksë ndërtesë	107,345,721	104,125,346	103,741,811	383,535

Gjatë vitit 2022, në llogari të bashkisë Vlorë përveç arkëtimeve të bëra për vitin 2022, janë likujduar edhe detyrime të prapambetura në vlerën 3.000.000 lekë.


Nga taksa e ndërtesës për vitin 2022 kanë mbetur pa u kaluar në llogari të bashkisë Vlorë vlera prej 383.535 lekë, e cila kalon në vitin 2023.

Taksa mbi tokën bujqësore

Kjo taksë sipas përcaktimeve të V.K.B-së arkëtohet në bazë të informacionit të dhënë nga njësitë administrative dhe DPPMA për njësinë Vlorë. Për vitin 2022 kjo taksë ka realizimin sipas tabelës së mëposhtme:

000/lekë

<i>Emërtimi taksës</i>	<i>Plan 2022</i>	<i>Fakt 2020</i>	<i>Fakt 2021</i>	<i>Fakt 2022</i>	<i>Realizimi vjetor %</i>
Taksë e tokës bujqësore	38,758	13,175	13,562	14,819	38%



Realizimi i kësaj takse është në masën 38% krahasuar me planin vjetor të vitit 2022 dhe kemi një rritje të arkëimit nga viti 2021 në vlerën 6%.


Taksa mbi truallin

Kjo taksë përfshin sipërfaqen e truallit që nuk përfshihet nën objektin ku zhvillohet aktiviteti. Për vitin 2022 kjo taksë ka realizimin sipas tabelës së mëposhtme:

000/lekë

<i>Emërtimi taksës</i>	<i>Plan 2022</i>	<i>Fakt 2020</i>	<i>Fakt 2021</i>	<i>Fakt 2022</i>	<i>Realizimi vjetor %</i>
Taksë trualli	12,371	11,156	12,213	12,202	99%

Taksë trualli



Realizimi i kësaj takse është në masën 99% në krahasim me planin vjetor të vitit 2022.

Taksa e fjetjes në hotel:


Sipas nivelit të kësaj takse miratuar me VKB-në nr.79 datë 02.12.2021 nga ana e DAV janë respektuar procedurat për arkëtimin e kësaj takse, e cila konsiston në përlogaritjen e kësaj takse në bazë të rregjistrave të dorëzuar nga vetë subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hotelerisë, ku numri i deklarimeve apo dorëzimit të këtyre rregjistrave ka qenë shumë i vogël.

Nisur nga kjo, administrata tatimore vendore ka zbatuar më tej pikën b) të vlerësimit të subjekteve për këtë taksë, ku janë kategorizuar bizneset në ato sezonal dhe vjetor sipas veprimeve të kryera nga bizneset të Q.K.B.

Për vitin 2022 kjo taksë ka realizimin sipas tabelës së mëposhtme:

000/lekë

<i>Emërtimi taksës</i>	<i>Plan 2022</i>	<i>Fakt 2020</i>	<i>Fakt 2021</i>	<i>Fakt 2022</i>	<i>Realizimi vjetor %</i>
Taksa e fjetjes në hotel	18,743	5,469	14,915	19,033	102%




Realizimi i kësaj takse është në masën 102 % krahasuar me planin vjetor të vitit 2022.

Taksa e tabelës dhe reklamës:

Kjo taksë vlerësohet sipas niveleve të përcaktuara në VKB nr. 79/2021 dhe për vitin 2022, realizimi i saj është si më poshtë:

000/lekë

<i>Emërtimi taksës</i>	<i>Plan 2022</i>	<i>Fakt 2020</i>	<i>Fakt 2021</i>	<i>Fakt 2022</i>	<i>Realizimi vjetor %</i>
Taksa e tabelës dhe reklamës	11,000	5,413	11,709	17,784	162 %



Realizimi i kësaj takse për vitin 2022, është në masën 162 % krahasuar me planin vjetor të vitit 2022.


II. Tarifat vendore:

Tarifa për zënie e hapësirës publike:

Në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, aplikimi i kësaj tarife ndiqet për hapësirat publike të cilat përdoren për qëllime biznesi realizimi i saj është si më poshtë.

000/lekë

Emërtimi tarifës	Plan 2022	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Realizimi vjetor %
Tarifa e zënies së hapësirës publike në zona të tjera të bashkisë + hapësira e tregjeve	48,419	16,439	50,688	62,432	129 %



- Tarifa e shërbimit të ndricimit, pastrimit dhe gjelbërimit:

Kjo tarifë për kategorinë biznese arkëtohet nga DAV, kurse për kategorinë familje nga Ujësjetllës Kanalizme sh.a, ku ky institucion në cilësinë e agentit tatimor do të përfitojë 3% të shumës së arkëtuar. Përsa i përket arkëtimit të taksës së ndërtesës për kategorinë familje, në bazë të rakordimit me Degën e Thesarit Vlorë dhe ndërmarrjes së Ujësjetllës Kanalizme sh.a, situata për vitin 2022 paraqitet si më poshtë:


000 leke

Emërtimi tarifës		Plan 2022	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Realizimi vjetor %
Tarifa e shërbimit të ndricimit, pastrimit dhe gjelbërimit	Subjekte	84,779	69,319	86,343	103,152	122 %
	Familje	150,506	38,437	99,937	104,961	70%

Totali	235,285	107,756	186,280	208,113	88%
---------------	----------------	----------------	----------------	----------------	------------

Realizimi i kësaj tarife përfshirë familjet dhe bizneset është në masën 88% krahasuar me planin vjetor të vitit 2022, kurse vetëm kategoria biznese e cila ndiqet nga DAV është realizuar në masën 122 % krahasuar me planin e vitit 2022.

Tarifa e pastrimit, ndricim, gjelberim



Tarifa e pastrimit për kategorinë familje, e cila faturohet dhe arkëtohet nga ndërmarrja e Ujësjetës Kanalizime sh.a, sipas të dhënave të dërguara, nga ky institucion për periudhën janar – dhjetor 2022 dhe rakordimeve me Degën e Thesarit Vlorë, janë derdhur për llogari të bashkisë Vlorë tarifë pastrim, ndricim, gjelbërim vlera prej **104.961 mijë lekë**, duke u mbajtur 3% e vlerës së arkëtuar nga U.K në cilësinë e agentit tatimor, sipas V.K.B-së nr. 79, datë 02.12.2021.

Viti 2022	100% Arketim lekë	97% Arketim lekë	Likujduar Bashkise lekë	Diferenca lekë
Tarifë pastrimi	108,929,698	105,661,801	104,960,520	701,281

Nga tarifa e pastrimit, për vitin 2022 kanë mbetur pa u kaluar në llogari të bashkisë Vlorë vlera prej 701.281 lekë, e cila kalon në vitin 2023.

Një sektor mjaft i rëndësishëm në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore është edhe sektori i borxhit.

Analiza e punës së këtij sektori për vitin 2022 paraqitet si më poshtë:

1.Kryerja e plotë dhe me rigorozitet e të gjithë praktikës ligjorë për mbledhjen me forcë të detyrimeve të prapambetura, sic janë: Njoftimet per pagese vullnetare dhe vendosje te masave siguroese për tatimpaguesit debitorë, sekuestrot konservative ne Banke dhe masat shtrënguese ndaj titujve te pronesise ne Qkb.

2.Ndjekja nga ana e jonë e ecurisë mbi zbatimin e këtyre masave shtrënguese prej institucioneve të tilla si:Banka, Qkb, që ligji i ngarkon me detyrim.

3.Rritja e bashkëpunimit me keto institucione ligjzbatuese të përmëndura më sipër,me qëllim marrjen e informacioneve ne kohë, të plota dhe transparente mbi posedimin e kapitaleve monetare (gj.llog.bankare), fizike (ndërtesa,tokë,automjete) si dhe ato të letrave me vlere (aksione,obligacione) e që per pasojë sjellë rritjen e efektivitetit në zbatimin e ketyre masave e si rrjedhim, rritjen e të ardhurave nga mbledhja e borxhit.

Realizimin e planit vjetor të të ardhurave në mbledhjen e borxhit tatimor për vitin 2022.

Paraqitur në tabelë: Debia e mbetur dhe nr. debitorëve deri më 31 Dhjetor 2021.

	DEBIA E MBETUR DERI MË 31.12.2021	NR. DEBITORËVE
BASHKIA VLOREË	398,953,004.8	6190

Gjatë ketij viti puna e këtij sektori ka konsistuar në ndjekjen kronologjike të disa hapave te rëndësishëm për të qënë efektive në synimet dhe objektivat tanë, sic janë:

I - Përpilimi dhe dërgimi i njoftim dhe kerkese per pagese tatimpaguesve debitorë.

N	NJOFTIME TATIMPAGUESVE	NR. NJOFTIMEVE
1	NJOFTIM DHE KËRKESË PËR PAGESË TË DEBISË	1587
2	NJOFTIM PER VENDOSJE TE BARREVE SIGURUESE	630
	TOTALI NJOFTIMEVE TATIMPAGUESVE	2217

II – Përpilimi dhe rivendosja e masave shtrënguese ndaj tatimpaguesve debitorë qe nuk kane kryer pagesa,pas procedurave te kryera sic jane : njoftime per pagese dhe njoftime per vendosje te masave shtrenguese.tatimpaguesve.

a.Urdhër Riblokimi në Bankë mbi llogaritë bankare si të biznesit dhe ato personale

b.Vendosje Barre Siguruese ndaj titujve (Nipt, aksione, obligacione), në Qkb

Paraqitur në tabelë

	MASA SHTRËNGUESE NDAJ TATIMPAGUESVE	NR. BLOKIMEVE
1	BLOKIME TE LLOGARIVE BANKARE	1025
4	VENDOSJE TE BARRËS NDAJ TITUJVE NE QKB	630
	TOTALI BLOKIMEVE	1655

III – Përpilimi dhe vendosja masave ekzekutuese

Urdhër Ekzekutimi: Kalim shume nga llog. e tatimpaguesit në llogarinë e Bashkise.

Paraqitur në tabelën e mëposhtëme:

MASA EKZEKUTUESE	NR. EKZEKUTIMEVE
URDHRA EKZEKUTIMI	314

IV – Përpilimi dhe heqja e masave shtrënguese ndaj tatimpaguesve debitorë.

a.Urdhër Zhllokimi në Bankë mbi llogaritë bankare si të biznesit dhe ato personale

b.Heqje Barre Hipotekore mbi pasuritë e paluajtshme, në Ashk

c.Heqje Barrë Siguruese mbi pasuritë e luajtshme ,në Ksha (me vone ne Rbs).

D.Heqje Barrë Siguruese ndaj titujve në Qkb

Paraqitur në tabelë

	HEQJA E MASAVE SHTRËNGUESE TATIMPAGUESVE	NR. BLOKIMEVE
1	ZHBLLOKIME TË LLOGARIVE BANKE	507
2	HEQJE TE BARRËS HIPOTEKORE ASHK	59
3	HEQJE TE BARRËS SIGURUESE KSHA	62
4	HEQJE TE BARRËS NDAJ TITUJVE QKB	135
	TOTALI HEQJES SË MASAVE SHTRËNGUESE	763

V -- Nga ndjekja e plotë e procedurave ligjore (hapat: I, II, III), në praktikën tonë të përditshme të punës kemi arritur këto rezultate, të cilat do i shprehim përmes tabelave të mëposhtëme:

❖ Mjetet ligjore të aplikuara në mbledhjen e borxhit per vitin 2022

Paraqitur në tabelën e meposhtëme: Shkalla e ndikimit, prej aplikimit të mjeteve ligjore në realizimin e të ardhurave nga mbledhja e borxhit.

PERMES APLIKIMIT	BORXHI MBLEDHUR	
NR	TE MJETEVE LIGJORË	NË LEK
1	NJOFTIME PËR PAGESË	17.723.000
2	MASA BLOKUESE	58.623.000
3	MASA EKZEKUTUESE	6.864.000
	TOTALI MBLEDHUR	83.210.000

❖ Për Borxhin e mbledhur gjatë vitit 2022

Paraqitur në tabelën e mëposhtme: Plan-Fakt dhe realizimi i saj në përqindje %.


PLANI VJETOR	FAKTI	REALIZIMI NE %	PLANI VJETOR
65.000.000	83.210.000	128 %	

NR.DEBITOREVE 31.12.2011 - 31.12.2021	NR.DEBITOREVE TE PAGUAR
6190	1718

Krahasuar me vitet e mëparshme gjendja në fund të cdo viti e vlerës së debisë, paraqitet si më poshtë:

Debia sipas viteve	Nr.i subjekteve	Vlera	% rritjes se vlerese se debise	Rritja e vleres se debise ne lek
Debia deri 31.12.2017	2870	243,548,445.00		
Debia deri 31.12.2018	4458	287,771,902.00	18.16%	44,223,457.00
Debia deri 31.12.2019	4783	324,901,227.00	12.90%	37,129,325.00
Debia deri 31.12.2020	5502	376,837,174.00	15.99%	51,935,947.00
Debia deri 31.12.2021	6190	398,953,005.00	5.50%	22,657,991.00
Debia deri 31.12.2022	6326	403,655,427.00	1.18%	4,702,422.00

DEBIA NE VITE



PËRSA I PËRKET REALIZIMIT TË TË ARDHURAVE QË ARKËTOHEN PËR BASHKINË VLORË, JEPEN NË TË DHËNAT E MËPOSHTME:

Nr.	EMERTIMI	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2022	Fakt 2022	Realizimi %
I	Te ardhura nga taksat vendore					
1	Takse për kalimin e drejtës së pronësisë	29,159	27,905	30,000	30,438	101%
2	Takse e automjeteve të përdorura	65,964	70,475	75,600	76,413	101%
3	Taksa e biznesit të vogël (Tatim i Thjeshtuar)	13,321	12,137	18,000	2,001	11%
4	Takse e pasurisë së paluajtshme (ndërtesat+toka)					
4.1	Takse pasurie e paluajtshme ndërtesa	116,645	191,418	250,732	192,756	77%
4.2	Takse pasurie e paluajtshme toke bujqësore	13,175	13,562	38,758	14,819	38%
5	Takse trualli	11,156	12,212	12,371	12,202	99%
6	Takse e fjetjes në hotel	5,469	14,915	18,743	19,033	102%
7	Taksa e ndikimit në infrastrukture	205,336	180,941	298,853	365,121	122%
8	Takse table + reklame	5,413	11,709	11,000	17,803	162%
9	Takse parkimi	1,339	2,038	1,900	2,689	142%
10	Taksa mbi të ardhurat Personale	24,270	32,133	11,000	36,416	331%
II	Te ardhurat nga tarifët vendore					
1	Tarifë për zënie e hapësirave publike					
1.1	Tarifë tregu	6,541	7,659	5,640	6,640	118%

1.2	Tarife e zënies se hapësirave publike	38,090	75,299	78,996	94,529	120%
2	Tarife vjetore për pastrimin urban+ndriçim+gjelbërim	107,756	186,280	235,284	208,113	88%
3	Tarife shërbimi për subjektet me aktivitet ndërtimi		7,621	14,164	9,355	66%
4	Tarife për leje dhe shërbim veterinar	19	220	-	-	0%
5	Tarife për shërbime te tjera nga pushteti vendor	3,764	10,968	5,033	10,186	113%
6	Tarife për leje dhe certifikata transporti	3,933	5,693	8,520	12,123	142%
7	Tarifa e Ujitjes			3,983	-	0%
III	Te ardhura te tjera					
1	Te ardhura nga qiratë (mjete+godine+toke)	2,439	1,730	41,325	3,264	17%
2	Te ardhura nga aplikimi i gjobave dhe debitorë	70,331	100,077	148,300	92,365	62%
3	Te ardhura nga kopshtet, çerdhet dhe shkollat	7,796	11,397	20,826	13,560	65%
4	Te ardhura nga institucionet vartëse					0%
4.1	Te ardhura nga teatri "Petro Marko"	375	351	550	403	73%
4.2	Te ardhura nga Qendra Kulturore	876	659	1,550	1,030	66%
4.3	Te ardhura nga Shumesportet			595	0	0%
4.4	Te ardhura nga ndërmarrja Shërbimeve Publike			300	0	0%
4.5	Te ardhura nga pullat		365	700	218	31%
5	Projekte	6,532		67,225		0%
6	Mjete ne ruajtje					
IV	TOTALI TE ARDHURAVE (Taksa Tarifa)	739,699	977,764	1,399,948	1,221,477	87.2%

- AGJENTËT TATIMORË JANË:

Agjencia e Kadastrës Shtetërore
Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Vlorë
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë
Ujësjiellës Kanalizime SH.A

Në bazë të të dhënave të rakorduara me Degën e Thesarit Vlorë për të ardhurat që ndiqen nga agjentët tatimorë por edhe drejtoritë e bashkisë Vlorë që realizojnë të ardhura, realizimi i tyre është si më poshtë:

-taksa për kalimin e të drejtës së pronësisë

Kjo taksë ku në cilësinë e agjentit tatimor është Agjencia Shtetërore e Kadastrës Vlorë, për vitin 2022 është realizuar në masën 101% kundrejt planit të vitit 2021 dhe në vlerë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë është 2,533 mijë lekë më pak.

-taksa e automjeteve të përdorura

Kjo taksë në cilësinë e agjentit tatimor arkëtohet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Vlorë ku për vitin 2022 është realizuar në masën 101% dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë është arkëtuar 5,938 mijë lekë më shumë.

-taksa e biznesit të vogël

Kjo taksë arkëtohet nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve dhe është realizuar në 11% kundrejt planit të vitit 2021 dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm janë arkëtuar 10,136 mijë lekë më pak. Ndërkohë për sa i përket T.A.P që gjithashtu arkëtohet nga i njëjti agjent tatimor ka një realizim në shumën 36,416 mijë leke ose 25,416 mijë leke me shume nga plani.këto diferenca të konstatuara kërkojnë qe gjate planifikimit të buxhetit në të ardhmen të jenë objekt i një vlerësimi më të drejtë.

- DREJTORITË QE NDJEKIN TË ARDHURA NË BASHKINË VLORE

-taksa e ndikimit në infrastrukturë:

Ndjekjen e kësaj takse e bën Drejtoria e Urbanistikës e cila e ka realizuar % krahasuar me planin e vitit 2022, kurse në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë ka realizuar të ardhura më pak në vlerën 24,395 mijë lekë.

Nr	Emërtimi	Plani Viti 2022	Fakti viti 2022	Realizimi %
1	Taksë ndikimit infr.	298,853	365,121	122%
2	Tarifë shërbimi	14,164	9,355	66%

Përsa i përket taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe tarifës së shërbimit për subjektet me aktivitet ndërtimi parashikimi është bazuar në disa investime strategjike të cilat miratohen në AZHT pasi taksa e ndikimit në infrastrukturë paguhet në llogarinë e Bashkisë Vlorë.

Parashikimi është bazuar edhe sipas eksperiencës në vitet e mëparëshme për lejet e ndërtimit nga subjekte private

-tarifa e hapësirës publike, e cila ndiqet nga DPPMA

Ka arkëtuar të ardhurat nga shfrytëzimi i hapësirave publike si stacione plazhi nga subjektet private mbas miratimit në parim që marrin nga GTSHA pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Në lidhje me nivelin e të ardhurave për vitin 2022 janë arkëtuar 338,537,276 lekë ndërkohë që parashikimi për vitin 2022 në paketën fiskale për të ardhurat që do të arkëtuara nga shfrytëzimi i hapësirës publike plazh ishte 33,841,700.

-taksë parkimi dhe tarifë leje transporti

Kjo taksë dhe tarifë ndiqet nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike dhe për vitin 2022 është arkëtuar si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Plani Viti 2022	Fakti viti 2022	Realizimi %
1	Taksë Parkimi	1,900	2,689	142%
2	Tarifë leje transporti	8,520	12,123	142%

Përsa i përket taksës së parkimit kemi një realizim të planit 141%, kjo si rrjedhojë e rritjes së kërkesave të bizneseve për të marrë parkime me pagesë para bizneseve të tyre fakt ky që duhet të vlerësohet në planifikimin e buxhetit në të ardhmen, për të bërë një planifikim korrekt.E njëjta gjë vlen edhe në rastin e tarifës për leje trasporti realizimi i së cilës është në masën 142%.

Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit

Bazuar në ligjin nr. 68/2017, dt.27.04.2017 “Për financimet e vetëqeverisjes vendore”, kreu II, neni 7, si dhe të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, V.B.K.-në Nr. 4, datë 31.01.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 20229” i ndryshuar, Udhëzimi plotësues nr. 1, dt. 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, Drejtoria e Menaxhimit Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit duke u mbështetur në prioritetet e vendosura nga Këshilli i Bashkisë gjatë kësaj periudhe ka punuar në:

- Pagesat për shërbimin e borxheve të vitit të mëparshëm
- Pagesat për shpenzimet e Emergjencës Civile
- Pagesat e punonjësve dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore
- Transfertat e fondeve në sigurimet shoqërore
- Ndihma dhe pagesat e papunësisë
- Pagesat për ujin dhe energjinë elektrike
- Pagesat e tjera nga fondet publike duke zbatuar parimin e regjistrimit kronologjik, hyrja e parë – dalja e parë

Treguesit e shpenzimeve për vitin 2022, kanë paraqitjen e mëposhtme (tregues të përmbledhur):

Administrata ka pasur në dispozicion për vitin 2022 gjithësej 3531390 mije leke për përdorim nga Dega e Thesarit të ndara si më poshtë;

a. Nga të ardhurat e veta (Burim financimi)

Plani i të ardhurave sipas buxhetit të miratuar: **1371535** mijë lekë, nga të cilat janë çelur ne thesar **1,210,235** mijë lekë janë përdorur në fakt **886,333** mijë lekë ose **73,22%**

b. Nga Granti i Pakushtëzuar (Burim financimi)

Plani : **760,265** mijë lekë janë përdorur në fakt **568,885** mijë lekë ose **77,93%**

c. Nga Granti Specifik (Burim financimi)

Plani : **539,349** mijë lekë janë përdorur në fakt **419,759** mijë lekë ose **79,26%**

d. Nga Buxheti i Shtetit (Burim financimi)

Plani : **860,241** mijë lekë janë përdorur në fakt **812,518** mijë lekë ose **94,45%**

Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit sipas vendimeve të Këshillit të Bashkisë si dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave ka marrë parasysh likuidimin e detyrimeve të vitit 2022 si likuidime të para.

Gjithashtu janë kryer pagesat sipas institucioneve dhe strukturave të miratuara nga Këshilli Bashkiak për vitin ushtrimor 2022.

Për vitin 2023 kanë ngelur detyrime të palikujduara të kontabilizuara në vlerën 108,414 mijë lekë nga viti i mëparshëm 2022, të cilat përbëhen nga 32,395 mijë lekë energji elektrike e trashëguar në vite (pagesa e kësaj shume do të vazhdojë të kryhet për çdo vit sipas planit të miratuar nga Këshilli i Bashkisë) 2,410 mijë lekë fatura të palikujduara nga ish Parku Urban (mospagesa ka ardhur si rezultat i mungesës së dokumentacionit të dorëzuar nga ish Parku Urban),2838 mijë lekë fatura të paligujduara për shërbime,2114 lekë fatura të paligujduara për mallëra,65,960 mije lekë fatura të paligujduara për investime ...e tëj

Pasë rakordimeve me Degën e Thesarit Vlorë Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit trashëgon për vitin 2023 fondet si më poshtë:

- Grant i pakushtëzuar **191.380** mijë lekë

- Grant specifik **119.590** mijë lekë
- Të ardhura të papërdorura **535,916** mijë lekë
- Totali i fondeve të trashëguara **846,887** mijë lekë.

Nga shumat e mësipërme janë regjistruar detyrimet kontabël 108,413,908 lekë të cituara më lartë dhe të raportuara si detyrime në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë deri në 31.12.2022 të cilat do të shlyhen në miratimin e buxhetit shtesë. Veç detyrimeve sipas tabelës së mëposhtme të cilat janë të kontabilizuara janë edhe detyrimet e subjektit të kontraktuar për pastrimin e qytetit në shumën 131,274 mijë lekë nga të cilat 32,274 mijë lekë i janë pakësuar situacioneve të punimeve për periudhën janar-korrik 2022 dhe 99,000 mijë lekë janë detyrimet e pashlyera te periudhës gusht-dhjetor 2022 për të cilat subjekt nuk është dakortësuar ti paraqes faturat sipas volumeve të punës në fakt. Gjithashtu nga fondet e sipërcituara do të përdoren edhe për shpronësimin e pasurive pronë private të prekura nga realizimi i projekteve në infrastrukturën publike në shumën 40956 mijeë lekë, fonde të cilat nuk u përdoren gjatë vitit 2022 për shkak të mungesës së paraqitjes së dokumentacionit të plotë nga subjekte e shpeonësuar.

Nr	Nr.UR	Subjekti	Date	Mbetja
		2020	qershor 2020	
1	1	Furnizuesi sherbimit universal	tetor 2020	32,394,556
2	2	Ermal Arapi	tetor 2017	17,223
3	3	Alba sha	korrik 2018	92,400
4	4	Arben Sako	qershor 2018	5,500
5	5	Asa 3D	2013-2014	41,870
6	6	Aulona Pol	korrik 2017	1,234,240
7	7	Bledar Dora	tetor 2018	25,920
8	8	Citrus shpk	tetor 2018	14,040
9	9	Elba Oil	netor 2017	28,800
10	10	Elton Ismailaj	netor 2017	3,000
11	11	Espiron	shtator 2017	10,000
12	12	Eximoil	qershor 2015	52,580
13	13	Gramos Habilaj	shtator 2018	12,000
14	14	Kadiu	gusht 2018	139,000
15	15	Majlinda Racaku	dhjetor 2017	2,500
16	16	Niko Vengu	mars 2017	11,000
17	17	Noart	gusht 2018	94,080
18	18	Pajtim Dalipaj	tetor 2018	9,900
19	19	Posta Shqiptare	mars 2017	1,145
20	20	Serjani Er	korrik 2016	58,080
21	21	Sherif Kaloci	korrik 2018	45,000
22	22	Shpetim Runaj	tetor 2017	20,700
23	23	Shpetime Bendaj	tetor 2017	1,560
24	24	Sparkle	korrik 2017	34,680
25	25	Spiro Vengu	2017	1,400
26	26	Tech invest	shtator 2018	0
27	27	Triptik	mars 2017	5,700
28	28	Tv 6+1 Vlora	korrik 2017	20,000
29	29	Ujesjellesi	2017	3,247
30	30	Viron Borakaj	gusht 2017	9,500
31	31	Xhipe	mars 2020	19,200
32	32	Egian Med shpk	dhjetor 2020	230,400
33	33	shperblim lindje		2,680,000
34	34	Bkt kredia	janar 2019-2020	2,407,213
35	35	Albaenerg shpk		13,680
36	36	Furnitor te ndryshem		1,240,618
		Shuma 1		40,980,732
		2021		
1	36	Universiteti Politeknik i Tiranes	Fat.244.dt.11.12.2020	397,134
2	37	Universiteti Politeknik i Tiranes	Fat.244.dt.11.12.2021	325,041
		2022		
1	1	Rikonstruksion i Ujesjllsit Transballkanike	fat.17.dt.27.09.2021	59,392,230
2	2	Rikonstruksion i Ujesjllsit uje i ftohte	fat.908.dt.26.07.2022	1,040,575
3	3	Rikonstruksion i Ujesjllsit Novosele	fat.906.dt.29.07.2022	1,022,370
4	4	Riparimi i Shkolles Teli Ndini	fat.79.dt.28.12.2022	651,600
5	5	Ndertimi i Salles se Keshillit	fat.26.dt.12.10.2022	3,517,418
6	6	Rikonstruksioni i banesave Egjiptjane	fat.56.dt.16.12.2022	405,684
7	7	Supervizimi i Ujesjllsit Novosele	fat.62.dt.27.10.2021	581,116
8	8	Botim Libri	fat.96.dt.29.12.2022	100,008
		Shuma 2		67,433,176
		Totali		108,413,908

Pjesë të raportit të monitorimit po paraqesim më poshtë anekset përkatëse të shpenzimeve sipas Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018 “Për Procedurat Standarde Të Monitorimit Të Buxhetit Të Njësive Të Vetëqeverisjes Vendore”. Procedurat për procesin e monitorimit të vitit korrent 2022 përfshijnë raportet si më poshtë:

- a) Shpërndarja e fondeve sipas programeve dhe zërave të klasifikimit ekonomik të shpenzimeve (artikujve), si dhe shpërndarja e fondeve për projektet, produktet;
- b) Produktet e parashikuara për secilin program;
- c) Kosto për njësi e planifikuar për secilin produkt;
- d) Ndarje e shpenzimeve sipas produkteve;
- e) Zbatimi i planit strategjik të zhvillimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore (planit të përgjithshëm vendor), strategjive sektorial

Emri i grupit: 146001		Shpenzimet e njësisë së vetëqeverisjes vendore-VLORE							Kodi i grupit: 00
Titulli	Programet Emërtimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2021	(2) PBA Viti 2022	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022	(4) Buxheti vjetor Plan i rishikuar Viti 2022	(5) Buxheti vjetor Planit Periudhës/progresi	(6) Fakti i Periudhës/progres	(7)=(6)-(5) Diferenca	
		1110	Administrata e Bashkisë	399,178	513,532	570,568	698,515	717,510	534,141
1320	Mb.Dekori+Varreza	12,725	16,101	16,101	16,896	15,966	11,169	-4,797	
3280	PMNZSH	37,994	58,081	58,081	74,372	62,488	41,926	-20,562	
4240	Ujti dhe Kullimi	37,081	41,600	41,600	54,734	54,734	36,210	-18,524	
4260	Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave	5,779	8,236	8,236	13,007	11,050	6,168	-4,882	
4520	Rrjeti rrugor	138,903	124,035	124,035	168,472	111,448	53,578	-57,870	
5100	Pastrimi	182,655	456,368	355,594	521,904	432,771	318,502	-114,269	
5100	Gjelberimi	59,723	77,468	77,468	77,468	67,737	59,474	-8,263	
5200	Ujesjellesi	31,780	25,177	25,177	25,177	5,697	4,365	-1,332	
6260	Zhvillimi i komunitetit	182,885	253,826	252,285	263,559	202,857	179,069	-23,788	
6440	Mb. Ndihimi rrugor	105,927	104,782	114,782	119,531	134,474	89,586	-24,888	
8130	Kl.Shumesportesh	53,334	59,090	53,090	53,090	43,159	43,132	-27	
8230	Qendra Kulturore	37,595	40,946	40,946	40,946	43,534	39,793	-3,741	
8280	Teatri Petro Marko	26,080	33,115	33,115	33,115	33,065	29,592	-3,473	
9120	Arsimi Parauniversitar	307,978	394,603	394,603	448,469	412,425	336,580	-75,845	
9230	Arsimi i Mesem i Përgjithshëm	51,706	85,075	59,033	79,075	79,348	47,004	-32,344	
10140	Qendra PAK	13,867	16,202	16,202	16,202	10,041	8,874	-1,167	
10430	Shtëpia e Fëmijës	30,740	10,053	10,053	10,053	9,483	8,246	-1,237	
	Fondi i kontigjenes		53,577	53,577	53,577				
	Total	1,715,930	2,371,867	2,304,546	2,768,162	2,427,787	1,847,409	-580,378	

Sic paraqitet në tabelën e mësipërme realizimi i buxhetit në total (të ardhurat e veta + grant i pakushtëzuar + grant specifik) është realizuar në masën 76,09 %. Nga këto paga janë realizuar 90.97%, sigurimet shoqërore 86.42%, shpenzime operative 78.48%, subvencione 76.61% dhe investimet 47.29%.

Programi	5100						Kodi I programit	
Art.	Emërtimi	1.Fakti I vitit paraardhës Viti 2021	2 .PBA Plan Viti 2022	3. Buxheti vjetor Plan fillestar Viti 2022	4. Buxheti vjetor Plan I rishikuar Viti 2022	5.Buxheti vjetor Plan I peroidhes/pro	6. Fakti I periudhës/progr esiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	697,218	925,341	859,468	912,390	795,290	723,526	-71,764
601	Sigurime shoqërore	114,360	151,849	141,377	149,345	138,843	119,993	-18,850
602	Mallra dhe shërbime të tjera	594,420	887,776	881,579	1,126,648	1,033,956	811,479	-222,477
603	Subvencione	44,780	25,177	25,177	25,177	5,697	4,365	-1,332
604	Transferta korrente të brendshme	32,901	41,952	9,950	9,950	10,151	8,403	-1,748
605	Transferta korrente të huaja	0	0	0	0	0	0	0
606	Trans për buxh. fam & individ	1,448	0	2,500	2,500	20,541	18,650	-1,891
609		0	0	0	15,172	37,777	0	-37,777
651		0	0	3,567	3,567	189	189	0
166		0	2,500	18,435	18,435	6,524	6,523	-1
466						59,780	3,384	-56,396
Nëntotali	Shpenzime korrente							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara							
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara	230,803	283,695	308,916	451,401	319,039	150,897	-168,142
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj							
Totali	Shpenzime kapitale							
	Totali (korrente+ kapitale)	1,715,930	2,318,290	2,250,969	2,714,585	2,427,787	1,847,409	-580,378
Drejtuuesi I	Emri	Kryetari I Njësisë Vetëqeverisjes Vendore	Emri					
Ekipit								
Menaxhues të Programit								
	Firma			Firma				
	Data			Data				

Programi	Administrata e Bashkise						Kodi I programit	
Art.	Emërtimi	1.Fakti I vitit paraardhës Viti 2021	2 .PBA Plan Viti 2022	3. Buxheti vjetor Plan fillestar Viti 2022	4. Buxheti vjetor Plan I rishikuar Viti 2022	5.Buxheti vjetor Plan I peroidhes/progresiv	6. Fakti I periudhës/progr esiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	192,433	231,948	231,948	231,948	209,254	195,823	-13,431
601	Sigurime shoqërore	30,872	38,405	38,405	38,405	38,255	32,649	-5,606
602	Mallra dhe shërbime të tjera	145,363	148,006	208,092	283,914	240,194	213,810	-26,384
603	Subvencione							
604	Transferta korrente të brendshme	24,340	16,523	9,950	9,950	10,151	8,403	-1,748
605	Transferta korrente të huaja							
606	Trans për buxh. fam & individ	1,448		2,500	2,500	6,196	4,593	-1,603
609						22,605		-22,605
651				189	189	189	189	0
166			2,500	6,384	6,384	6,524	6,523	-1
466						59,692	3,296	-56,396
Nëntotali	Shpenzime korrente							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara							
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara	4,722	76,150	73,100	125,225	124,450	68,855	-55,595
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj							
Totali	Shpenzime kapitale							
	Totali (korrente+ kapitale)	399,178	513,532	570,568	698,515	717,510	534,141	-183,369
Drejtuuesi I	Emri	Kryetari I Njësisë Vetëqeverisjes Vendore	Emri					
Ekipit								
Menaxhues të Programit								
	Firma			Firma				
	Data			Data				

Bashkia	Vlore						Kodi i grupit/Njesise vendore	146001
Programi	Dekori+Varreza						Kodi i programit	1320
Art.	Emërtimi	1.Fakti I vitit paraardhës Viti 2021	2 .PBA Plan Viti 2022	3. Buxheti vjetor Plan fillestar Viti 2022	4. Buxheti vjetor Plan I rishikuar Viti 2022	5.Buxheti vjetor Plan I peroidhes/ progresiv	6. Fakti I periudhës/ progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga							
601	Sigurime shoqërore							
602	Mallra dhe shërbime të tjera	12,725	16,101	16,101	16,896	15,966	11,169	-4,797
603	Subvencione							
604	Transferta korrente të brendshme							
605	Transferta korrente të huaja							
606	Trans për buxh. fam & individ							0
609								
651								
166								
Nëntotali	Shpenzime korrente							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara							
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara							
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj							
Totali	Shpenzime kapitale							
	Totali (korrente+ kapitale)	12,725	16,101	16,101	16,896	15,966	11,169	-4,797
Drejtuessi I Ekipit	Emri	Kryetari I Njësisë Vetëqeverisjes Vendore		Emri				
Menaxhuesi i Programit								
	Firma			Firma				
	Data			Data				

Bashkia	Vlore						Kodi i grupit/Njesise vendore	146001
Programi	PMNZH						Kodi i programit	3280
Art.	Emërtimi	1.Fakti I vitit paraardhës Viti 2021	2 .PBA Plan Viti 2022	3. Buxheti vjetor Plan fillestar Viti 2022	4. Buxheti vjetor Plan I rishikuar Viti 2022	5.Buxheti vjetor Plan I peroidhes/ progresiv	6. Fakti I periudhës/ progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	29,876	47,141	47,141	47,141	35,996	32,073	-3,923
601	Sigurime shoqërore	4,876	7,821	7,821	7,821	6,221	5,321	-900
602	Mallra dhe shërbime të tjera	3,242	3,119	3,119	4,238	4,239	3,672	-567
603	Subvencione							
604	Transferta korrente të brendshme							
605	Transferta korrente të huaja							
606	Trans për buxh. fam & individ					860	860	0
609					15,172	15,172		-15,172
651								
166								
Nëntotali	Shpenzime korrente							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara							
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm							
230	Kapitale të patrupëzuara							
231	Kapitale të trupëzuara							
232	Transferta kapitale							
Nëntotali	Shpenzime kapitale me financim të huaj							
Totali	Shpenzime kapitale							
	Totali (korrente+ kapitale)	37,994	58,081	58,081	74,372	62,488	41,926	-20,562
Drejtuessi I Ekipit	Emri	Kryetari I Njësisë Vetëqeverisjes Vendore		Emri				
Menaxhuesi i Programit								
	Firma			Firma				
	Data			Data				

Bashkia	Vlore						Kodi i grupit/Njesise vendore	146001
Programi	Ujitja dhe Kullimi						Kodi I programit	4240
Art.	Emertimi	1.Fakti I vitit paraardhes Viti 2021	2 .PBA Plan Viti 2022	3. Buxheti vjetor Plan fillestar Viti 2022	4. Buxheti vjetor Plan I rishikuar	5.Buxheti vjetor Plan I peroidhes/progresiv	6. Fakti I perluhdhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	10,363	12,636	12,636	13,746	13,456	11,131	-2,325
601	Sigurime shoqërore	1,716	2,024	2,024	2,248	2,248	1,731	-517
602	Mallra dhe shërbime të tjera	21,062	26,940	26,940	27,480	24,820	23,058	-1,762
603	Subvencione							
604	Transferata korrente të brendshme							
605	Transferata korrente të huaja							
606	Trans për buxh, fam & Individ					290	290	0
609								
651								
166								
Nëntotali	Shpenzime korrente							
Gjatë gjithë periudhës së sezonit turistik kemi mbuluar me shërbime të përforcuara gjithë zonat që kanë prioritet turistik sidomos Lungomaren, Bulevardin, Qendrën Historike.

Krahas këtyre janë ushtruar dhe detyra të tjera funksionale për të cilat jemi ngarkuar me ligj.

- Detyra funksionale në ruajtjen e hapësirave publike nga dëmtimet e rrugëve, trotuareve, ndërtesave pronë e Bashkisë. Lirimin e hapsirave publike, të zëna nga tregëtarët ambulante, subjektet që operojnë në katet e para të pallateve apo ndërtesave në rrugët kryesore të qytetit dhe njësive administrative etj. Është nderhyrë në 300 raste.
- Është ndëhyrë vetë apo në mbeshtetje të INUV, njësive administrative e rajoneve për parandalimin e ndërtimeve pa leje apo prishjen e tyre në 40 raste.
- Janë bllokuar apo gjobitur tregëtar të fruta – perimeve që operojnë me shumicë jashtë tregut të fruta- perimeve, mjete për kundravajtje rrugore, dhe kundravajtje të ndryshme administrative në 198 raste.
- Janë ushtruar kontrole vetëm apo në bashkëpunim me inspektorët e pyjeve dhe kullotave për evidentimin e prerjeve të paligjëshme apo hedhjen e mbeturinave në pyje, sidomos në Pyllin e Sodës, Llogora etj. Në 250 raste.
- Jemi përgjigjur në kohë shqetësimeve të qytetarëve për problematika nga më të ndryshmet ankesa të ardhura në zyrën e informacionit në telefonin fikse dhe fizikisht.

- Jemi përgjigjur në kohë zgjidhjeve efikase të ankesave të ardhura nga Portali i Bashqeverisjes në 11 raste dhe ankesave dhe kërkesave të ardhura nga Policia e Shtetit në 125 raste.
- Kemi mbështetur aktivitete kulturore të zhvilluara nga Bashkia Vlorë në 105 raste sidomos gjatë sezonit turistik dhe festave të fundëvitit duke organizuar dhe shërbime 24 orë për ruajtjen e dekorit festiv të qytetit.
- Kemi mbështetur aktivitetet sportive të zhvilluara nga Klubi Sportiv Flamurtari në Stadium, Pallatin e Sportit, Fushën në Pyllin e Sodës dhe në Orikum në 124 raste.
- Kemi mbështetur zhvillimin e punimeve pa pengesa në Lungomare2, në rehabilitimin e blloqeve të banimit në Lagjen 1 Maj dhe 24 Majë, Sheshin e Flamurit, Parkun e Pavarsisë, sheshin para Bashkisë sa herë që firmat zbatuese të projekteve kanë paraqitur kërkesë.
- Kemi mbështetur pa kufizim ‘Ndërrmarjen e Ujësjetës Kanalizimeve’, ‘Ndërrmarjen e Shërbimeve Publike’ gjatë aktiviteteve të tyre të përditëshme apo investimeve të kryera nga Bashkia Vlorë.
- Kemi kontribuar për lirim të qarkullimit rrugor në qytet me patrulla fikse të vijat e bardha në Skelë gjatë gjithë sezonit turistik, për parandalimin e parkimeve të gabuara në Lungomare gjatë gjithë shtrirjes së saj në bashkpunim të ngushtë me Policinë e Shtetit.
- Është mbuluar me shërbime Tregu në Novoselë çdo ditë të enjte.

Në ‘Pikën e Grumbullimit të Mbetjeve Urbane’ është stacionuar peshorja dhe kryhet shërbim 24 orë për peshimin e makinave të firmës së pastrimit, për të kontrolluar peshë e tyre.

Në saj të aksionit kombëtar të pastrimit shërbimet e Policisë Bashkiake janë angazhuar fuqishëm duke ushtruar kontrole të vazhdueshme në gjithë territorin e Bashkisë Vlorë. U ndërhy fuqishëm për disiplinimin e mbetjeve të bizneseve sidomos të supermarketeve dhe të pikave shumice, duke i disiplinuar në depozitim të mbetjeve nga aktiviteti i tyre. Pylli i Sodës mbulohet me shërbim të përforcuar i ndarë në sektor. Janë mbështet me shërbime policore dhe pjesmarrje, aksionet e pastrimit që ka organizuar Bashkia Vlorë.

Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit

Periudha 1 janar deri 31 dhjetor 2022 janë vendime për dënimin me gjobë të objekteve të konstatuara kundërvajtje mbi 100 raste.

Në të njëjtën periudhë janë vendime për prishje të objekteve të konstatuara kundërvajtje 81 copë.

Në objektet të cilat janë marrë vendimet për prishje janë objekte:

- Të konstatuara si ndërtime pa leje në flagrancë (që shoqërohen me V. Dënimin me gjobë)
- Objekte të cilat janë skualifikuara nga ASHK.
- Objekte të cilat preken nga investimet publike.

Në objektet të cilat janë marrë vendimet për gjobë janë objekte:

- Të konstatuara si ndërtime pa leje në flagrancë
- Subjekte që kërkojnë shtyrjen e afatit të zbatimit të Lejeve të Ndërtimit

Ekzekutimi i objekteve me vendime prishjeje është bërë për të gjitha objektet që preken nga Investimet publike dhe të skualifikuara nga ASHK.

Një pjesë e objekteve të konstatuara si kundërvajtje janë vetëekzekutuar nga kundërvajtësit.

Një pjesë e objekteve janë prishur prej IKMT, dhe për pjesën tjetër jemi në pritje pas kërkesës për bashkëpunim drejtuar IKMT.

Vlera e gjobave të vendosura nga I.M.T Bashkia Vlorë 34,890,000 lekë

Vlera e gjobave të arkëtuara është 1,200, 000 Lekë

Diferenca e pa arkëtuar për gjobat e vendosura është në proces të gjykatës dhe zyrave përmbartimore.

3. Projekti : Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit Programi: K03280. Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

Në zbatim të Ligjit 152/2015 dhe VKM nr. 520 dt. 25.07.2019 nga Shërbimin Zjarrëfikës, gjatë vitit 2022 është realizuar puna dhe siguruar Gatishmëria, në njohjen e bazës Ligjore, bazuar në Ligjin 152/2015 dhe VKM nr.520 dt.25.07.2019 , Urdhrave dhe Udhëzimeve si dhe Postës Elektronike ardhur nga Dretoria e Përgjithshme e MZSH në Ministrinë e Brendshme Tirane si edhe Urdhrave të dala nga Kryetari i Bashkisë Vlorë.

Programi Vjetor i përgatitjes Profesionale ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH Tiranë është duke u zbatuar nga Shefi i Sektorit të Ndërhyrjes dhe Drejtuesi i Shuarjes së Zjarrit dhe Komandantët e Shërbimeve.

Sektorit i ndërhyrjes ka marre masat e menjëhershme për përpilimin e Dokumentacionit Ligjor për muajt Janar-Gusht 2022, bazuar në Ligjin 152/2015 si dhe akteve nënligjore dhe Udhëzimeve të Ministrisë të Brendshme si dhe Urdhrave të ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH Tiranë. Sektorit i Parandalimit ka marre masat për programimin e Punës për muajt Janar-Gusht 2022, dhe janë duke zbatuar programin e planit të masave të ardhura nga DPMZSH, konkretisht për verifikimin dhe ndarjen e Objekteve sipas rrezikshmërisë në kategori bazuar në Aktet Ligjore në fuqi , të dala nga Ministri e Brendshme.

Është ndjekur në vazhdimësi gatishmëria e Sektorit të Ndërhyrjes duke u mbështetur në organizimin e Shërbimit sipas Grafikut të Shërbimit, Librave të Planezuara dhe situatave të paparashikuara.

Vëmendje kryesore dhe e veçantë ju kushtua mirëmbajtjes së Automjeteve Zjarrëfikse si dhe Paisjeve dhe materialeve të tjera ndihmëse të Zjarrëfikse si dhe bashkëpunimit me Drejtorinë e Emergjencave në Bashkinë Vlorë dhe në Prefekturën e Qarkut Vlorë.

Në vazhdimësi me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Shërbimit të Bashkisë po marrim masat e nevojshme për tu paraprirë situatave në vazhdimësi

Gjatë periudhës Janar-dhjetor 2022 janë asistuar këto situata:

- Pyje, shkurre, kullota - 424
- Situata Zjarri në banesa - 46
- Ndërhyrje Shpëtimi dhe emergjence - 78
- Ndërhyrje djegie makinash - 38
- Situata zjarri të ndryshme
- Alarm i rremë - 2
- Nuk ka qene e nevojshme per nderhyrje - 20
- Totali gjithesej – 612

Ketë periudhë, vecanërisht gjatë verës ka patur probleme me ngjarje sidomos ne drejtim te mjedisit dhe djegies se papergjegjshme sidomos ne Ullishte perballe Fshatit Bestrove mbi Pusin E Mezinit Ullishtëja, ,Ngjarje tek fshati Radhim ku digjeshin ullinje.Ne ngjarjen ku digjeshin Plerat e Qytetit me kerkese te Komunitetit per ndime ne drejtim te verifikimit te moshave te treta te cilet nuk pergjigjen ne banesat e tyre ku jetojne eshte dashur nderhyrja e Efektivit Zjarrefikes dhe pse me

shume veshtiresi u kemi ardhur ne ndihme Komunitetit,por gjithashtu ngelet për tu përgëzuar ndërhyrja e dhe e institucioneve mbështetëse si Policia e Shtetit dhe ne saj te tyre me disa kallezime te bera ne ana e tyre per zjarrevenjet e qellimshme u be i mundur frenimi i zjarreve dhe kallezim penal per zjarrevenesit.

	MASAT							Vërtetime zjarri	Miratim projekti për PMNZSH
	Konstatime me procesverbal (dënim me gjobë)	Gjoha me vendim	Bllokime	Kallëzim penal	Akte ekspertize (për zjarret e rëna)	Akte teknike (Çertifikatë e mbrojtjes nga zjarri)	Ripërtëritje e akte teknike (Çertifikatë e mbrojtjes nga zjarri)		
JANAR	-	-	-	-	5	-	5	4	4
SHKURT	-	-	-	-	5	2	7	4	8
MARS	-	-	-	-	3	-	15	1	7
PRILL	-	-	-	-	8	4	4	1	10
MAJ	-	-	-	-	2	7	2	1	8
QERSHOR	-	-	-	-	3	6	3	2	6
KORRIK	-	-	-	-	5	7	2	4	3
GUSHT	-	-	-	-	-	3	2	1	3
SHTATOR									
TETOR									
NENTOR									
DHJETOR									
TOTALI									

	Kilometra te pershkruara	Normat e konsumit	Shpenzimet e bera per:									Totali/Lekë
			Gazoil		Benzine		Lubrikante		Blerj pjes	Mirëmb/Ruti	Siguracion	
			Litra	Leke	Litra	Leke	Litra	Leke	Leke	(Leke)	TPL	
			1	2	3	4	5	6	1+6			
JANAR	1016	-	774	176	234	173	-	-	-	-	-	176706
SHKURT	857	-	605	176	185	173	-	-	-	-	-	135805
MARS	1919	-	1159	190	479	175	-	-	-	-	-	304035
PRILL	1679	-	735	230	251	215	-	-	-	-	-	222015
MAJ	1581	-	664	237	252	235	-	-	-	-	-	216588
QERSHOR	2076	-	680	237	381	235	-	-	-	-	-	250695
KORRIK	3053	-	871	237	314	235	-	-	-	-	-	280217
GUSHT	4464	-	1034	235	446	225	-	-	-	-	-	343340
SHTATOR												
TETOR												
NENTOR												
DHJETOR												
TOTALI												

Drejtoria e Mbrojtjes Civile

Drejtoria e Mbrojtjes Civile gjate vitit 2022 për realizimin e detyrave ka synuar në krijimin e kushteve për të zvogëluar risqet e fatkeqësive,për të parandaluar ,përgatitur,përballuar fatkeqësitë dhe për tu rimëkëmbur,nëpërmjet një sistemi të integruar dhe efikas të mbrojtjes civile. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi përbëjnë elementet kryesor që përshkojnë planin për të bërë të mundur shfrytëzimin e të gjitha mundësive dhe kapaciteteve ekzistuese.

Plani i Mbrojtjes Civile për Bahkinë Vlorë është i zbatueshëm për të gjitha fazat e ciklit të emergjencave, për përgatitjen, përgjigjen, rikthimin në gjendje normale dhe lehtësimin e pasojave në popullsi.Sipas eksperiencës në vite Bashkia Vlorë vlerësohet si një rajon i mundshëm për një numër të konsiderueshëm fatkeqësish natyrore ose veprimtaria njerëzore. Rreziku më i madhnë Bashki nga fatkeqësitë natyrore mund të vijë nga tërmete të rëndë, përmbytjet, rrëshqitjet e tokës,.

Baza ligjore ku mbështetet puna e D.M.C është ligji 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile "dhe VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”

Për vitin 2022, D.M.C ka verifikuar mbi 50 ankesa qytetarësh që kanë të bëjnë me problematika të ndryshme.

-Disa prej ankesave kanë qënë djegje në banesë nga shkaqe të ndryshme të cilat janë verifikuar ,më pas u janë plotësuar dosjet dhe u është bërë gati projektvendimi për në Këshillin Bashkiak për marrjen e dëmshpërblimit financiar nga Bashkia Vlorë.Konkretisht disa prej shtetasve që kane përfituar ndihema financiare nga bashkia vlorë gjatë këtij vit jane sipas tabelës së mëposhteme;

Nr.	Bashkia	Emër Mbiemër	V.K.B	Data	Fatkeqësia	Vlera e dëmit	Vlera e dhënë
1.	Vlorë	Jonus Lalaj	20	28.03.2022	Djegje në banesë	414.366	306.811
2.	Vlorë	Ilirjan Skëndaj	21	28.03.2022	Djegje në banesë	1.282.960	826.383
3.	Vlorë	Adriola Ruko	22	28.03.2022	Djegje në banesë	408.115	352.297
4.	Vlorë	Zihni Xhemalaj	32	28.04.2022	Djegje në banesë	846.456	675.598
5.	Vlorë	Petrit Licaj	30	28.04.2022	Djegje në banesë	530.237	467.189
6.	Vlorë	Krenar Rrapaj	31	28.04.2022	Djegje në banesë	628.972	545.160

-Në këtë periudhë ka pasur zjarre të shumta kryesisht në pyje, kullota, kallamishte e sidomos në zonën e vendgrumbullimit të plehrave të qytetit. Zjarret kryesisht kanë qenë në zonën e Bestrovës, Bunavisë, Radhimë, Grabian, Orikum si dhe te pylli i sodës. Me koordinimin e M.ZH.SH është bërë e mundur shuarja e zjarreve duke zvogëluar në këtë mënyrë në maksimum dëmet e shkaktuara.

-Në bashkëpunim me M.ZH.SH, Ndërrmarjen Pyjore dhe Policinë Bashkiake kemi hartuar Planin e Masave për Parandalimin e Zjarreve për periudhën pranverë – verë 2022.

-Janë zhvilluar takime me Prefektin dhe përfaqësues të A.K.M.C për problematika të ndryshme që lidhen me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore.

-Një problem i trajtuar nga D.M.C ka qenë problematika e pallatit 1300, një shqetësim i cili ka mbi 15 vite që trajtohet nga banorët. Një ndërhyrje e paligjshme në katin e parë të këtij pallati ka bërë që të dëmtohet dhe struktura e tij. Mbas një korrespondence të vazhdueshme të Bashkisë Vlorë me Institutin e Ndërtimit u arrit nga Instituti i Ndërtimit të bëhej një studim i plotë për të bërë ndërhyrjen në pallatin 1300.

Në datën 21 Maj 2022 D.M.C bëri disa njoftime për banorët e pallatit 1300, pasi mbas raportit të ardhur nga Instituti i Ndërtimit, pallati ka nevojë për riparime pasi rrezikon jetën e banorëve.

-Para sezonit veror në kuadër të sensibilizimit të popullatës për rrezikun që vjen nga rënia e zjarreve, D.M.C në bashkëpunim me Prefekturën, Policinë e Shtetit, 5 Njësitë Administrative dhe Kryepelqët e fshatrave ka zhvilluar disa takime sensibilizuese.

-vecanërisht periudha Maj- Gusht 2022 ka qenë e ngarkuar nga rënie e zjarreve të vazhdueshme në territorin e Bashkisë Vlorë. Përmendim :

Në datën 13 maj një zjarr masiv në pyllin Pish Poro ku specialistët e D.M.C kanë punuar së bashku me zjarrëfikësit për fikjen e zjarrit.

Në datën 21 dhe 25 maj te vendi i grumbullimit të plehrave si pasojë e rënies së zjarrit u mobilizuan të gjitha strukturat e bashkisë si N.SH.P, U.K., M.Z.SH për fikjen në kohë të tij.

-Në datën 30 qershor 2022 në Prefekturë është zhvilluar një takim koordinues dhe bashkëpunues në prani dhe të strukturave ushtarake me autoritetet civile dhe strukturat përgjegjëse për menaxhimin e situatave të emergjencave civile, kryesisht zjarreve në zonat me risk në nivel qarku dhe bashkie.

-Në datën 10 gusht 2022 është ndërhyrë për prerjen e disa pemëve në zonën e Zvërnecit të cilat përbënin rrezik për kalimin e automjeteve, në prezencë të D. Shërbimeve dhe D. Së Pyjeve.

-Në këtë periudhë ka pasur zjarre në gjithë territorin e Bashkisë Vlorë, por nga sinjalizimi i shpejtë dhe në kohë reale është bërë e mundur që forcat zjarrëfikëse të vinin zjarret në kontroll dhe duke i fikur plotësisht pa shkaktuar dëme të mëdha materiale dhe mjedisore.

Vlen për tu theksuar zjarri i rënë në datën 19 gusht 2022 në kodrat e Kaninës i cili preku sipërfaqe të mëdha dhe ullinj. Era e fortë dhe terreni i thyer kodrinor e vështirësoi shumë punën e forcave zjarrëfikëse dhe strukturave të tjera mbështetëse.

Me mobilizimin e të gjitha forcave të bashkisë u arrit të fiket zjarri duke shkaktuar vetëm dëme materiale.

Nderrmarrja e Sherbimeve Publike

Gjatë gjithë vitit 2022 në Qytetin e Vlorës është shërbyer në të gjitha sip. e gjelbërta.

Në rrugën nacionale Vlorë-Fier shërbehet me pastrim, higjienizim, korrje sip. bari, krasitje shkurresh, krasitje druresh, sperkatje drurësh.

Lulishtja Hyrja e qytetit është shërbyer me:pastrim,higjenizim,korrje sip,bari,vaditje me bot,krasitje shkurresh e gardh i gjelber,punim dru shkurre,plerim kimik,pastrim shatërvani,riparim stolash,spërkatje e bimësisë decorative,fshirje rruge,riparim e lyerje stolash.

Lulishja 8 nendori është shërbyer me krasitje drurësh ,krasitje gardh i gjelbër,punim,plerim kimikriparim e lyerje stolash.

Lulishte para Policisë: është shërbyer me pastrim,higjenizim,korrje sip.bari,krasitje gardh I gjelbër dhe shkurre,punim dru –shkurre-gardh i gjelbër,plerim kimik.,riparim e lyerje stolash.

Lulishte ura e degës; është shërbyer me:Pastrim higjenizim,korrje sip.bari krasitje dru-shkurre-gardh I gjelbër,plerim kimik.

Rruga Dervish Hekali:është shërbyer me punim drurësh e vaditje me bot.

Rruga Demokracia:është shërbyer me pastrim higjenizim ,korrje sip,bari,punim drurësh,vaditje me bot.

Rruga Hysni Alimerko; është punuar me pastrim ,punim drurësh dhe krasitje.

Lulishte Pallati i Kulturës + Universiteti i ri:është shërbyer me pastrim –higjenizim,punim toke për mbjellje lulesh,mbjellje lulesh,vaditje,korrje sip.bari+plehrim,krasitje palmash+spërkatje,Krasitje drurësh +punim,fshirje e rrugeve e shesheve,pastrim i fugave,qethje shkurresh për tu dhën formë,krasitje gardh i gjelber +punim.

Lulishte ne Hyrje te Portit :është shërbyer me :pastrim –higjenizime,korrje sip. bari,fshirje rrugë e sheshe,krasitje drurësh,qethje shkurresh e gardh i gjelbër+punim e vaditje

Rruga Fejzo Gjomema; është shërbyer me pastrim,punim drurësh,vaditje

Rruga Hektor Shyti;është shërbyer me :pastrim,punim drurësh,vaditje.

Rruga Kosova –Parku i tregëtisë:është shërbyer me:punim toke për mbjellje farë bari,mbjellje fare bari,plehrim,vaditje,korrje sip.bari,punim drurësh,qethje shkurresh +punim,vaditje me bot.

Rruga Pelivan Leskaj:është shërbyer me ;pastrim ,punim drurësh,qethje gardh i gjelbër,plerim kimik,fshirje.

Rruga Shyqyri Alimerko:është shërbyer me punim drurësh,pastrime barërash të këqija në trotuar,spërkatje drurësh.

Rruga Aristidh Kokoshi :është shërbyer me punim drurësh.

Rruga Dush Strati;është shërbyer me: punim drurësh,pastrim,krasitje,fshirje rruge

Rr.Nermin Vlora Falaski:është shërbyer me pastrim-higjenizim,korrje sip. bari,qethje shkurresh e punim,punim drurësh,plerim kimik.

Rr.Mustafa Bello:është shërbyer me :pastrim,punim drurësh+krasitje.

Rr.Naim Frasheri ;është shërbyer me pastrim,punim drurësh,pastrim trotuaresh nga barërat e këqija.

Rr.MisDurham:është shërbyer me punim drurësh,ktasitje,pastrim trotuaresh nga barërat e këqija,spërkatje drurësh,vaditje me bot,fshirje rruge

Lulishte Marigo Posio; është shërbyer me :pastrim-higjenizim, korrje sip. bari, plehrim, qethje shkurresh+punim, krasitje gardh i gjelbër+punim, fshirje rrugë e sheshe, plerim kimik.

Trekëndëshi Hollidei; është shërbyer me pastrim, vaditje, qethje gardh i gjelbër+punim, punim shkurresh, korrje sip. bari, plerim kimik, vaditje me bot.

Blloku Kapele-Posta; është shërbyer me; pastrim –higjenizim, qethje shkurresh+punim, punim drurësh, punim toke për përgatitje për mbjellje të sip. së barit të dëmtuar, plerim kimik.

Lagjia 28 Nentori+Gjendia Civile; është shërbyer me pastrim –higjenizim, korrje sip, bari. krasitje gardh i gjelbër+punim, qethje shkurresh+punim, punim drurësh, plerim kimik.

Shkallët në Kuzum Baba; shërbehet me pastim, korrje sip. bari, qethje shkurresh, fshirje të shkalleve.

Lungomare ; është shërbyer me :pastrim-higjenizim, vaditje, korrje sip. bari, plehrim, rigjenerim tapet bari, punim drurësh+krasitje, krasitje palmash+spërkatje, mbjellje pishave të reja, riparim impiantesh, fshirje rruge me fshese dhe autofshese, fshirje trotuaresh, korsi bicikletash.

Blloku Pavaresia; është shërbyer me: pastrim ,higjenizim, korrje sip. bari, qethje shkurresh+punim, qethje gardh i gjelbër, punim drurësh, krasitje palmash, plerim kimik.

Blloku Kali i Trojes; është shërbyer me; pastrim, higjenizim, korrje sip. bari, fshirje rrugë e sheshe, krasitje palmash+spërkatje, punim dru –shkurre, qethje shkurre e gardh i gjelbër, riparim stolash, lyerje stolash.

Rr: Anita Bitri, Lef Sallata, Jeronim de Rada, Fiqirete Musta, Hajredin Haxhiraj : është shërbyer me pastrim ,punim drurësh, krasitje, pastrim i trotuarit nga barërat e këqija, plerim kimik, vaditje me bot, fshirje rruges.

Blloku Isa Boletini; është shërbyer me ;pastrim ,higjenizim, korrje sip. bari, punim dru-shkurre-gardh i gjelbër, qethje gardh i gjelbër +shkurre, pastrim trotuari nga barërat e këqija, plerim kimik, fshirje rruges, riparim stolash.

Lulishte pas Qendrës Studentore; është shërbyer me; pastrim, punim drurësh, qethje shkurresh e gardh i gjelber+punim, pastrim barerash nga trotualet, riparim e lyerje stolash.

Blloku pas Teatrit Petro Marko; shërbehet me ;pastrim, higjenizim, korrje sip, bari, qethje shkurresh e punim, krasitje gardh i gjelbër +punim, punim drurësh, fshirje rrugë e sheshe.

Blloku përballë Xhamisë; është shërbyer me: pastim ,higjenizim, korrje sip. bari, fshirje rrugë e sheshe, punim drurësh, krasitje palmash, qethje shkurre e gardh i gjelbër+punim, riparim e lyerje stolash.

Rruga; Gjergj Araniti ; është punuar me; pastrim, higjenizim, qethje shkurre e gardh i gjelbër, punim shkurre e gardh i gjelbër, punim beli për përgatitje të tokës për rigjenerim të barit të dëmtuar, mbjellje fare bari, vaditje me bot.

Rr. Albano Romina ; është shërbyer me; pastrim, punim drurësh, pastrim trotuari nga barërat e këqija, vaditje me bot.

Rruga Veleidin Kollozi; është shërbyer me: pastrim, higjenizim, korrje sip. bari, punim drurësh+spërkatje, plerim kimik, vaditje me bot.

Rr. Riza Salati; është shërbyer me pastim, punim drurësh, pastrim trotuari nga barërat e këqija, vaditje me bot.

Lulishte Selia e PS: është shërbyer me :Pastrim,higjenizim,punim dru –shkurre,qethje shkurre e gardh I gjelbër,korrje sip. bari.

Rr.Ali Demi: është shërbyer me;pastrim,higjenizim,korrje sip.bari.punim drurësh,punim e qethje gardh I gjelber,plerim kimik,vendosje stolash te lapidary,vaditje me bot,sperkatje,riparim e lyerje stolash.

Rr.Osman Haxhiu,Zaho Koka,Enver Jaho;eshte sherbyer me pastrim,punim,krasitje druresh,pastrim I trotuarit nga barërat e këqija.

Rr.Rakip Malile: është shërbyer me;pastrim,krasitje palmash+spërkatje,qethje gardh i gjelbër +punim,plerim kimik.

Rotondo në Hyrje te Rr.Transballkanike: është shërbyer me ;pastrim,korrje sip. bari,plehim me pleh kimik,vaditje.

Rr.Transballkanike; është shërbyer me :pastrim ,higjenizim,krasitje gardh i gjelbër,punim trafikndarësit, korrje sip bari,punim toke,mbjellje lule,zvendësim të luleve të vjedhura,capitje,plehim,vaditje me bot, punim me freze,larje me lavazho,fshirje me fshese,fshirje me autofshese.

Lulishte 3 Racat; është shërbyer me pastrim,fshirje,punim dru-shkurre,qethje shkurresh,korrje sip.bari,shkulje barërash të këqija,larje me lavazho

Bloku i Kombinatit; është shërbyer me ;pastrim,korrje sip.bari,punim drurësh,pastrim fugash te parkimet e makinave,krasitje drurësh të mëdhenj që rrezikojnë,krasitje druresh per ngritje kurore,vaditje me bot.

Bloku pas Albano Romina: është shërbyer me ;pastrim ,higjenizim,punim dru-shkurre-gardh i gjelbër,vaditje me bot,fshirje rruges.

Rruga Sazani; është shërbyer me pastrim,higjenizim,korrje sip.bari,punim drurësh,Pastrim i pyllit të sodës nga letra,inerte,krasitje e pishave,heqje e rrënjëve të pishave të rrëzuara prej vitesh,prerje ferrash.

Lulishte Plazhi i vjeter; është shërbyer me;pastrim,korrje sip.bari,punim dru-shkurre,qethje shkurresh për tu dhënë formën e duhur,fshirje rruge e korsi biciklete.

Rr.Misto Mele; është shërbyer me pastrim ,higjenizim,korrje sip.bari,punim dru-shkurre-gardh I gjelbër,qethje shkurre e gardhe të gjelbër,vaditje me bot,sperkatje.

Rr.AT Kristo Negovani;eshte sherbyer me ;pastrim ,punim gardh I gjelber+krasitje,krasitje druresh plerim kimik,fshirje rruge.

Rr.Zahir Pajaziti,Tasim Jonuzi,Ramize Gjebrea;eshte punuar me pastrim,punim druresh,pastrim trotuaresh nga barërat e këqija.

Bloku pas 3 Racave;eshte sherbyer me;pastrim,punim dru-shkurre-gardh I gjelber,krasitje shkurre-gardh I gjelber,korrje sip.bari,punim toke dhe mbjellje fare bari në vendet e dëmtuara,fshirje rruges te lagjes.

Bloku te rr.Demokracia;eshte sherbyer me ;pastim,punim druresh,plerim kimik,pastrim të sip.të parkimeve,vaditje me bot.

Lulishte te Liqeni; është shërbyer me pastrim,korrje sip.bari,krasitje drurësh,qethje shkurresh,punim dru-shkurre.

Bloku Pilot; është shërbyer me;pastim,korrje sip.bari,punim dru-shkurre,qethje shkurresh,vendosje stolash,pastrim I trotuaresh nga barërat e këqija,riparim stolash dhe lyerje.

Rr.Dhimiter Konomi;është sherbyer me ;pastrim trotuari nga barerat e keqija,punim druresh,plerim kimik,sperkatje me herbicide e barerave te keqija.larje trotuaresh me lavazho.

Universiteti:është sherbyer me;pastrim,higjenizim,korrje sip.bari,pastrim fugash,punim dru,shkurre,krasitje shkurresh për tu dhën formën e duhur, krasitje palmash+sperkatje,fshirje rruge e sheshe,mbjellje lulesh,vaditje,plerim kimik.

Rruga Sulejman Delvina;është shërbyer me;pastrim,korrje sip. bari,pastrim fugash,punim dru - shkurre,krasitje dru-shkurre,pastrim trotuari nga barërat e këqija,vaditje me bot,sperkatje druresh,prejre e pemeve te thata,fshirje e larje trotuaresh me lavazho.

Ballkoni i Vlorës ;është shërbyer me pastrim,higjenizim,korrje sip.bari,plerim kimik..

Lulishte Posta eColes;është sherbyer me ;pastrim,higjenizim ,korrje sip. Bari,punimdru –shurre,-gardh I gjeber,qethje gardh i gjelber +shkurre.

Shkollat e Kopshtet e qytetit:është sherbyer ne te gjitha shkollat e kopshtet me ;korrje sip.bari,punim dru –shkurre,plerim kimik,qethje shkurresh e gardhesh te gjelber,mbjellje fidanësh të rinj, krasitje druresh e palmash.Me nje sip totale; sip Bari 85000 m2,dru dekorativ 2838,Palma 201,Shkurre 1773 rrenje.

Ne Fidanishte ;punohet me ;pastrim territori nga barerat e keqija,punim druresh,krasitje formuese,mbushje qeskash per tranpantim fidanesh,mbushje kubikesh me lule per pregatitje per qytet,prodhim fidanesh me fare e me kalema,bjellje farishtesh me lule e bime te ndyshme dekorative,pregatitje kurorash me raste festash te ndryshme,vaditje te bimesise,etj.

Lapidari ne Babice:punohet me ;korrje sipërfaqe bari,plerim kimik,punim gardh i gjerbër,punim drurësh.

Lulishte Shkolla e Marinës: është punuar me;pastrim të sip.të gjelbërt,vaditje,korrje sip.bari,plerim kimik,riparim inpiantesh.

Bulevardi Vlorë –Skelë;është shërbyer me ;pastrime ,fshirje,punim druresh,punim gardh i gjelbër,sperkatje të bimësisë dekorative,çapitje lulesh,korrje sip.bari te xhamia,plerim kimik,krasitje gardh I gjelber.

Duke filluar që nga muaji Qershor deri në fund të vitit 2022, Sektori I Gjelbërimit ka qenë I angazhuar me : Fshirje te rrugeve ne qytet.Pastrim të pyllit të sodës,pastrim të koshave në Bulevard,lungomare,rr,Sazani,rr,demokracia,blloku pas aulones dhe mbeturina jasht koshave ne qytet(2 here ne dite)Larje të trotuareve duke filluar nga Qendra Historike,Bulevardi Vlorë – Skelë,,Lungomare,Terrenet Sportive,,Rruga Jeronim De Rada,Rruga nga Kalaja në Orikum,Larje të shtërvaneve,sheshin e madh te lodrave,sheshi 3 racat,rruga dhimiter konomi,blloku I ri te xhamia,etj

Emërtimi	njësia	sasia	Volume pune të kryera në shërbim të sip.të gjelbërta sipas zërave
Lule	M2	4907	1500 m2
Bar	M2	216736	210000 m2
Dru dekorativ	Rrënjë	11750	10000 rrënjë

Palma	Rrënjë	895	800 rrënjë
Shkurre	Rrënjë	6232	5000 rrënjë
Rrugë e sheshe	M2	31797	500000
Gardh i gjelbër	ML	14571	12000 meter linear
Transport mbeturinash	rrugë		mbetje për 8 mujorin

Theksujme se proceset e punes te trajtuara me lart nga ana e sektorit të gjelbërimit jane përsëritur sa here është vlerësuar e domosdoshme.

SEKTORI MIRËMBAJTJE RRUGË TROTUARE , PLAZHE PUBLIKE

Gjatë gjithë vitit 2022 edhe Sektori i mirëmbajtje rruge, trotuare , plazhe si sektor brenda Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike e ka organizuar punën e tij mbi bazën e grafikëve të ndërtuar për ti shërbyer sa më mirë komunitetit të qytetit. Ky sektor e ka ndërtuar punën në mirëmbajtje të rrugëve të qytetit si mbushje me asfalt , çakëll , stabilizant dhe rërë bituminoze si dhe të njësisve administrative të përfshira në Bashkinë Vlorë si Novosel , Llakatund , Njësia Qendër dhe Orikum. Pothuajse është ndërhyrë gjatë gjithë periudhës në pjesën më të madhe të rrugëve të rajoneve të qytetit si:

Në rajonin Nr 5

Lagja “Kushtrim” përballë ish-fabrikë së e tullave është bërë pastrimi i dherave, llumrave dhe materialeve të ndryshme.

Këto rrugica të kësaj lagje janë pastruar dhe karikuar me çakëll disa herë duke transportuar sasi të mëdha të këtyre material janë larguar nga rrugicat dhe kunetat rreth 80 m³ materiale të ndryshme.

Është bërë skarifikimi dhe ,mbushja me material inert (cakell ,stabilizant) duke shpenzuar një sasi prej 110 m³ çakëll.

Po kështu në këtë rajon është ndërhyrë në rrugicat e po kësaj lagje pranë SHA Ujësjiellës Vlorë duke pastruar rrugicat dhe kunetat me materiale të ngurta prej 50 m³

Është bërë skarifikimi dhe skarifikimi me material inert (cakell, stabilizant në sasinë prej 70 m³.

Në bllokun e projektit plot pranë ish-serrave si dhe ish-tuneleve të aviacionit duke hequr pastruar dhe transportuar materiale të ndryshme si dhe mbeturina në volum prej 70 m³

Është bërë skarifikimi dhe karrikimi me material inert në sasinë prej 50 m³.

- Në rajonin Nr

Lagja “Isa Boletini”

Janë pastruar të gjitha mbetjet e ndryshme dhera , llumra dhe materiale të tjera në të gjitha rrugicat e kësaj lagje në sasinë prej 80 m³.

Janë skarifikuar dhe karikuar me material inert si çakëll , stabilizant në sasinë 130 m³.

Në zonën e unazës (bishti I kalldrëmit deri te Institucioni SHIK) janë pastruar të gjitha rrugicat e zonës nga mbeturina si dhe mbetje të ndryshme në volum 70 m³.

Janë skarifikuar dhe mbushur me çakëll, stabilizant në sasinë prej 30 m³.

Në lagjen “ 10 Korriku “

Janë pastruar mbetje të ngurta dhe materiale të tjera në sasinë prej 50 m³.

Janë skarifikuar dhe mbushur me çakëll, stabilizant rrugicat në sasi për 20 m³.

Në lagjen “ Uji i Ftohtë ‘

Pastrime nga mbetjet e ndryshme dhera llumra nga Club ITARUS deri te tuneli unaza (Diplomati) sidomos në situatën e shirave në sasinë prej 30 m³ pasi këto materiale shkarkohen nga kodra si rezultat i reshjeve në këtë zone.

Në lagjen “ Pavarësia “ është ndërhyrë me mbushje gropa me rërë bituminoze në sasinë prej 20 ton. Në rugicën pranë Zjarrëfiksës është ndërhyrë disa herë me pastrim mbeturina, ku janë larguar rreth 50 m³. Është bërë skarifikim dhe mbushje me çakëll stabilizant në rrugicat pranë ambulancës së lagjes si dhe rruga tek Aneksi I Stadiumit “ Flamurtari” rreth 30 m³.

- Në Rajonin Nr 3

Në lagjen “ Rilindja “ pastrim nga balta , mbetje materiale të ngurta në bllokun pranë P L M në sasinë prej 20 m³.

Në godinën e Bibliotekës së Qytetit është ndërhyrë me pastrim të sipërfaqeve të oborrit pas saj dhe heqje materiale në sasinë prej 30 m³.

Kjo sipërfaqe është mbushur me stabilizant në sasinë prej 20 m³.

Është ndërtuar një pjesë e murit rrethues të dëmtuar.

Është ndërtuar dhe vendosur portë metalike në hyrjen pas godinës.

Është bërë karikimi me rërë bituminoze në të gjitha rrugicat e lagje në sasinë prej 30 ton.

- Në Rajonin Nr 1

Në bllokun mbi spital pranë liqenit është ndërhyrë me pastrim të rrugicave nga mbetjet në ato të pa asfaltuar duke transportuar sasinë prej 50 m³.

Ndërkohë në këto rrugica u bë karikimi me çakëll me një sasi prej 50 m³.

Në zonën e Karabashit është ndërhyrë në të gjitha dëmtimet e rrugës me mbushje me rërë bituminoze në sasinë prej 20 ton.

- Në Rajonin Nr 4

Pastrimi i mbetjeve të ndryshme dhe inerteve në rrugët Mateo Matatias dhe evaduar një sasi materiali prej 30 m³. Është bërë skarifikim dhe karikim me çakëll stabilizant në sasi 40 m³. Në rrugën “ Fan Noli” është bërë skarifikimi dhe është bërë mbushje në stabilizant në sasi prej 40 m³. Te rruga pranë kopshtit “Pullumbat e Paqes” është bërë pastrimi dhe evadimi I një sasi prej 50m³. Po kështu është bërë skarifikim dhe karikim me stabilizant në sasinë prej 30 m³.

Duhet theksuar gjithashtu se sektori i pastrimit vec sa parashtruam më lartë gjatë gjithë periudhes ka qënë i angazhuar për të pastruar mbetje kudo që ato janë konstatuar referuar edhe problematikës me subjektin e kontraktuar për pastrimin në qytet.

Rrugët e dëmtuara të shtruara me asfalt

Emërtimi i rrugëve	Sipërfaqe / m2	Sasia /m3	Sasia / ton
Janaq Kilica , At Kristi Negovani, Cemokracia	228.6	22.8	50.1
Blloku kullave te Xhamia	594	59.4	130.68
Rruga para Shkollës "Janë Minga "	331.4	33.14	72.9
Unaza para SHIK dhe kthesa "Lamanaj"	115.4	11.54	25.38
Blloku pallateve pas Sigurime Shoqërore	96.6	9.6	21.12
Rruga Sulejman Delvina (bishti kalldrëmit) pas sigurimeve shoqërore nr 2	29.3	2.9	6.6
Rruga " Ali Demi " mbi spital (kryqëzimi)	771.5	77.1	170
Kryqëzimi transballkanike me rrugën Sazani (para karburant Vola)	50	5	11
Posta çole kryqëzimi si dhe pas pallatit postës	127.3	12.7	28
Rruga " Riza Salati,Misto Mele., kryqezimi tre racat)	182	18.2	40
Blloku pallateve tregu orizit	115	11.5	25.3
Rruga Kuzumbaba "	104	11.5	25.3
Rruga " Pelivan Leskaj	24	2.4	5.3
Blloku pallateve lagjja " Isa Boletini "	400	40	88
Sheshi ne fund te rruges " Demokracia" para Supermarket Haso	389.6	38.9	85.6
Rruga pranë ish-konsullatës Italiane	200	20	44
Blloku pallateve në " Varosh"	200	20	44
Eshte riparuar me asphalt blloku pallateve pas shkolles Industriale	300	30	66
Te rruga Gjergj Araniti	50	5	11
Rruga pelivan Leskaj (prane Hotel Partner	30	3	6.6
Tek unaza prane K SH A	60	6	13.2

Para shkolles "Teli Ndini"	500	50	110	
Tek rruga Hasan Kushta	30	3	6.6	
Total	4878.7	482.14	1086.6	

Sinjalistika rrugore

Ne sektorin e sinjalistikës është punuar për vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale

Jane bere vijeziomet e kembesoreve pergjate lungomares

Jane bere vijeziomet e korsive te bicikletave

Jane bere vizimet e kembesoreve ne bulevardin Vlore Skele

Jjane bere vijeziomet e kembesoreve ne unazen parallel me lungomaren

Pastrimi I plazheve publike

Është kryer pastrimi në plazhin e vjetër nga mbeturina detare (leshterike) si dhe mbetje të tjera, si dhe largimi i tyre në sasinë prej 300 ton.

Plazhi I Akademisë pastruar periodikisht nga mbetjet detare si dhe mbeturina të tjera në sasinë prej 200 ton.

Plazhi i ri është pastruar periodikisht sidomos në sasi mbetje detare në fundin e këtij plazhi pranë fushave të sportit, vend ku grumbullohet sasia më e madhe e këtyre mbeturinave, prej 250 ton.

Plazhet janë mirëmbajtur edhe duke u pluguar dhe sistemuar sipërfaqja e rërës si dhe pastrimi i shkallëve të trotuari përgjatë lungomares nga rëra dhe mbaturinat.

Ishulli pastrohet ditë për ditë nga mbetjet detare dhe mbeturinat.

Riparim trotuare:

Është ndërhyrë pjesërisht në vendet në të cilat trotuaret kanë ceduar

Rruga " Ali Demi " janë riparuar 32 m2

Trotuari para Shkollës " Jani Minga " 13 m2

Në trotuarin e Lungomares 12 m2

Tek shkolla " Ibrahim Kushta " 45 m2

Tek blloku pallateve pas Sigurimeve Shoqërore 43 m2

Në sinjalistikë horizontale:

Janë vendosur tabela që kanë munguar në rrugët " At Kristo Negovani , në rrugën "Anita Bitri" , "Riza Salati" , "Gjergj Aranti" , Unaza e qytetit.

Në sinjalistikën horizontale:

Janë vizuar vend qendrimi taksi, tek rruga "Parlat Rrexhepi" pranë Bashkisë , në rrugën Sazani.

Në rrugën “Gjergj Araniti”, “Demokracia”, rreth - rrotullimi Pusi Mezinit rreth-rrotullimi pranë shkollës së Aviacionit.

Janë kryer së fundmi vijëzimet e Longomares

Ne sektorin e sinjalistikës është punuar për vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale

Jane bere vijezimet e kembesoreve pergjate lungomares

Jane bere vijezimet e korsive te bicikletave

Jane bere vizimet e kembesoreve ne bulevardin Vlore Skele

Jjane bere vijezimet e kembesoreve ne unazen parallel me lungomaren

Betonime të ndryshme ne rruge dhe rugica

Në rrugën e unazës pranë Rrapit në Ujë të Ftohtë është bërë betonimi i një sipërfaqe prej 15 m².

Është ndërtuar trotuari përballë Club Itarus në pllaka si dhe beton në sipërfaqe prej 20 m².

Betonim i gropave në rrugën “At Kristo Negovani” pranë ish- Gjykatës së vjetër 10 m².

Betonim bazamante gabinës elektrike pranë Bashkisë.

Betonizim te sheshi para pallatit te haso 45 m³ beton

Betonizim pallati perball drejtorise se policies 60 m³

Riparim trotuari perball bibliotekes

Mbushje me cakell lulishte pran bibliotekes

Ndertim trotuari i ri perball ish kampit te puntoreve.

Ndertim trotuari i ri tek bishti i kalldre3mit.

Tek ish kinema ali demi ndertim ved koshash per mbeturina

Rruga dhimiter konomi ndertim vend kazanesh.

Tek shiku trotuar i riparuar me beton.

Riparim trotuari posta e coles.

Në situatën e reshjeve

Sektori I rrugë trotuare së bashku me mjetet e ndërmarrjes është angazhuar në çdo moment kur ka situatë rreshjesh për pastrimin e rrugëve, trotuare, kunata nga baltrat si tek ish - bobinazhi, unaza e qytetit, rruga “Demokracia” sheshi fabrika e tullave, në Pus Mezini.

BORDI KULLIMIT

Pastrimi i kanaleve kulluese dhe ujitëse

Gjatë këtij viti janë kryer këto volume pastrimi të kanaleve kulluese dhe ujitëse nga sektori i Bordit të Kullimit me mjete të renda eskavator nga vetë ndermarrja.

Duke u mbështetur me planifikimin dhe vjetor të 2022, pastrimet me mjetet eskavator nga vetë ndermarrja me 2 Volvo, 1 Fiat-Hitachi krahëgjatë si dhe Cat305 është planifikuar:

Pastrim i kanaleve kulluese të II dhe të III **52.91 km** **68,500 m³**

Volumet e kryera janë në:

Njësitë Administrative Novose 24.62 km me një volum 34.445 m³.

Nj.A. Shushicë janë 22.65 km me një volum 13.188 m³.

Njësitë Administrative Qëndër 14.7 km me një volum 6,447 m³

Njësitë Administrative Orikum 9.94 km me një volum 14,420 m³

Pastrimi i vaskave të Hidrovorit të qytetit nga llumrat dhe mbeturinat të kryera nga Fiat-Hitachi.

Ngritja e argjinaturës anës lumit në Mifol me një gjatësi 1330 ml

Mbyllja e hausit të hapur anës autostradës në Novoselë, nga dalja e lumit Vjosë në muajin Dhjetor 2021.

Ndërhyrje emergjente nga mjete Fiat-Hitachi për fikjen e zjarrit dhe mbulimin me dhe të grumbullimi i mbeturinave të qytetit të Vlorës.

Pastrimin e inerteve të Pylli i Sodës nga 2 Volvot.

a) Gatishmëria e hidrovorit të qytetit

Gatishmëria e hidrovorit të qytetit nga Janari deri në Gusht ka qenë e mirë

Është përballuar rënia e reshjeve si dhe ujërat e përditëshme që dalin nga qyteti i Vlorës.

Për sa i përket pompave aksiale të hidrovorit:

-Nga 4 pompa punojnë 3

-Kapaciteti nga 16m³/s në 11.5m³/s

-Gatishmëria 72%

Arsyet janë këto:

-Amortizimi i lartë i pompave

-Difekt i rëndë në pompën 2, Ganz500

-Amortizimi i kapakëve të shkarkimit të pompave të vogla.

Në shtator do të kryhen shërbimet në kapakët, sistemin elektrik dhe sistemin mekanik të pompave.

Me gjithë amortizimin e madh të Hidrovorit në përgjithësi gatishmëria është e kënaqshme por që sidoqoftë duhet të vlerësohet përmirësimi për të ardhmen duke bërë projektet përkatëse.

Për këtë problem (amortizimin e madh të Hidrovorit) kërkohet nga instancat e larta zëvendësimin e pompës 2 Ganz500 të cilën e kemi kërkuar edhe në projekt-buxhetin AFM 2022-2024, si dhe projektimin dhe zëvendësimin e tubacioneve të shkarkimit më gjithë kapakët e 2 pompave të vogla me kapacitet 2.5m³/s secila të cilat janë më praktike në kohë normale.

SEKTORI DDD

Sektori i shërbimit DDD gjatë vitit 2022 ka realizuar dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim në çerdhe, kopshte, shkolla, vendstrehime, lulishte, parqe, dhe mjedise publike., sic janë shkollat, kopshtet dhe çerdhet dy herë në vit, si edhe në rastet kur ka ankesa nga këto institucione publike. Ndërhyrjet për blatat ose furrtaret në kuzhinat e kopshteve dhe çerdheve bëhen dy herë në vit, ndërsa për brejtësit ndërhyhet një herë në vit.

Për të siguruar garantimin e sigurisë së shëndetit sektori DDD zbaton një plan masash profilaktike për kufizimin ose eliminimin e brejtësve në rast kontakti, si edhe të insekteve që rrjedhimisht sjellin probleme në ambjentin e gatimit. Preparatet që perdoren janë konform rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Rregullores 528/2012 të BE 'Për produktet biocide'

Gjatë këtij viti janë kryer dezinfektim pranë pallateve fillimisht duke inspektuar vatrat e infeksionit si bodrume e mcr dhe më pas ndërhyrja me preparat për dezinfektimin e tyre. Inspektimet dhe desinsektimet kryhen çdo ditë të javës nga e hëna deri të shtunën në vatrat e evidentuara më parë dhe në rast konstatimi të reja.

Në Rajonin 1 është realizuar inspektim, dezinfektim dhe dezinfektim si më poshtë:

- Banesë pranë Shkollës 9 vjeçare "**4 Heronjtë**"
- Katllavanit të ish Kinema "**Ali Demi**"
- Pallat pranë Spitalit me parkim të kontaminuar me ujë të ndotur. Në këtë ndërtesë ka prezencë uji në katin e nëndheshëm.
- Pranë AKU është higjenizuar hapsira brenda dhe jashtë koshave të mbeturinave, të cilat ishin me mbeturina organike dhe inorganike..
- Pranë Shkollës 9 vjeçare "**28 Nëntori**" është higjenizuar dhe dezinfektuar hapsira rreth koshave të mbeturinave.
- U dezinfektuan ambjentet e shkollës "**Teli Ndini**"
- U dezinfektua shkolla 9 vjeçare "**4 Heronjtë**"
- U realizua dezinfektim në ambjentet e kopshtit **N:5**
- Janë dezinfektuar zyrat të **Dega e Thesarit** pasi janë konstatuar punonjës pozitiv ndaj **Covid-19**
- U dezinfektuan zyrat të **Prefekturës** për shkak të konstatimit të **Covid -19**
- U dezinfektuan ambjentet të "**Drejtoria Rajonale Tatimore**" si pasojë e konstatimit të **Covid-19**.

Në Rajonin 2 është realizuar inspektim përgjatë kanalit të Siavit dhe është ndërhyrë për dezinfektim në hapsirat që janë evidentuar problematike.

- U realizua inspektim pranë zonës së quajtur "Ish Reparti Ushtarak,, duke ndërhyrë me procedurën e dezinfektimit e dezinfektimit për zvogëlimin e vatrës së infeksionit në parkimin e nëndheshëm është jo funksional me prezencë të mbeturinave.
- Inspektim dhe dezinfektim përgjatë Lungomares rreth koshave të mbeturinave.
- Janë higjenizuar hapsirat brenda dhe jashtë koshave të mbeturinave pranë Shkollës së Marinës.
- Janë dezinfektuar ambjentet të **Spitali Psikiatrik**
- U realizua dezinfektim dhe deratizim në ambjentet e jashtme të **Kopshtit Nr.8**
- Dezinfektim në ambjentet e brendshme të shkollës së mesme "**Mustafa Qemal Ataturk**".
- Është dezinfektuar dhe deratizuar ambjentet e jashtme dhe brendshme të Kopshti "**1 Maj**".
- Janë dezinfektuar hapsirat përreth Stadiumit Flamurtari, si edhe mcr Brenda nje banese prane aneksit të Stadiumit "**Flamurtari**"
- U dezinfektuan ambjentet e jashtme dhe të brendshme të "**Shtëpia e Foshnjës**".
- U realizuan dezinfektim dezinfektim dhe deratizim në **Qendrën e Zhvillimit PAK**

Në Rajonin 3 është zhvilluar inspektim dhe dezinfektim në Mcr, banesa të braktisura e parkime të nëndheshme si më poshtë:

- Mcr pranë **Kopshtit Nr.2**.
- Dy Mcr(vendstrehime) në dy banesa të ndryshme pranë shkollës 9 vjeçare "**Musa Çakërri**".

- Shtëpi të braktisura pranë shkollës 9 vjeçare "Musa Çakërrri", të cilat janë vatër për brejtësit, të cilat është dezinfektuar e deratizuar.
- Inspektim dhe dezinfektim pranë Këndit të Lojrave dhe te Blloku i banimit te ish Kombinati
- Është realizuar dezinfektim dhe deratizim në **Çerdhen Nr.4**
- U dezinfektuan ambjentet e jashtme dhe të brendshme të Shkollës së mesme "Ali Demi".
- U dezinfektuan ambjentet e jashtme dhe te brendshme te Kopshtit "Lef Sallata"
- U realizua dezinfektim në shkollën e mesme artistike "Naim Frashëri"

Në **Rajonin 4** janë dezinfektuar ndërtesa por edhe ambjentet rreth pallateve, të cilat janë:

- Pallat me bodrum me numër 1258
- Pallati 1267 me bodrum me ujë të ndotur
- Pallat me numër 1300 pranë Shkollës "15 Tetori,, i cili ka bodrum me ujë të ndotur si edhe vatër për brejtësit pasi ka mbeturina shtazore dhe jo shtazore përreth tij..
- Pallate rreth Postës së Çoles nr.1281, nr.1267.
- Pallat nr.1286 zona mbrapa Shkollës "Jani Minga" me ujë të ndotur.
- Pallat 1365 mbas Shkollës 9 vjeçare "Marigo Posio"
- U dezinfektuan ambjentet e **Kopshtit N.7**
 - U realizua dezinfektim në ambjentet e **Çerdhes Nr.2**
 - Dezinfektim dhe deratizim në **Kopshtin Nr.11**

Në **Rajonin 5** kemi evidentuar problematika në pallate të ndërtuara para viteve 90 dhe kemi ndërhyrë për minimizimin e problematikës përkatësisht:

- Pallat në Rrugën Demokracia nr.1982, i cili ka prezencë uji të ndotur potencial vatre infeksioni.
- Pallat prane Sahatit të qytetit me kat të nëndheshëm me ujëra të ndotur dhe dezinfektim i ambjentit përreth tij.
- Është kryer disinfektim rutine në pallatin e ashtuquajtur "6 katëshi,, kemi prezence uji të ndotur në bodrume. Gjendja në këtë pallat është jo e mirë.
- Është ndërhyrë me preparat dezinfektues mcr pranë **Kopshtit Nr.3** për minimizimin e vatrës, e cila ka potencial për zhvillimin e artropodëve me impakt në shëndetin publik, pasi bëhet shpesh herë vend akumulimi për mbeturinat mbeturina inerte e fekale
- Janë dezinfektuar dhe deratizuar ambjentet e jashtme dhe të brendshme në **Kopshtin Nr.2**
- Është dezinfektuar Kopshti "Zigur Lelo"dhe Shkolla 9 vjeçare "Zigur Lelo"
- U dezinfektuan ambjentet e jashtme të **Kopshtit N.14**
- U dezinfektua dhe u deratizua shkolla e mesme "Halim Xhelo"
- U inspektuan ,dezinfektuan dhe deratizuan **Çerdhja Nr.4** dhe **Çerdhja Nr.15**
- **DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE**

Gjatë vitit 2022 janë realizuar dhe kryer këto projekte dhe shërbime sipas sektorëve përkatës;

A. SEKTORI I INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

1. Verifikimi i problematikave të qytetarëve dhe institucioneve te arsimit në terren
2. Korespondenca me ndërmarrjet dhe qytetarët
3. Hartimi i projekt - preventivit të tualeteve të shkollës “ Ismail Qemali”
4. Hartimi i projekt-preventivit të tualeteve të shkollës “ Jani Minga”
5. Verifikimi i problematikave të ngritura nga portali dhe kthimi i përgjigjeve.
6. Hartimi i projekt - preventivit “ Rikonstruksion i banesave të komuniteteve të varfëra dhe të pafavorizuara”
7. Hartimi i projekt - preventivit “ Ndërhyrje riparimi në cerdhe, kopshte dhe shkolla, Bashkia Vlorë”
8. Llogaritja e tarifave te supervizim-kolaudim si dhe fuqisë punëtore dhe kategorisë së licencave për të gjitha objektet e tenderuara.
9. Ndjekja e punimeve në projektin “ Rikonstruksion i tualeteve të shkollës Jani Minga”.

B- SHERBIMI I PASTRIMIT TE QYTETIT

Pastrimi i Njesise Administrative Orikum realizohet nga firma ne sipermarje “Bajtel” sh.p.k.

Nga ana e kompanise realizohen keto sherbime:

Largim transport mbeturinash

Fshirje e rugeve

Larje e rugeve

Sistemim mbeturinash

Pastrimi ne njesite administrative Novosele, Qender, Llakatund realizohet nga firma ne sipermarje “Rej” sh.p.k

Nga ana e kompanise realizohen keto sherbime:

Largim transport mbeturinash

Fshirje e rugeve dhe shesheve

Kontrata per pastrimin e qytetit eshte nje kontrate 3 vjeçare me shoqërinë “Duka”shpk Nga ana e firmes kryhen keto sherbime:

Largim, transport i mbeturinave urbane	140 T
Sistemim ne fushen e grumbullimit	140 T
3. Fshirja e rugeve (manuale + auto) 557910 + 188042	745 952 m2
4. Larja e rugeve me uje.	417 170 m2
5. Lag’je e rugeve me uje	417 170 m2
6. Larje e shesheve dhe trotuareve	69 345 m2

Largim, transport i mbeturinave urbane.

Në qytet janë rreth 1050 kontenierë të shpërndarë në 390 pika grumbullimi dhe është planifikuar 140 ton mbeturina në ditë, nga te cilat themi se 1/3 janë mbetje të papranueshme (inerte, elektroshtepiake, mobilje, krasitje kopshtesh etj) te hedhura prane konteniereve, pra rreth 45ton.

Heqja e mbeturinave realizohet në këtë mënyrë:

Gjatë gjithë vitit mbetjet urbane hiqen 1 here ne 24 ore pas ores 22:00 ne 7 dite te javes.

Gjatë sezonit turistik (15 qershor – 15 shtator), 100 pika grumbullimi (në rrugët kryesore dhe pranë zonës turistike) hiqen dy herë në ditë, për të mos pasur konteniere të tejmbushur, pasi gjenerimi i mbetjeve urbane është më i madh.

Sistemimi i mbeturinave

Çdo ditë në fushën e grumbullimit sistemohen të gjitha mbeturinat urbane që grumbullohen në qytet, të cilat shtypen me fadromë dhe hapen vasketa të reja për hedhjen e mbeturinave.

Fshirja e rrugëve.

Fshirja e rrugëve, trotuareve, shesheve dhe blloqeve të banimit kryhet një herë në 24 orë dhe 6 ditë në javë, në oraret 23.00 - 07.00, në një sipërfaqe prej 557 910 m² me punëtor dhe 188 042 m² me autofshesa. Fshihen me punëtor blloqet e banimit, rrugët e brendëshme të lagjeve, trotuaret.

Fshihen me autofshesë rrugët me infrastrukturë të rregullt.

Gjatë procesit të fshirjes zbrazen koshat e vegjel në shetitore dhe bulevard, gerryhen anët e kunetave, priten barerat.

Larja e rrugëve me ujë

Shërbimi i larjes me ujë realizohet në rrugët me kunetë të rregullt për shkarkimin e ujrave, për eliminimin e baltës dhe pluhurin në rrugë. Larja e rrugëve kryhet një herë në 24 orë në oraret 02:00 – 06:00 (10 muaj) nga marsi – dhjetor me ane të autoboteve lares, në një sipërfaqe prej 417170m² me 0,5 lit/m²

Lag'ja e rrugëve.

Lag'ja e rrugëve realizohet mbasditë 16:00 – 18:00 (10 muaj) për të evituar pluhurin dhe freskuar ambientin. Lagen të njëjtat rrugë të cilat lahen në mëngjes.

Larja e shesheve dhe trotuareve

Ky shërbim realizohet gjatë gjithë vitit 4 herë në muaj, në një sipërfaqe totale prej 69 345 m².

Larja e trotuareve kryhet me një makinë të posaçme.

Trotuaret që lahen janë: Bulevardi Ismail Qemali (Trotuaret), sheshi Pallati i Sportit – Stadiumi, sheshi i Skelës – sheshi Pavarësia.

Gjatë gjithë periudhës i është kërkuar kompanisë së pastrimit të rrisë cilësinë e shërbimit. Gjatë kontrolleve në terren, është rritur kërkesa e llogarise për rritjen e performances nga ana e firmes dhe duke filluar nga muaji mars 2021, është bere ndalese në situacione për punë të pakryer

Po ju paraqesim një informacion mbi situacionet e kompanisë së Pastrimit “Duka”shpk për vitin 2022.

Muaj	Situacioni sipas “Duka”shpk	Situacioni sipas faktit	Diferenca	Detyrimi për tu paguar
Janar	18 057 239	15 416 704	2 640 535	Likujduar
Shkurt	17 200 736	14 537 021.2	2 663 714.8	14 537 021.2
Mars	19 856 009	15 401 372.11	4 454 636.89	15 401 372.11
Prill	19 570 509	15 341 957	4 228 552	15 341 957
Maj	19 856 009	15 321 989.2	4 534 019.8	15 321 989.2

Qershor	19 570 509	14 894 682	4 675 827	14 894 682
Korrik	19 856 009	15 414 780.2	4 441 228.8	15 414 780.2

Për muajtë e tjerë të vitit 2022 nga subjekti Duka nuk është pranuar të bëhet ndryshimi i situacioneve sipas faktit dhe rrjedhimisht nuk janë shlyer faturat sips pretendimit të tij. Theksojmë gjithashtu se gjatë vitit 2022 shërbimi i pastrimit nga subjekti Duka ka patur problematika. Për këtë qëllim dhe rritjen e kontrollit të shërbimit është edhe urdhri i Kryetarit të Bashkise Nr.198 prot. dt.10.09.2020 për Rajonet e qytetit, ku kërkohej prej tyre të jenë pjese integrale e kontrates me kontrollet e tyre të përditshme në territorin e njësisë së tyre administrative dhe informacionin javor mbi shërbimin e pastrimit në Rajonet respektive.

Çdo ditë gjatë kontrolleve në terren behen foto dhe video të cilat i dërgohen firmes së pastrimit për të normalizuar situatën. Shërbimet e pastrimit kanë orare të përcaktuara, prandaj nga ana e qytetareve kërkohej një sensibilizim shumë i madh për të mirëmbajtur dhe ruajtur pastertinë në qytet.

Gjatë muajit maj, për të përmirësuar dhe rritur cilësinë e shërbimit, nga ana e firmes së pastrimit është punuar me forca të përqendruara gjatë ditëve për prerjen e barerave të mbira në trotuare dhe ane të kuletave në blloqet e banimit si blloku Isa Boletini, blloku i Orizit, blloku pas shkolles Industriale etj.

Në bashkëpunim me bankën gjermane KFË është realizuar zëvendësimi i konteniereve për grumbullimin e mbetjeve urbane, ndërtimin e bazamenteve dhe implementimin konteniereve të nendheshëm në zonën e Lungomares.

Një rëndësi e veçantë duhet të kushtohet edhe edukimit publik nëpërmjet medias televizive e asaj të shkruar, flete palosje dhe postera, për sensibilizimin e komunitetit për mbajtjen pastër të qytetit, hedhjen e mbeturinave në vendin dhe kohën e caktuar.

C- SEKTORI I NDRIÇIMIT PUBLIK

Gjatë vitit 2022 Sektori i Ndricimit në Qytet ka synuar që brenda mundësive dhe buxhetit në dispozicion të realizojë shtrirje të ndricimit në gjithë zonat e banuara.

Ndrichimi publik në Qytet, përfshin rrjetin e ndricimit të shpërndarë si më poshtë:

- ndriçimi i rrugëve kryesore dhe dytësore
- ndriçimi i shesheve
- ndriçimi i parqeve dhe lulishteve

Në dispozicion të shërbimit të ndriçimit publik për qytetin janë:

- Numri i pikave të furnizimit të energjisë (kabinave elektrike) që kanë kontratë 209 copë aktive, 25 copë të ngrira
- Numri i ndriçuesve të instaluar 7182 copë

Në territorin urban të qytetit ka 3 lloje shtyllash:

- dekorative: të cilat gjenden në zonat pedonale dhe disa nga parqet e qytetit;
- çeliku: pothuajse të gjitha të zinkuara, përbëjnë pjesën dominuese të shtyllave që shërbejnë për ndriçimin e qytetit;
- betoni: shtyllat i përkasin OSHEE, por ndriçuesit janë të Bashkisë.

Duke vlerësuar drejt situatën e Ndricimit Publik si dhe rëndësinë tepër të madhe që ka për sigurinë e qytetarëve dhe në fushën e turizmit, gjatë këtij viti janë realizuar këto shërbime:

Çmontimi dhe magazinimi i dekorit ekzistues të festave të fundvitit.

Riparimi i 30 prozhektorëve 1000Ë në fushat sportive pranë lungomares.

Zëvendësimi i kabllit të dëmtuar në rrugën “Dhimitër Konomi”.

Riparimi i difekteve elektrike në ambientet e Gjendjes civile dhe Tatimeve.

Riparimi i ndriçimit në ambientet e Bashkisë.

Zëvendësimi i kabllit të dëmtuar në rrugën “Kosova”

Riparimi i ndriçimit në rrugën “Enver Jaho”, “Tare Celo”.

Vendosja e dy shtyllave metalike profil drejtkëndor 120x80x3mm H=6M në rrugën “Demokracia”

Vendosja e dy shtyllave metalike profil drejtkëndor 120x80x3mm H=4.5m 50Ë. Në rrugën “Fejzo Mema”

Vendosja e shtyllave të ndriçimit në rrugën “ Sulejman Delvina”, “Unaza”, “Zenel Murra”, “Reshat Osmani”.

Maj- Gusht 2022

Riparimi i ndriçimit në rrugën Dervish Hekali, Sokrat Leka.

Riparimi i ndriçimit në rrugën Gjergj Arjaniti, Veledin Kollozi.

Riparimi i ndriçimit në rrugën Aleksandër Moisiu

Riparimi i difekteve elektrike, zëvendësimi i linjave elektrike të amortizuara.

Riparimi i ndriçimit në rrugën Fiqiri Muka, Dush Strati.

Riparimi i ndriçimit pranë komisaritatit të policisë.

Riparimi i ndriçimit te lulishtja “Tre Racat”.

Riparimi i ndriçimit në rrugën “Hajredin Danushi”, “Zaho Koka”, “ Mis Durhan”.

Riparimi i ndriçimit në rrugën “Andrea Varfi”.

Vendosja e ndriçuesave Led 100Ë në rrugën Dush Strati.

Riparimi i ndriçimit në rrugën Shaban Demiraj dhe 4 Heronjtë.

Zëvendësimi i ndriçuesave 100Ë dhe 50 Ë në rrugën Shaban Demiraj.

Riparimi i ndriçimit në rrugën Fiqirete Musta.

Gjithashtu janë bërë punime për ndricimin public edhe në njësite administrative;

N.J.A. QENDËR

Riparimi i 50 ndriçesave 250Ë në Nartë

NJ.A.SHUSHICË

Riparimi i ndriçesave 250Ë dhe mirmbajtja e ndriçimit.

NJ.A.NOVOSELË

Zëvendësimi i kabllit të dëmtuar dhe riparimi i difekteve në panelat elektrikë.

Zëvendësimi i 10 ndriçesave 100Ë në fshatin Trevllazër.

NJ.A.ORIKUM

Riparimi i 70 ndriçesave 250Ë.

Vendosja e ndriçimit në fshatin Tragjas 5 Ndriçes 100Ë

Zëvendësimi i 25 ndriçesave 100Ë të dëmtuar në në Novoselë.

Në qytet dhe në Njësitë e tjera administrative situata e ndriçimit është si më poshtë:

- Nj.A.Orikum: Në Orikum dhe në Fshatrat ka 357 ndriçes
- Nj.A.Qendër: Në Kaninë ka 75 ndriçes. Në Nartë ka 40 ndriçes. Në Babicë të Madhe ka 145 ndriçes
- NJ.A.Novoselë: Në Novoselë dhe në Fshatrat ka 630 ndriçes
- Nj.A.Shushicë ka në total 180 ndriçes.

D- SEKTORI I STREHIMIT

Gjatë vitit 2022 në këtë sektor është punuar për realizimin e këtyre programeve;

1. Programi I përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara.
 - i. Shqyrtimi I kërkesave të regjistruara pranë institucionit
 - ii. Verifikimi në terren në bashkëpunim me grupet e punës të ngritura me urdhërin e brendshëm të kryetarit të kushteve të banimit, duke bërë vlerësimin e nevojave për ndërhyrje në këto banesa dhe matjet për hartimin e preventivave
 - iii. Përgatitja e dokumentacionit dhe e kërkesës për bashkëfinancim drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila është financuese kryesore e projektit
2. Kanë vijuar aplikimet për zbatimin e programit për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët në apartamentet e ndërtuara nga Enti Kombëtar I Banesave në territorin e ish-frigoriferit në lagjen “Kushtrimi” Vlorë, sipas kërkesës së bërë nga Këshilli I Bashkisë Vlorë për shtyrjen e afatit të aplikimeve edhe për tre muaj
3. Kanë vijuar aplikimet deri në datën 3 maj në zbatim të programit për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët nëpërmjet subvencionimit të interesave të kredisë nga buxheti I shtetit, për 62 kredi të paplotësuara nga numri prej 140 kredi të akorduara nga ministria përgjegjëse për strehimin në vitin 2020.
4. Kanë vijuar aplikimet nga familjet e pastreha që banojnë me qira në treg të lirë për të përfituar subvencionin e qirasë nga buxheti I Bashkisë Vlorë për vitin 2022.
 - I. Është bërë shqyrtimi I kërkesave dhe I dokumentacionit

- II. Verifikimi në terren në bashkëpunim me rajonet për të verifikuar kushtet e banimit sipas kontratave të qirasë
 - III. Është bërë përzgjedhja dhe klasifikimi nga Komisioni I Strehimit të Bashkisë
 - IV. Përgatitja e project-vendimit dhe paraqitja në Këshillin e Bashkisë Vlorë për të miratur familjet përfituese
 - V. Janë hartuar formularët e subvencionimit të qirasë për familjet/individët përfitues një nga një dhe I janë përcjellë Qendrës Ekonomike për kalimin e shumave të lekëve.
5. Është përgatitur project-vendimi dhe kalimi në KB për familjet që përfitojnë pagesat e qirasë , në vitin e dytë të financimit, pas prishjes së banesave nga zbatimi I projektit të rikonstruksionit të rrugës Transballkanike me Portin Detar Vlorë
 6. Është bërë administrimi dhe shqyrtimi I dokumentacionit, si edhe vlerësimi I subvencionit të qirasë për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë të kategorisë së prekur nga zbatimi I projektit lidhja e rrugës Transballkanike me superstradën Fier-Vlorë. Është përgatitur project-vendimi për miratim në Këshillin e Bashkisë Vlorë.
 7. Janë kryer gjithë procedurat dhe është përgatitur project-vendimi për të miratuar listën e familjeve dhe individëve, që përfitojnë banesë më kosto të ulët nëpërmjet kredive me kushte lehtësuese nga buxheti I shtetit.
 8. Janë përgatitur shkresat dhe listat me emrat e familjeve/individëve të miratuara në Këshillin e Bashkisë dhe janë përcjellë në tre bankat e përzgjedhura nga ministria për vazhdimin e procedurave, në Entin Kombëtar të Banesave dhe MF&E
 9. Është përgatitur project-vendimi për të miratuar në KB listën e dytë të familjeve/individëve, që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë.

E-SEKTORI I TRANSPORTIT

Sektori i transportit ndjek dhe zbaton procedurat përkatëse për nxjerrjen e licencave dhe certifikatave për transport rrethqytetës , qytetës ,taksi ,agjensi transporti dhe licencë tregtim karburanti bazuar në Ligjin 8308 datë18.08.1998 "Për transportet rrugore" , i ndryshuar, VKM dhe udhëzimeve të MIE.

Gjate vitit 2022 është bërë licensimi i të gjithë atyre subjekteve të cilët kanë paraqitur kërkesat për licensim.

1-Taksi 4+1 janë licensuar 32 mjete. Në Bashki janë të licensuara rreth 124 mjete, tksi 4+1 me afat 5 vjecar.

2-Taksi 8+1 janë rilicensuar 7 mjete, me aftat 5 vjecar.

2-Certifikata për transport mallrash për llogari të vet janë 104 copë, për transport mallrash për të tretë janë 38 copë, licencë transporti mallrash për të tretë 8 copë, me afat 5-vjecar.

3-Certifikata mjetesh rrethqytetase 49 copë.

4- Çertifikata për transport udhëtarësh për llogari të vetë, për 41 mjete.

5-Çertifikata qytetase 10 copë.

6- Drejtoria jonë pajisë me licencë tregtim karburanti subjektet të cilat tregtojnë karburant.

Subjekte aktive në territorin e bashkisë janë 43 copë nga këto 30 janë të pajisur me licencë 5 vjecare.

Janë zbatuar dhe rekomandimet e lëna nga KLSH, duke bërë pagesën sipas diferencave të lëna. Pa paguar licencën janë 16 subjekte dhe 4 skane paguar diferencën e KLSH.

Në subjektet e palicensuara janë bërë njoftimet përkatëse.

7-Shërbimi i transportit urban në qytet kryhet nga subjekti "Urban Trans Vlora". Në këtë shërbim i është kushtuar vëmendje e veçantë rritjes së cilësisë së transportit urban duke u shërbyer sa më mirë komunitetit

8-Taksa e parkimit është vjelë nga të gjithë subjektet në momentin që subjekti pajiset me lic+certif, dhe vlefata e taksës së parkimit bëhet në bazë të VKB .

Të gjithë subjektet të cilat kërkojnë parkim para subjekteve të tyre paguajnë taksën e parkimit me pagesë, në bazë të një kontratë të lidhur me Bashkinë Vlorë me një afat një vjeçar dhe pagesa sipas VKB. Gjatë këtij viti janë dhënë parkime me pagesë 46 vendparkime.

9- Sinjalistika rrugore horizontale dhe vertikale është bërë nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, duke bërë vijezimet në rrugë dhe vendosje tabelë në vendparkimet e mjeteve taksit, transport rrethqytetës, interurban dhe ndërkombëtar si dhe vijezimet para institucioneve arsimore.

Problem i madh në sinjalistikën vertikale mbetet mungesa e semaforëve në pikat me problematike në qytet.

Komunikimi me qytetarët në vijimësi ka qënë korrekt, është gjetur një bashkëpunim i mirë me ta duke mos patur probleme në këtë drejtim dhe duke bërë të mundur zgjidhjen e problemeve të tyre.

F. DEKOR-FUNERAL

Një shërbim që i ofrohet qytetarëve është dhe shërbimi i funeralit, i cili realizohet nëpërmjet firmës "K&N" e kontraktuar nga bashkia me afata 1 (një) vjeçar .

Për vitin 2022 janë kryer punimet e mëposhtme;

-Mirëmbajtje sipërfaqe bari 52.274 m² ku kryhen këto procese të punës :kositja bari 3 herë ,krehje e sipërfaqeve të gjelbërta (mbas cdo korrje),grumbullimi dhe largimi i mbeturinave
Mirëmbajtje rrugë dhe sheshe me sipërfaqe 18.500 m². Ku hyjnë zërat e punimeve :-
fshirje ,grumbullim,mbeturina,transport .Mirëmbajtja e tyre bëhet cdo muaj.

-Mirëmbajtje drutë e rrugës 150 copë ku hyjnë zërat e punimeve :
punime 2 herë,krasitje në masën 30% ,mbjellje, zvendësim të pemëve të dëmtuara,
plehërim kimik,spërkatje 1 herë.

Punimet kryehen sipas grafikëve të punimeve të përcaktuar në kontratë të cilat ndiqen në mënyrë kronologjike nga mbikqyrësi.

-Të dhënat për varrezat e Dëshmorëve Vlorë dhe punimet që kryehen për mirëmbajtjen e tyre.

Sipërfaqja e varrezave të dëshmorëve 12.300 m² nga këto sipërfaqe varroshesh 1050 m² me një numër varrezash 963

Sheshe dhe shkallë me sipërfaqe 7046 m²

-Sipërfaqe e gjelbërt 3523 m²

Sipërfaqe gjelberimi sezonal 678 m²

Gardh i gjelbërt 452 ml

Shkurre 200 copë.

Punimet që janë kryer për këtë katër mujor në varrezat e dëshmorëve janë për sa mëposhtë.

-Mirëmbajtje sheshe e shkallë sipërfaqen 7046 m²

-Fshirje,pastrim fuga,grumbullim mbeturina.transport i mbeturinave

-Mirëmbajtje gardh i gjelbërt 452 ml .hyjnë zërat e punimeve

-Punim 3 herë,dhënie forme 4 here,heqje mbeturina,mbjellje,ujitja 8 herë,plehërim kimik
 -Mirëmbajtje shkurre 200 copë, hyjnë zërat e punimeve :
 Punim shkurresh.dhënie forme 4 herë,heqje mbeturina
 Mbjellje,ujitja 8 here .
 -Mirëmbajtje e luleve sezonale. 678 m2, hyjnë këto punime
 Shkulje e luleve 2 herë,grumbullim mbeturina. Capitje 2 herë,ujitje 8 herë,sperkatje 2 herë.
 Mirëmbajtje e varoshëve .
 Është bërë zëvendësimi i pllakave të varoshëve të dëmtuar për shkakë të efekteve atmosferike ,apo dhe dëmtime fizike .
 Është bërë larja e gjithë varrezave të dëshmorëve me acid,larja e monumentit,larja e shesheve dhe e shkallëve.
 Është realizuar dekorimi për çdo fest të përcaktuar në kontratë .
 Ky shërbim ofrohet në raste festash për qytetin dhe për Njësitë Administrative.

• MENAXHIMI I INTEGRUAR I MBETJEVE

Ecuria e punimeve në Qendrën Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve në Sherishtë

Ndërtimi i landfillit sanitar ka përfunduar 95% të punimeve ndërtimore të ndara sipas lot-eve më poshtë:

LOT 1

- Qeliza 1 – Kanë përfunduar punimet e dherave në të gjithë qelizën 1. Kanë përfunduar shtrimi i shtresave të izolimit në skarpat dhe bazamet, shtresat që përbëhen nga Geo Sintetic Clay, HDPE, dhe Gjeotekstil. Ka përfunduar shtrimi i tubove të gazit në të gjithë perimetrin e qelizës. Ka përfunduar puna për mbushjen me material drenazhi (50 cm zhavorr lumi i larë). Ka përfunduar mbushja e qelizës 1.1 dhe qelizës 1.2. Ka përfunduar shtrimi i tubove HDPE PN 16 DN 355 që shërbejnë për mbledhjen e leksiviatave. Rrethimi i të gjithë objektit ka përfunduar.
- Po punohet me gjelbërimin e nevojshëm për mbojtjen e skarpatave dhe me mbjelljen e pemëve dhe shkurreve dekorative.
- Qeliza 2 – Kanë përfunduar punimet e dherave në gjithë qelizën 2. Ka përfunduar dhe shtrimi i shtresave izoluese. Ka përfunduar shtrimi i tubove të gazit në të gjithë perimetrin e qelizës. Po vazhdon puna me mbushjen me material drenazhi (50 cm zhavorr lumi i larë). Ka përfunduar shtrimi i tubove HDPE PN 16 DN 355 që shërbejnë për mbledhjen e leksiviatave.
- Leachate storage pond (LTP) – Kanë përfunduar punimet e dherave dhe shtrimi i shtresave të izolimit. Ka përfunduar dhe mbushjen e sheshit me cakull. Eshtë dorëzuar në

kantier fabrika e trajtimit të leksiviatave. Kanë përfunduar lidhjet hidraulike të rrjetit të qarkullimit të ujit të ndotur në impiant. Kanë përfunduar lidhjet elektrike të impiantit të trajtimit të ujit. Është bërë testimi i lidhjeve elektrike.

Po punohet për testimin dhe kalibrimin e pjesës hidraulike dhe mekanike të impiantit LTP.

- Ndërtësa e Administratës – Kanë përfunduar punimet e betonit, elektrike, anti zjarri, kanalizimet dhe muratura. Kanë përfunduar linjat e brendëshme hidraulike dhe elektrike. Ka përfunduar instalimi i sistemit kapot dhe grafiato, aktualisht mungon vetëm lysterja. Po punohet me instalimin e dymve dhe dritaret e objektit. Po punohet me shtrimin e trotuarëve me pllaka përreth godinës së administratës.
- Ndërtesa e Oficinës (Ëorkshop) - Kanë përfunduar punimet e betonit, elektrike, anti zjarri, kanalizimet dhe muratura. Kanë përfunduar linjat e brendëshme hidraulike dhe elektrike. Ka përfunduar instalimi i sistemit kapot, janë vendosur qepenat dhe aktualisht mungon vetëm grafiato, lysterja dhe dymet e dritaret e objektit.
- Ndërtesa e parkimit (Canopy Hangar) – Kanë përfunduar të gjitha punimet.
- Sheshi administratës dhe MRF – Kanë përfunduar të gjitha punimet e dherave. Kanë përfunduar shtrimin i linjave nëntokësore si elektrike, IT, sistemi i kamerave, ujësjellësi, sistemi kundra zjarrit, kanalizimet, sistemi i vaditjes. Ka përfunduar testimi i linjave të ujësjellësit, sistemit kundra zjarrit dhe sistemit të vaditjes, dhe po punohet me testimin e linjave kanalizimeve. Ka përfunduar shtrimin i sheshit me asfalt.
- Rruga e aksesit – Kanë përfunduar të gjitha punimet e dherave dhe të strukturave mbajtëse (muret). Kanë përfunduar betonimet e kanaleve anësore dhe vendosja e shtyllave elektrike nga Sherishta deri në landfill. Ka përfunduar shtrimin i rrugës me asfalt.

LOT 2

- Ndërtesa MRF – Kanë përfunduar punimet e dherave dhe të betonit. Ka përfunduar të gjitha punimet metalike. Ka përfunduar shtrimin i linjave elektrike, IT, kundra zjarrit, kanalizimeve etj. në brendësi të sheshit të MRF. Ka përfunduar shtrimin i sheshit me beton të armuar dhe rifiniturat përkatëse.
- Kan ardhur dhe montuar në kantier në masën 95% makineritë e MRF.

LOT 3

- Janë porositur makineritë e parashikuara sipas kontratës për LOT 3 nga te cilat ka ardhur në kantier kompaktori, buldozeri, skrepi CAT dhe në ditët në vijim priten ardhja e të gjitha makinerive të mbetura.

Monitorimi i mbetjeve

MIM Vlorë ka përpiluar qasjen konceptuale të monitorimit të mbetjeve referuar kërkesave ligjore për monitorim dhe raportim (Ligji për Mbetjet, VKM-të, Rregulloret specifike). Cikli i monitorimit vlerëson performancën dhe ndikimin mjedisor.

Për t'iu përgjigjur monitorimit të parametrave, është porositur programi kompjuterik i cili do të shërbejë edhe për planifikimin e burimeve të ndërmarrjes, për menaxhimin e të dhënave sasiore dhe financiare në sistem. Ka përfunduar vendosja, testimi dhe kalibrimi i peshores në landfill. Peshorja do të shërbejë për të matur sasinë e mbetjeve që gjenerohen nga rajoni Vlora Veri, sasinë e mbetjeve që riciklohen dhe sasinë e mbetjeve që depozitohen në landfill.

Riciklimi (dhe kompostimi)

Ndërmarrja MIM Vlorë është përfshirë në aktivitetet e planifikimit për skemën pilot të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve me kontenierë depo në rajonin nr. 3 të qytetit të Vlorës, të drejtuara nga ekspertët e Konsulentit Institucional. Në fazën e parë të testimit është propozuar të instalohen 10 stacione me 3 kontenierë depo për lloje të ndryshme materialesh (kanaçe, shishe, kartona, ambalazhe). Projekti pilot do të paraprihet dhe shoqërohet nga një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi rreth ndarjes së mbetjeve në burim. MIM Vlorë ndërmori aktivitetet e para të ndërgjegjësimit mjedisor me disa shkolla në qytetin e Vlorës.

Në funksion të studimit të tregut për materialet e riciklueshme u vendosën kontakte me disa kompani riciklimi në Tiranë për të parë interesin dhe potencialin për bashkëpunim kur të fillojë puna në impiantin e ndarjes së materialeve.

Ka përfunduar plani mbi pikat e vendosjes së kontenierëve për mbetjet e riciklueshme në Rajonin Numër 3. Kontenierët për mbetjet e riciklueshme kanë ardhur dhe po punohet për shpërndarjen e tyre në qytet.

Rritja e ndërgjegjësimit dhe marrëdhëniet me publikun

Një sërë prezantimesh edukuese dhe ndërgjegjësuese u zhvilluan me nxënësit e shkollave ("Lef Sallata", "Ismail Qemali", "Internacional", etj.) në Vlorë, me miratimin e Zyrës Arsimore. Qëllimi i tyre ishte promovimi i mjedisit të pastër, reduktimit të mbetjeve, riciklimit dhe njohja me aktivitetet që do të kryhen në Qendrën Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve dhe mjetet e reja që do të vihen në shërbim të qytetarëve.

Gjatë vitit të kaluar MIM Vlorë punoi me Konsulentin Institucional për hartimin e një Plani për Komunikimin dhe Marrëdhëniet me Publikun në Zonën e Mbetjeve të Vlorës Veriore dhe mori pjesë në diskutime me përfaqësues të bashkive Vlorë e Selenicë rreth masave të propozuara, duke arritur një dakordësi në Dhjetor 2021. Pritet të miratohet nga Kfë financimi për realizimin e këtyre masave.

Gjatë vitit 2021 u realizua faqja elektronike e ndërmarrjes ëëë.mimvlora.al, si një mjet i rëndësishëm komunikimi dhe informimi për komunitetin. Ndërkohë që faqja në Facebook është përditësuar në mënyrë konstante me postime rreth zhvillimeve të reja dhe aktiviteteve të MIM Vlorë.

Gjatë vitit 2022 janë zhvilluar aktivitete dhe takime të ndryshme me shoqata mjedisore lokale dhe kombetare me qëllim bashkëpunimin për pastrimin e qytetit dhe rritjen e ndërgjegjesimit për mbajtjen pastër të mjedisit.

Janë zhvilluar aktivitete me shkolla 9-vjecare dhe gjimnaze publike dhe private me fokus edukim dhe sensibilizimin e popullatës rreth çështjeve mjedisore.

Nisma të ndryshme dhe aksione vullnetare për pastrimin e qytetit dhe specifiku zonën e Pyllit të Sodës janë ndërmarre nga MIM Vlora. Gjatë këtyre aksioneve vullnetare ka pasur pjesëmarrje nga shkolla të ndryshme, biznesi, administrata dhe qytetarë të thjeshtë.

Me ndihmën e konsulentëve të huaj është zhvilluar plani i PR dhe Marketingut të cilin do të ndjekë MIM Vlora. Është bërë përzgjedhja e sloganit të fushatës, posterat për kamionat dhe për kontenieert. Janë zgjedhur zonat e venosjes së kontenierëve. Është hartuar një raport i detajuar mbi planin dhe hapat e marketingut i cili është dërguar te KË dhe pritet miratimi i tij.

Plani vendor i menaxhimit të integruar të mbetjeve (PVMIM)

MIM Vlorë ka marrë pjesë në diskutime dhe ka kontribuar në hartimin e dokumentit të PVMIM të Bashkisë Vlorë si pjesë e Grupit të Punës të ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë. PVMIM të Bashkisë Vlorë ka përfunduar dhe pritet të miratohet nga Këshilli Bashkiak.

Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave

Bazuar në ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, të ndryshuar , në ligjin **nr. 49/2016** për disa ndryshime dhe shtesa në *Ligjin Nr. 9693 datë 19/03/2007 “Për Fondin Kullor”* të ndryshuar, dhe të VKM nr.684, dt. 2.9.2020 për disa ndryshime dhe shtesa në **VKM nr.433, date 8.6.2016** “Për transferimin në pronësi të Bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit

dhe aktualisht në administrim të MTM”, strukturat përgjegjëse për pyjet e kullotat pranë bashkise janë organi administrativ i shërbimit pyjor dhe përgjigjen për:

- ✓ sigurimin e mbrojtjes dhe
- ✓ për qeverisjen e qëndrueshme të pyjeve e kullotave
- ✓ Gjate kësaj periudhe janë realizuar detyrat dhe shërbimet e meposhtëme;
- Janë bërë kontrole mbi zbatueshmerin e ligjit dhe akteve nënligjore të kullotave, mbi fermerët:
 - Që ushtrojnë aktivitetin e tyre me bagëti në kullotat dimërore dhe verore dhe nuk paguajnë detyrimet tarifore.
 - Që aktualisht “përmiresojnë kullotat“ me ane të zjarrit.
- Janë bërë monitorime mbi mundësin e nevojave për meremetim lerash dhe vepra të tjera hidrike, me synim të riaftësimin të kapacitetit ujëmbajtës të tyre për sigurimin e ujit të pijshëm për blektorinë gjatë një sezoni kullosor dhe krijimin e “rezervave ujore“ (hidranteve) në rastet e rënies së zjarreve.

Treguesit/pritshmëritë - Mundësi përmirësimi dhe rehabilitimi.

- Puna jonë ka rezultuar në takime të realizuara me fermerët, që meren me mbarështrimin e blektorisë, për ato zona apo fshatra ku dhe tendenca e shmangies ndaj pagesës së kullotës ka patur shfaqjet e saja, si në fshatin Dukat dhe Tragjas. *Ai që kullotë duhet të paguaj.*

Për këtë periudhë, të ardhurat nga aktiviteti kullotës janë **643.000 leke**. Të ardhura këto nga kontratat e kullotave dhe 1 sipërfaqe në përdorim .

- Ka dal nevojja për **meremetim e veprave ujëpirëse malore** në kullotat, me synim të riaftësimin të kapacitetit ujëmbajtës të tyre për sigurimin e ujit të pijshëm për blektorinë gjatë një sezoni kullosor prej 6 muajsh.

Ndërkohë në kuadër të shkresës së Ministrisë së Ministrisë së Brëndshme, nr. 3754 prot dt. 13.07.2021 me lëndë: *“Kujtesë mbi detyrimet ligjore..... për marrjen e masave parandaluese për zjarret e stinës në sipërfaqet pyjore dhe kullota“*, nga ana e sektorit u rishikua edhe një herë përcaktimi i nevojave për ndërhyrje emergjente në kuadër të sigurimit të rezervave ujore. Në kuadër të kësaj shkrese, përcaktimi i veprave ujore për rehabilitim/ndërtim vëpër të re, u bë jo vetëm në funksion të gjëndjes aktuale të tyre, por edhe në kuadër të nevojës/rëndësis së habitatit.

Për sa më sipër sektori vendosi që shuma prej 3.500 000 lekë (nga të ardhurat e siguruar nga aktiviteti i kullotjes), caktuar nga Bashkia do të përdoret konkretisht në masivin pyjorë mbi fshatin Tragjas dhe kullotat dimërore mbi fshatin Rradhimë dhe Sotiran Dukat.

Janë përgatitur tre projekte për:

- ✓ Rehabilitimin e lerës Ali Maçit në ngastrën pyjore nr. 6 të ekonomisë Tragjas – Shengjergj
- ✓ Bërjen e një lere të re (çimentoje) në ngastrën nr. 48, EK Dukat-Tragjas-Shashicë
- ✓ Rehabilitimin e lerës në Sotiran fshati Dukat

Pyjet - Të vihet nën kontroll aktiviteti i ndërhyrjeve ilegale në pyje (prerje, zenie fondi, ndërtime)

- Janë kryer kontrole rutinë në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore që janë aktualisht në fuqi, për pyjet.
- Në saj të inisiativës së vet kryetarit të Bashkisë, z. Dritan Leli, është duke vazhduar aksioni për pastrimin e pyllit të Sodës nga mbetjet urbane dhe largimi i të gjithë drureve të rrëzuar, thyer apo shkullur nga era.
- Kemi bashkëpunuar me Njësitë Administrative dhe kryesitë e fshatrave në nivel Bashkie

Treguesit/pritshmeria - *Kontroll i aktiviteteve ilegale.*

- Mbrojtje më e mirë e formacioneve pyjore.
- Janë minimizuar aktivitetet pa leje, si prerje, zënie fondi, ndërtime pa leje e tjerë.
- Kemi realizuar dhe do realizojmë në vazhdimësi një pyll të pastër.
- Ka përfunduar Plani i Mbareshtimit për grup ngastrat pyjore 15.02.2022 – 15.02.2032, Për Ekonomine Pyjore ‘Kume Shashicë’ te Pylli I Sodës, i cili do të pasqyroj gjëndjen aktuale të këtij pylli, masat silvo teknike, që me realizimin e tyre do të cojnë në përmirësimin e situatës fito sanitare të tij, si dhe parashikimin e objektivave të tjera menaxheriale, gjithmon brenda legjislacionit shqipëtar për pyjet dhe statusit që i ka dhënë plani i pergjdhshem vendor.

Nuk kemi patur nderhyrje me prerje në fondin pyjore.

Zjarret - *Të vihet nën kontroll mbrojtja e pyjeve dhe kullotave nga zjarri. vecanërisht prej atyre te vëna me qëllim nga barinjët.*

- Eshtë përgatitur një program masash parandalimi dhe përgjigjja ndaj situatave emergjente që mund të krijohen nga zjarret për vitin 2022.
- Janë bërë takime për sensibilizimin e komunitetit të zonës, kryesisht të komunitetit të blegtorëve, me qëllim rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të tyre, *për të ndryshuar konceptin se zjarret përmirësojnë kullotat (të cilat janë në proces të përfunduar).*
- U realizua heqja e të gjitha llojeve të mbetjeve, të depozituara gjatë periudhës së viteve '90 e në vazhdim, përgjatë rruges auto Plazhi vjetër deri tek “kanali motorit”. U pastrua nga mbetjet dhe u zgjerua korridori parcelar që përshkon ngastrën pyjore nr 18, duke krijuar kushte të përshtatshme për lëvizjen e mjeteve zjarrfikëse në rastet e zjarreve.
- Në kuadër të mbrojtjes nga zjarri, po bëhet një studim në pyllin e Sodës (në kuadër të planit të mbarshtrimit), mbi krijimin e korridoreve antizjarr. Ky studim do të konkretizohet me një projekt i cili do të paraqes në menyrë të detajuar krijimin e korridoreve antizjarr në pyllin e Sodës.

Tabela e mëposhtme jep qartësisht situatën e zjarreve në pyje e kullota bashkiake për periudhën e Veres 2022.

- Rastet e zjarreve – 3
 - ✓ Pyje 3 raste
 - ✓ Kullota - raste
- Sipërfaqia e pershkruar nga zjarret, 20 ha
 - ✓ Në pyje 20 ha

Klubi Shumesportesh Flamurtari

Klubi Shumesportesh Flamurtari gjatë vitit 2022 kanë vazhduar aktivitetet zyrtare në Pallatin e Sportit Flamurtari dhe puna për përfaqsimin sa më të denjë të Klubit dhe Bashkisë Vlorë dhe për arritjen e objektivit të përbashkët të masivizimit të sporteve dhe përfshirjen e sa më shumë të rinjve në to. Veçojmë këtu fitoren e titullit Kampion Kombëtar për sezonin 2021 -2022 nga ekipi i femrave të basketbollit pas fitoreve të tre ndeshjeve finale me ekipin e Partizanit. Ndeshje emocionuse që mbushën me spektatorë Pallatin e Sportit Flamurtari në të dyja Finalet e zhvilluara këtu. Gjithashtu arritëm të jemi finalistë me ekipin e vajzave në Ligën Unike 2021-2022 që zhvillohet së bashku me ekipet më të mira të Kosovës për femra në Basketboll si dhe fitues të Kupës së Federatës në Shqipëri për sezonin 2021 – 2022.

Kampion Kombëtar u shpall dhe ekipi i vajzave të Flamurtarit në Kampionatin Kombëtar të volejbollit për të reja U-18, falë një sezoni të shkëlqyer duke i fituar të gjitha ndeshjet zyrtare. Në muajin qershor me mbështetjen e Bashkisë Vlorë u organizua për herë të parë nga Klubi maratona “Vlora vrapon 2022” me pjesëmarrje të nxënësve të shkollave , sportistë të klubit por dhe të atletëve profesionistë nga disa qytete të Shqipërisë. Në fund të maratonës për fituesit u shpërndanë shumë çmime dhe medalje.

Gjithashtu po në muajin qershor u zhvillua dhe aktiviteti i kick box “Night of the Champion”, dhe ky një aktivitet me pjesëmarrje të lartë tifozash ku u shpallën kampionë dy sportista të Flamurtarit për femra dhe meshkuj.

Për meshkujt në basketboll u renditëm në vendin e katërt të kategorisë së parë, ndeshjet e fundit të djemve ishin mjaft premtuese ku fituam 3 nga 5 ndeshje dhe kemi shumë shpresë për sezonin 2022 -2023.

Gjithashtu rezultate të larta janë arritur dhe në disiplinën e Boksit për të rinj e të rritur në kampionatet respektive, ku sportistët e Flamurtarit janë shpallur kampion jo vetëm në aktivitetet kombëtare por dhe në ato ndërkombëtare me ekipin kombëtar duke na bërë krenar për rezultatet e arritura.

Dhe nga ekipi i shahut për të rinj kemi një sportist kampion i cili fitoi vendin e parë në garën për kategorinë U-16 të zhvilluar në muajin korrik në qytetin e Durrësit. Paraqitje dinjitoze ka bërë dhe ekipi i minifutbollit Flamurtari duke u renditur në vendin e tretë të kategorisë respektive.

Gjithashtu sportistë kampion për vitin 2022 kemi dhe në disiplinën sportive të karatesë dhe taekëondo. Kupa Pavarësia për Taekëondo u zhvillua në fund të muajit maj në Pallatin e Sportit Flamurtari me pjesëmarrjen e ekipeve dhe sportistëve nga gjithë Shqipëria, gjithashtu dhe Kampionati Kombëtar i karatesë ku u shpallën kampionë 2 sportistë të Flamurtarit.

QENDRA KULTURORE

Gjatë vitit 2022 nga Qendra Kulturore janë zhvilluar veprimtari të ndryshme artistike,letrare e kulturore të ndryshme referuar edhe datave përkujtimore sipas një kalendri të paracaktuar në periudha të ndryshme të vitit si më poshtë;

JANAR

1. **16 Janar** – aktivitet për datëlindjen e Ismail Qemalit me nxënësit e shkollës “Nr.1”, me temë: “Të njohim figurën e Ismail Qemalit. Roli i tij në shpalljen e Pavarësisë në vecanti dhe në politikën shqiptare të fillim shek.XX, në përgjithësi
2. **20 Janar** - 1944 inagurohet Brigada V sulmuese në Bramyshnje (Tërbac). Brigadë heroike e bijve të denjë të Vlorës. Aktivitet në Muzeun Historik – Arkeologjik me Shoqatën e Veteranëve.
3. **21 Janar** - Aktivitet nëpër shkolla të mesme, “Elite”, “Nr.1”, “Halim Xhelo”, “Ali Demi” me temë: “Delegatët e Vlorës në Kongresin e Lushnjës”
4. **22 Janar** – Aktivitet nëpër shkolla të mesme, “Halim Xhelo”, “Ali Demi” me temë: “Arsyet e dorëheqjes së qeverisë së Vlorës 1912 – 1914”.
5. **24 Janar** – Përkujtohet vdekja e Ismail Qemalit.
Aktivitet në Muzeun Historik – Arkeologjik me piktura dhe vizatime të realizuara nga nxënësit e shkollave të qytetit. Sqarojmë gjithashtu që: Ashtu sikurse ka mbetur dilemë datëlindja e Ismail Qemalit (16 janar apo 24 janar 1844), po ashtu edhe dita e vdekjes ende nuk është zgjidhur (24 janar apo 26 janar). Për të mos folur pastaj për shkaqet e vdekjes (natyrale apo helmim).Ismail Qemali do të varroset më 12 shkurt 1919, në Kaninë, në varrezat e familjes së tij.
6. **27 Janar** – Përkujtohet “Dita e Kujtesës”, për të mos harruar kurrë viktimat e shkaktuara nga genocidi nazist dhe holokausti. “Kujtojmë dhe respektojmë të rënëit nga qyteti i Vlorës në kampet e përqëndrimeve naziste”. Midis viteve 1939 – 1944 janë burgosur dhe internuar nga qyteti i Vlorës rreth 1641 qytetarë dhe për fat të keq shumë pak prej tyre i kanë mbijetuar kampeve të përqëndrimit dhe janë kthyer në atdhe.

SHKURT

7. **2 Shkurt** - Aktivitet në Muzeun Etnografik. Kujtojmë dhe nderojmë në ditën e lindjes Marigo Posio (2 shkurt 1882). Aktivitet me temë “Marigo Posio – jo vetëm qëndistare e flamurit”. Ajo ishte një grua poliedrike dhe ndër të paktat femra intelektuale të qytetit të Vlorës.
8. **6 Shkurt** – Aktivitet në Muzeun Etnografik. Kujtojmë botimin në Vlorë nga Marigo Posio, të gazetës "Shpresa Kombëtare" me 6 shkurt 1921. Gazetë e përdyjavshme shoqërore e letrare, organ i shoqërisë së grave "Shpresa Kombëtare". Numri i parë doli në 6.2.1921 dhe u botuan gjithsej 6 numra. Trajtoi probleme shoqërore që lidheshin me çlirimin e gruas, propagandoi rrugën iluministe për rolin e arsimit dhe të edukatës për brezin e ri dhe veçanërisht për shkollat e përbashkëta të djemve dhe vajzave.
9. **13 Shkurt** – Aktivitet në Muzeun Etnografik.
Kujtojmë Klubin Labëria.; Më 1909, një ndër veprimtaritë e klubit atdhetar Labëria ishte edhe krijimi i teatrit në Vlorë. Shfaqja e parë që organizoi teatri ishte drama “Vdekja e Pirros”, përgatitur nga Mihal Grameno.

MARS

10. **Mars** – Aktivitet në Muzeun Historik dhe Etnografik me nxënës të shkollave të mesme dhe 9 – vjecare, me temë: Roli i Marigo Posio në “Klubin Labëria” si grua, mësuese, intelektuale dhe gazetare.

11. **15 Mars** - Muzeu Historik - Arkeologjik, u vizitua ditën e sotme nga shkolla e mesme "Ali Asllani" e Kotës. Nxënësit u njohën me objektet arkeologjike që janë gjetur në Kotë si dhe me rëndësinë e figurës së Ali Asllanit.

12. **24 Mars** – Aktivitet në Muzeun Etnografik me nxënës të shkollës 9 vjecare “Teli Ndini” me temë: “Kostume të gruas qytetare vlonjate, të realizuara nga piktori i njohur i qytetit të Vlorës, Petrit Ceno”. Këto veshje janë përdorur në fund të shek. XIX - fillim të shek. XX, për raste festash, dasmash dhe ceremonish fetare.

PRILL

13. **18 Prill** – Dita ndërkombëtare e monumenteve dhe e lokaliteteve.

Aktivitet në Muzeun Historik dhe Etnografik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare.

14. **22 Prill** – Aktivitet në Muzeun Historik me nxënësit e shkolles “Elite” me temë: “Avni Rustemi – Jo vetëm atentatori i Esat Pashë Toptanit”

Përkujtohet sot 98 vjetori i ndarjes nga jeta e Avni Rustemit.

Avni Rustemi vdiq pas një atentati që iu bë në Tiranë më 22 prill 1924. Vendlindja e tij ishte Libohova (22 shtator 1895) por varrimi i tij u bë në qytetin e Vlorës më 29 prill 1924.

15. **25 Prill** - Aktivitet në Muzeun Historik me nxënësit e shkolles “Rilindja” Kongresi i mbajtur në Vlorë më 25 prill 1921, krijoi një shoqëri, që mori emrin **Federata " Atdheu"**. Kryetar nderi i saj u zgjodh Avni Rustemi.

16. **29 Prill** - Në kuadër të nismës "Edukimi përmes kulturës", nxënës të shkollave "Idriz Rustemi" (Risili), "Fasli Danaj" (Llakatund) dhe "Halim Xhelo" (Vlorë), vizituan ambientet e Muzeumeve - Vlorë (Muzeu Historik dhe Etnografik).

Mesazhi që u përcoll tek nxënësit ishte: "Trashëgimia jonë kulturore si një mjet për të promovuar turizmin historik, arkeologjik dhe etnografik të zonës ku jetojmë".

MAJ

17. **5 Maj** – Dita e Dëshmorëve. Aktivitet në Muzeun Historik me temë: “Vlora gjatë Luftës së dytë Botërore. Dëshmor dhe Heronj nga qyteti.”

18. **18 Maj** – Dita ndërkombëtare e Muzeumeve. Vizitë e nxënësve të qytetit tek Muzeu Historik dhe Etnografik.

19. **29 Maj** – Aktivitet me nxënës të shkollave të mesme me temë: “Roli i Kuvendit të Bacallasë në Luftën e Vlorës”

QERSHOR

20. **5 Qershor** – Aktivitet në Muzeun Historik.

Tema: “Kujtojmë Luftën e Vlorës. Roli i cetave vullnetare në Luftën e Vlorës”.

21. **10 Qershor** - Aktivitet në Muzeun Historik.

“Përfaqësues nga Vlora në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878”

22. **11 Qershor** – “Kujtojmë Luftën e Vlorës. Roli dhe figura e Selam Musait”

23. **27 Qershor** – Përkujtohet genocidi çam (1944 – 2022)

KORRIK

24. **1 Korrik** - Ekspozitë me temë: “Vlora në sytë e Edëard Lear”

25. **17 Korrik** - Kujtojmë, ndarjen nga jeta të Persefoni Kokëdhimës (1924 - 1944), Heroinë e Popullit.

26. **20 Korrik** – Dita e Veteranëve (1957 – 2022)

Nderim dhe respekt për të gjithë veteranët, dëshmorët dhe heronjtë, për betejat e realizuara dhe gjakun e derdhur për çlirimin e vendit.

GUSHT

27. **1 Gusht** - Ekspozitë me temë: “Përlindja e Shqipërisë - Gazeta e parë e shtetit të pavarur shqiptar”.

28. **2 Gusht** - Protokoli Shqiptaro -Italian (Drejt përfundimit të Luftës së Vlorës 1920). Në të thuhej se qeveria italiane e respektonte sovranitetin shqiptar dhe integritetin tokësor të Shqipërisë dhe, në përputhje me këtë, do të tërhiqte trupat e saj nga Vlora (për një periudhë një mujore - deri më 2 shtator 1920) dhe pjesët e tjera të vendit, me përjashtim të ishullit të Sazanit.

SHTATOR

29. 2022 - 3 Shtator - 1920 / 102 vjet - Fitore e Luftës së Vlorës

Aktivitet në Muzeun Historik me foto, dokumenta dhe përshtypje nga shtypi i kohës.

30. 14 Shtator / 4 Tetor – Kujtojmë: “Epopenë e Drashovicës – 14 shtator 1943”

Për nga rëndësia dhe rezultatet e saj politiko - ushtarake kjo luftë (me 20 të vrarë dhe 70 të plagosur), përbën një Epope që i kalon kufijtë e Vlorës dhe ngrihet në shkallë kombëtare.

31. 1895 - 22 Shtator - 2022

Kujtojmë 127 vjetorin e lindjes së atdhetarit të shquar, Avni Rustemi

Avni Rustemi nuk ishte vetëm atentatori i Esat Pashë Toptanit. Ai ishte mësues, publicist, deputet shqiptar dhe veprimtar i lëvizjes demokratike.

32. 29 Shtator - Dita kombëtare e trashëgimisë kulturore.

Ekspozitë në Muzeun Etnografik me temë:

- a) Rëndësia e Etnografisë në trashëgiminë kulturore
- b) Etnografia në telajo dhe kostume tradicionale origjinale

TETOR

33. 1944 - 15 Tetor - 2022 / 78 vjetori i Çlirimit të Vlorës

Lavdi Dëshmorëve të Atdheut. Aktivitet në Muzeun Historik me nxënës të shkollave

34. 1942 - 18 Tetor - 2022

Përkujtojmë 80 vjetorin e ndarjes nga jeta të Heronjëve të Topanasë

35. 1944 - 22 Tetor - 2022 / 78 vjetori i çlirimit të Sazanit

NËNTOR

36.1924 - 8 Nëntor - 2022 / 98 vjetori i "Shkollës Tregtare Vlorë"

37.28 Nëntor / "Nëntori i Pavarësisë"

"110 vjet Pavarësi" ishte ekspozita e çelur ditën e sotme në Muzeun Historik. Nxënës nga shkolla të ndryshme u njohën me rolin e Ismail Qemalit në shpalljen e Pavarësisë, formimin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës si dhe me festimet e 1 Vjetorit të Pavarësisë

38. 1944 - 29 Nëntor - 2022 / 78 vjetori i Çlirimit të Atdheut

DHJETOR

39.4 Dhjetor 1912 - 22 Janar 1914 / 110 vjetori i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Qeveria e Përkohshme e Vlorës u krijua më 4 dhjetor 1912. Krijimi i saj u vendos nga Kuvendi Kombëtar i Vlorës, i cili me kërkesë të Ismail Qemalit e caktoi vetë përbërjen e qeverisë.

40. 20 Dhjetor - aktivitet kushtuar figurës së Ali Asllanit.

Më 20 dhjetor 1966 ka ndërruar jetë poeti, atdhetari dhe diplomati vlonjat, Ali Asllani.

Aktivitete të realizuara në TEATRIN E KUKULLAVE DHE TEATRIN RINOR Periudha (Janar – Dhjetor 2022)
--

- Aktivitete periudha : Janar – Dhjetor 2022

TEATRI I KUKULLAVE VLORE

- Premiera e shfaqjes së Teatrit të Kukullave Vlorë " LUANI MBRET" – 4 ditë
- Shfaqja "LUANI MBRET" Shkolla 24 Maji – 2 ditë
- Shfaqja "LUANI MBRET" Shkolla 15 Tetori – 2 ditë
- Shfaqja "LUANI MBRET" Shkolla Internacional – 2 ditë
- Shfaqja "LUANI MBRET" Shkolla Lef Sallata – 2 ditë
- Shfaqja "LUANI MBRET" Shkolla Jani Minga – 3 ditë
- Shfaqja "LUANI MBRET" Shkolla Naim Frashëri – 2 ditë
- Shfaqja "LUANI MBRET" Shkolla 4 Heronjtë – 2 ditë
- Shfaqja "LUANI MBRET" Shkolla Internacional – Kopështi – 2 ditë
- Shfaqja "LUANI MBRET" Shkolla Perla – 2 ditë

TEATRI RINOR

- Festivali Mbarëkombëtar Teatror i Shkollave të Mesme " Gjergji Trola " 2022 Tiranë.
" 3 DERRKUCAT "

Ne Prill 2022 filluan provat per premieren e re dhe faza per gatitore mbaroi deri ne fund te muajit Maj. Shfaqja u vu ne skene per femijet e qytetit sipas axhendes me poshte :

- DT 20 MAJ 2022 ORA 11:00 - SHTËPIA E FOSH NJËS
- (DITA KOMBËTARE E FËMIJËVE JETIM)
- DT 30 MAJ 2022 ORA 11:00 -SHKOLLA "4 HERONJTË"
- DT 30 MAJ 2022 ORA 12:00 - KOPËSHTI "ELITE"
- DT 31 MAJ 2022 ORA 11:00 - "KOPËSHTI I DASHURISË"
- DT 1 - 6 QERSHOR 2022
- DT 13-14-15 KORRIK 2022 ORA 20:30 - QËNDRA HISTORIKE "MURADIE"
- DT 20-21-22 KORRIK 2022 ORA 20:30 - SHESHI "3 RACAT"
- DT 25-26-27 KORRIK 2022 ORA 20:30 - "KINEMAJA VERORE" LUNGOMARE
- DT 2 GUSHT 2022 ORA 20:30 - SHESHI PARA NJËSISË ADMINISTRATIVE "ORIKUM"
- SHTATOR 2022 KA FILLUAR PUNA PËR PREMIERËN E RE TË TEATRIT TË KUKULLAVE VLOREË.

TEATRI I KUKULLAVE VLOREË , mori pjese ne Festivalin Mbarekombetar te teatrove te kukullave" "XINXIFILO 2022" Pogradec.

tor 2022 - Fillon puna për premierën e re "Kësulëkuqja"

- 1 Dhjetor - Shk.Internacional
- 2 Dhejtor - Shk.Rilindja + Fëmijët e qytetit
- 4 Dhjetor - Fëmijët e qytetit
- 5 Dhjetor - Shk.Jani Minga(2 shfaqje)
- 6 Dhjetor - Kopështi Internacional
- 9 Dhjetor - Shkolla "Naim Frashëri"
- 10 Dhjetor - Fëmijët e qytetit
- 11 Dhjetor - Fëmijët e qytetit
- 14 Dhjetor - Shkolla 15 Tetori
- 16 Dhjetor - Shkolla 24 Maji
- 17 Dhjetor - Fëmijët e qytetit
- 18 Dhjetor - Fëmijët e qytetit
- 25 Dhjetor – Festival Festiv per Krishlindjet me Fëmijët e qytetit.

Aktivite të realizuara në Biblioteken Publike “ Shevqet Musaraj” Periudha (Janar – Dhjetor 2022)

Ne zbatim te Programit te Aktiviteteve per vitin 2022, ne Biblioteken Publike “ Shevqet Musaraj”, gjate periudhes Janar – Gusht te këtij viti jane zhvilluar nje sere aktivitete, takimesh dhe ekspozitash tematike. Sipas muajve ju informojme si me poshte:

Muaji Janar

Jane organizuar mini ekspozita me botime per figurat e shquara te kombit tone Skenderbeut dhe Ismail Qemalit ne pervjetoret e tyre te vdekjes, si dhe mini ekspozita me botime te autoreve shqiptare te lindur ne kete muaj si Fan Noli, Fatos Kongoli, Haki Stermilli dhe Ismail Kadare. Pjese e aktiviteteve kane qene dhe ekspozitat me rastin e “ Dites se Kujteses “, si nderim per

krijimin e Brigades se V-te ne 20 Janar dhe “ Dites se Memories “ ne kujtim te viktimave te Holokaustit ne 27 Janar.

Muaji Shkurt

I shpallur nga Ministria e Kultures si Muaji i Kujteses, gjate ketij muaji jane organizuar mbi 18 miniekspozita me botime te autoreve shqiptare, me ne ze te letersise per te rritur dhe femije te lindur gjate ketij muaji dhe me gjere.

Jane zhvilluar ore leximi me nxenes te ciklit 9-vjecar, per rritjen e dashurise per librin.

Ekspozite me botime historike dhe artistike te autoreve te ndryshem ne 17 Shkurt, me rastin e 14 – vjetorit te shpalljes se Pavaresise se Kosoves.

Ne bashkepunim me Zyren Vendore te Arsimit Parauniversitar ne Vlore nis puna per organizimin e konkursit me teme “ Perralla e gjyse time “, me nxenesit e ciklit te ulet te shkollave te qytetit qe do te finalizohet me ndarjen e cmimeve ne 1 Qershor me rastin e festes se femijeve.

Muaji Mars

Jane organizuar miniekspozita me botime te shkrimtareve te shquar, Xhevair Spahiut, Skender Haskos, Faik Konices te lindur gjate ketij muaji dhe shkrimtares per femije Charlotte Bronte.

Me rastin e festave te 7-8 Marsit ne ambientet e bibliotekes u zhvillua nje takim me gra dhe vajza poete dhe shkrimtare te qytetit, te cilat lexuan pjese nga krijimtaria e tyre dhe diskutime per shtimin e takimeve te tilla miqesore dhe promovuese te artit e kultures ne qytet.

U organizua pritja e Konsulles se Pergjithshme te Italise ne Vlore Z. Iva Palmieri e cila u njoh nga afer me ambientet dhe punen e bibliotekes , botimet me vlere te rralla te saj ne gjuhen italiane dhe me gjere. Ne pefundim z. Palmieri i dhuroi bibliotekes nje sasi te konsiderueshme librash ne gjuhen italiane me spektër te gjere ne permbajtje.

Me rastin e 21 Marsit, Dites Boterore te Poezise ne ambientet e jashtme te bibliotekes, ne bashkepunim me Zyren Vendore te Arsimit Parauniversitar dhe Shoqaten “ Petro Marko “, u zhvillua nje aktivitet i gjere me nxenes ,krijues e lexues me muzike, krijime te autoreve te qytetit e atyre kombetare si dhe krijime te vete nxenesve nga gjimnazet e qytetit.

Muaji Prill

Gjate muaji prill jane organizuar nga sektori i librit per femije aktivitete me tematike argëtuese dhe didaktike, si dhe jane pritur ne ambientet e ketij sektori nxenes te ciklit te ulet te shkollave jo publike, “ Perla “ dhe “ Dijetari “, te cilet jane njohur me ambientet e bibliotekes, rregulloren dhe mundesite e argëtimit dhe leximit qe ajo ofron, per ti afruar sa me shume ata me librin dhe leximin. Me rastin e 21 Prillit Dites Boterore te Librit, ne bashkepunim me Qendren Kulturore te Femijeve “ Bajram Tushe “ te Vlores u organizuar nje aktivitet i gjere kulturor me poezi dhe krijime te vete femijeve si dhe nje ekspozite piktore, me punime te personazheve te dashur te librave per femije. Ne kete aktivitet nga ana e bibliotekes u shpermdane certifikatat “ Miku i Librit “ per femije e te rritur lexues te rregullt te bibliotekes per vitet 2020-2021.

Gjithashtu stafi i bibliotekes ka marre pjese gjate ketij muaji ne aksionet per pastrimin e Pyllit te Sodes, te organizuara nga Bashkia .

Ne pefundim ju informojme se perveç aktiviteteve te bibliotekes , per periudhen Janar-Prill, jane zhvilluar nje numer i madh, rreth 105 aktivitete nga te cilat 76 online, nga Kendi Amerikan prane bibliotekes me pjesëmarrjen e te rinjve dhe nxenesve te te gjitha moshave e me tematika nga me te larmishmet.

Muaji Maj

Gjate muajit **Maj**, jane hapur 3 ekspozita me botime te autoreve , te ndryshem dhe ne perkujtim te festive te ketij muaji, si dhe celjes se sezonit turistik me ekspozimin e albumeve fotografike e studimeve te ndryshme per resurset turistike e historike te qytetit.

Jane zhvilluar aktivite argetuese dhe edukative me femije te kopshteve, prane kendit te femijeve dhe me te rinj gjimnaziste te Kendi Amerikan.

Gjate ketij muaji numri I lexuesve qe kane frekuentuar biblioteken ka qene : 556 lexues

Numri I librave te lexuar : 5376 cope

Muaji Qershor

Per muajin **Qershor** eshte zhvilluar nje aktivitet ne b/punim me ZVAP e Vlores , me nxenesit e shkollave 9-vjecare perm shpalljen e fituesve te konkursit " Perralla e gjyshes ", ne kuader te 1 Qershorit , dhe nje ekspozite me botime te autoreve shqiptare e te huaj per femije.

Ne kendin Amerikan me gjimnaziste e te rinj te qytetit jane zhvilluar rreth 16 aktivite tematike dhe argetimi .

Gjate ketij muaji numri I lexuesve ka qene :355.

Numri I librave te lexuar ; 6848 cope

Muaji Korrik

Per muajin **Korrik**, jane organizuar 3 ekspozita nga autore te ndryshem te qytetit , si dhe rreth 18 aktivite me te rinj prane kendit amerikan.

Numri I lexuesve per kete muaj ka qene : 252.

Numri I librave te lexuar : 5919 cope.

Muaji Gusht

Per muajin **Gusht** , jane hapur 2 ekspozita me libra te autoreve te ndryshem, si dhe 7 aktivite tematike me te rinjte prane kendit Amerikan.

Numri I lexuesve per kete muaj ka qene : 284.

Numri I librave te lexuar : 6862 cope.

Muaji Shtator

Per muajin **Shtator** jane hapur 9 ekspozita me tematika te ndryshme , 3 aktivite me nxenes te shkollave "Lef Sallata" e gjimnazit "M.Q.Ataturk ne kuader te 86 vjetorit te krijimit te bibliotekes si dhe aktiviteti "Skema e shkembimit te shkollave te Ballkanit Perendimor"ne bashkepunim me Kendin Amerikan,Zyren Vendore Arsimore Vlore drejtuar nga Zyra Rajonale e Bashkepunimit Rinor.

Numri pjesemarresve ne aktivite: 716

Numri i lexuesve per kete muaj:434

Numri i librave te lexuar:6355

Muaji Tetor

Per muajin **Tetor** jane hapur 10 ekspozita me libra te autoreve te njohur shqiptare dhe te huaj,me libra te rinj dhuruar bibliotekes ne kuader te muajit te leximit si dhe Dites se Clirimit te qytetit.Gjate ketij muaji u zhvilluan aktivite me nxenes te shkollave : "Ismail

Qemali", "Elite", "Naim Frasher", "Internacional", "M.Q.Ataturk"."15 Tetori"etj.

U zhvillua promovimi i librit "Jete ne qelq" i autores vlonjate Tefta Musta si dhe ne

bashkepunim me Zyren e BE -se prane Bashkise Vlore u ndane cmimet e konkursit te recituesve

qe kishte organizuar shkolla "Ismail Qemali" ne kuader te Muajit te Leximit.Prane Kendit Amerikan u zhvilluan 10 aktivitete ne bashkepunim me Qendren Rinore Vlore.

Numri i pjesemarrresve ne aktivitete:1200

Numri i lexuesve per kete muaj:431

Numri i librave te lexuar:7118

Muaji Nentor

Gjate gjithe muajit Nentor,muajit te festave ne mjediset e bibliotekes jane ekspozuar botime te ndryshme,studime e dokumenta te veprimtareve qe bene te mundur shpalljen e Pavaresise dhe botime me dokumenta e kujtime te luftes per Clirimin e Shqiperise.Ne kuader te festave jane zhvilluar aktivitete me nxenes te shkolles"Speciale","24 Maj","Internacional" ,"4 Heronjte"etj. Po keshtu u finalizua projekti" Read Japan Project" ne bashkepunim me ambasaden japoneze ne Tirane me dhurimin e 100 librave ne gjuhen angleze te autoreve japoneze,me pjesemarrjen e ambasadorit te Japonise ne Shqiperi Z.M.Takada..Prane Kendit Amerikan e u zhvilluan 15 aktivitete.

Numri i pjesemarrresve ne aktivitete:1130

Numri i lexuesve:459

Numri i librave te lexuar:6896

Muaji Dhjetor

Gjate ketij muaji ne mjediset e bibliotekes u zhvillua promovimi i librit"Fjala ,ura e miqesise" i autores vlonjate Elvira Xhori Loli.Jane ekspozuar nga fondi i vjeter i bibliotekes koleksione te gazetave te vjetra si dhe librat e rinj, qe iu shtuan bibliotekes nga autore shqiptare e te huaj,per te rritur e femije,blere me fondet e akorduara nga Bashkia Vlore.Prane Kendit Amerikan u zhvilluan 20 aktivitete me tematika te ndryshme me nxenes e studente.

Numri i pjesemarrresve ne aktivitete:1700

Numri i lexuesve:138

Numri i librave te lexuar:2532

ARSIMI

Sektori I Arsimit gjate vitit 2022 bazuar në Ligjin nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", Ligjin Nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, Udhëzim, Nr.22, datë 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor, Ligj Nr.74/2013, datë 14.02.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar”, VKB-ës nr. 97, datë 28.12.2020 “Plani i përmisimit të shërbimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Vlorë”, Prill-Qershor 2022 procesi i monitorimit të kopshteve në Bashkinë Vlorë dhe Njësitë Administrative për zbatimin e kriteve të ligjshmërisë në veprimtarinë e institucionit arsimor parashkollor, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi ka zhvilluar disa veprimtari në funksion të krijimit të kushteve të përshtatshme në shkolla,kopeshte dhe cerhde dhe konkretisht;

- Në zbatim të udhëzimit nr. 25, datë 25.07.2018 të MAS “Për bordin e institucionit arsimor”, Kreu 3, pika7: Bazuar në ligjin nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e

Shqipërisë”, neni 34, është miratuar Projekt –Vendimi “Për përcaktimin e përfaqësuesve të Bashkisë Vlorë në Bordet e Institucioneve Arsimore Publike dhe jo Publike”.

- Në bazë të Vendimit nr. 30 të Kryetarit të Bashkisë, datë 12.06.2020 “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të njësisë së bashkisë vlorë për administrimin e shërbimeve në arsimin parashkollor (kopshte dhe çerdhet)”, u zhvillua procesi i monitorimit dhe vlerësimit të çerdheve publike në Bashkinë Vlorë.

- Bazuar në Urdhërin e brendshëm nr. 6 datë 19.01.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit edukativ individual për fëmijët me aftësi të kufizuar”, komisioni ka përditësuar planin PEI për 36 fëmijë me aftësi të kufizuar në kopshtet e Bashkisë Vlorë, në bashkëpunim me mësueset mbështetëse (përditësimi cdo 3 muaj).

- Finalizimi i veprimtarisë me rastin e 7-Marsit, festës së mësuesit, është organizuar në bashkëpunim me Zyrën Vendore Arsimore në shkollën 9-vjecare “28 Nëntori” veprimtaria me mësues që kanë dhënë kontribut në fushën e arsimit. U nderuan 20 mësues me titullin “Mirënjohje e Qytetit”.

- Proçesi i mbledhjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit të bonusit financiar të nxënësve ekselentë të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme që aplikojnë në Bashkinë Vlorë. Janë trajtuar me bonus financiar 136 nxënës në shkollat 9- vjecare publike dhe 135 nxënës në shkollat e mesme të përgjithshme publike.

- Mbledhje e informacionit për rastet me Covid-19 dhe rastet e sëmundjeve infektive në kopshte/çerdhe.

- Bazuar në Ligjin nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, VKB-ës nr. 97, datë 28.12.2020 “Plani i përmirësimit të shërbimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Vlorë”, ndiqet procesi i regjistrimit të vazhdueshëm në kopshte dhe çerdhe, si dhe adresimi i problematikave. (në vazhdimësi)

- Bazuar në Urdhërin e Brendshëm Nr.23, datë 23.10.2020 “Për një ndryshim në urdhërin Nr. 3 datë 07.01.2020 mbi ngritjen e komisionit për kolaudimin e mallrave ushqimorë, industriale dhe elektrike” është kryer kontroll ditor i ushqimit për çerdhet, kopshtet dhe PLM pranë magazinës së Qendrës Ekonomike.

- Bashkëpunim me zjarrfikësen Vlorë për trajnim të përdorimit të fiksës së zjarrit i personelit të çerdheve dhe kopshteve.

- Bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për Programin Kombëtar të Praktikave të Punës dhe shpërndarja e çertifikatave për Thirrjen e VI.

- Në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit për Çrregullimin e Spektrit të Autizmit janë zhvilluar disa aktivitete gjatë muajit Prill. Aktivitetet janë përmbyllur me një ekspozitë me materiale të riciklueshme me fëmijët e shkollës PLM dhe Qendrës Komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe marshim Vlorë-Skelë me fëmijë dhe të rinj.

Në zbatim të detyrave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit e institucioneve arsimore parauniversitare publike për garantimin e kushteve

higjeno-sanitare dhe ngrohjes në godinat e institucioneve arsimore publike, Janë paraqitur në drejtoritë përkatëse problematikat infrastrukturore dhe mungesa e bazës materiale që kanë drejtuesit e institucioneve arsimore publike për plotësimin e kushteve për një zhvillim normal të procesit të mësimi dhe edukimit.

- Në mbështetje të ligjit 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar, kreu V pika 3 të udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021 " Për procedurat e pranimit dhe të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore dhe për administrimin e portalit " Mësues për Shqipërin" Pjesë e Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve të mësuesve të arsimit parashkollor që aplikojnë në portal. Proçesi u krye në bashkëpunim me Zyrën Vendore Arsimore Vlorë-Himarë.

-Pjesë e grupit të punës pranë Qendrës Ekonomike për përcaktimin e specifikimeve teknike për ushqimin në kopshte dhe çerdhe.

- Studim "Analizë e situatës në kopshtet e Bashkisë Vlorë" në proçes.

- Monitorime të vazhdueshme në kopshte dhe në çerdhe.

- Takime të vazhdueshme me drejtuesit e çerdheve dhe kopshteve të Bashkisë Vlorë për mbarëvajtjen në këto institucione.

- Takim bashkëpunues në lidhje me projektin "Të dimë më shumë bashkë, të bëjmë më mirë bashkë" e organizuar nga Drejtoria e Integritit European dhe Investimeve Huaja.

- Takim mbi analizën vjetore të Z.V.A Vlorë-Himarë me Institucionet parauniversitare publike dhe jopublike në lidhje me diskutimin mbi objektivat e 2022.

- Takim me drejtuesit e kopshteve për fillimin e vitit të ri shkollor në bashkëpunim me ZVA Vlorë-Himarë.

- Specifikimi i mjeteve mësimore në bazë të Urdhërit nr.180, datë 23.06.2022 "Për hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit për mjetet didaktike". Shpërndarja e mjeteve didaktike në institucionet arsimore parashkollore.

- Bashkëpunim me Universitetin "Ismail Qemali" – Vlorë për të koordinuar realizimin e aktiviteteve dhe të programeve specifike për "Vlerësimin psikomotor tek fëmijët në institucionet arsimore shtetërore të kujdesit në Bashkinë Vlorë, bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit me nr. prot 2509, datë 17.06.2019 sipas nenit nr.4 të Aneks Marrëveshjes me nr.12146/1.

- Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore" ,VKM Nr. 666, datë 10.10.2019 "Për Kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimn e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike", të ndryshuar, Vendimi nr.511 , datë 27.07.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave " Për Kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimn e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike" të ndryshuar, Sektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit ndërmori hapat e mëposhtme:

U hartua një udhëzues për të evituar problematikat e hasura në të shkuarën si dhe për tu ardhur në ndihmë qytetarëve mbi procedurën, kriteret, dokumentacionin përkatës për secilin kriter, afatet kohore si dhe rastet në të cilat aplikantët nuk kanë të drejtë të aplikojnë. Udhëzuesi u nis në mënyrë elektronike në të gjitha shkollat e Bashkisë Vlorë dhe në Zyrën Vendore Arsimore Vlorë-Himarë gjatë muajit shtator- fillim tetori. Bazuar mbi parashikimet e aplikantëve të ardhura nga drejtuesit e IA-ve Sektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit pa të arsyeshme ngritjen e një grupi pune për shqyrtimin e dokumenteve për aplikimeve për bursa. Me Urdhërin e Brendshëm Nr.291, datë 31.10.20220. Për vitin shkollor 2022-2023 komisioni i ngritur pranë këtij sektori ka shqyrtuar 355 aplikime nga 31 shkolla të Bashkisë Vlorë. Nga shkollat e mesme profesionale dhe konvikti 126 nxënës janë përfutues sipas kriterit ku aplikojnë.

- Nga shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të përgjithshme 164 nxënës janë përfitues sipas kriterit ku aplikojnë

Nxënësit dhe mësuesit e institucionit të arsimit special që përfitojnë bursë sipas pikës 21, të VKM nr.666, datë 10.10.2019 në formën e kuotës ushqimore janë :

- 1- 63 nxënës ku 4 janë nga Qendra e Zhvillimit
- 2- 21 mësues

- Kthim përgjigje institucioneve të ndryshme ose qytetarëve.
- Organizimi i festës së “1- Qershorit” me Qendrën Kulturore të Fëmijëve.
- Organizimi i aktivitetit “Për vlerësimin e nxënësve kampion të vitit 2021” për sporte të ndryshme.
- Koordinimi i “Festivalit të Luleve”, 19-20-21 Maj.
- Ndjekja e aktiviteteve sportive në kuadër të javës sportive dhe Ditës Ndërkombëtare të Sportit për Zhvillim dhe Paqe.
- Ndjekja e aktiviteteve të ndryshme sportive që zhvillohen në Bashkinë Vlorë dhe në shkollat e qytetit.
- Pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme që organizojnë drejtori të tjera të Bashkisë Vlorë dhe institucione të ndryshme.

Shtëpia e Foshnjes

Shtëpia e Foshnjes Vlorë (institucion rezidencial i përkujdesit shoqëror për fëmijë 0- 5 vjeç) funksionon në bazë të standarteve dhe procedurave të bazuara në politikën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas legjislacionit për sistemin e mbrojtjes sociale dhe udhëzimeve përkatëse ,Ligji Nr. 121/2016 “ Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr.18/2017 “ Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve”, VKM nr.659/2005 “ Për standartet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale”

Institucioni rezidencial i përkujdesit shoqëror për fëmijë 0-5 vjeç pranë Bashkisë Vlorë (IPSH Vlorë) gjatë vitit 2022 ka ofruar shërbime të përkujdesit shoqëror për fëmijë të braktisur në maternitete dhe fëmijë të tjerë në nevojë. Ky institucion ka si qëllim mbrojtjen e tyre nëpërmjet ofrimit të gjithë shërbimeve të nevojshme për të siguruar ushtrimin e të drejtave në përputhje me zhvillimin e personalitetit, bazuar në interesim më të lartë të tyre.

Shtëpia e Foshnjes Vlorë gjatë kësaj periudhe ka synuar të ofrojë kujdes të planifikuar rezidencial (afatgjatë ose të përkohshëm) për fëmijë pa kujdes prindëror që i përkasin grupmoshës 0-5 vjeç, me kapacitet akomodimi për jo më tepër se 30 fëmijë. Punonjësit e institucionit vlerësojnë nevojat e secilit, dhe hartojnë më pas plane individual të zhvillimit të fëmijëve me synim maksimizimin e potencialit të tyre për secilën fushë zhvillimi (fizik, konjitiv, social, emocional). Kjo e fundit realizohet nëpërmjet përfshirjes në një numër veprimtarish dhe aktiviteteve interaktive dhe krijimit të një mjedisi stimulues, pozitiv dhe të sigurt për fëmijët.

→**Stafi psikosocial** i Shtëpisë së Foshnjës 0-5 vjeç, Vlorë gjatë 8 muorit të parë vitit 2022 është përpjekur maksimalisht të ofrojë mbështetje dhe shërbim psiko-social për fëmijët e akomoduar në institucion dhe familjet e tyre duke zbatuar objektivat e vendosura në planet vjetore. Në lidhje me qëllimet, objektivat e institucionit janë ndjekur si më poshtë:

Përgjatë periudhës së analizës vjetore të vitit 2022 janë realizuar nga punonjësi social i Shtëpisë së Foshnjes Vlorë, këto detyra:

- 1- Në bashkëpunim me psikologun e IPSH Vlorë janë ndjekur 2 procese gjyqësore për birësimin e fëmijëve me iniciale: E.SH. & N.H. dhe 2 procese gjyqësore për marrjen e kujdestarisë së fëmijëve të akomoduar me iniciale: K.D. & XH.M.
- 2- Pjesëmarrje në tre GTN (Grup Teknik Ndërsektorial) dhe katër SVK (Skuadra Vendore e Koordinimit).

3- U trajnuan kujdestaret e institucionit përgjatë muajit mars, në lidhje me plotësimin e RVNE-ve dhe planeve të kujdesit. Orientim i vazhdueshëm i kujdestareve të IPSH-së Vlorë për mënyrën e komunikimit me fëmijët, si dhe për menaxhimin e dinamikave të marrëdhënies kujdestareve me njëra - tjetrën (ndarjen e detyrave, përgjegjësi, nxitje e bashkëpunimit midis tyre).

4- Ruajtja e komunikimit (takime) me përfaqësues të aktorëve lokal, specifikisht me: Drejtoreshën e Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social, Bashkia Vlorë.

Përgjegjësen e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijët dhe Familjen.

Punonjësin Social të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Vlorë.

Drejtorinë e Zyrës së Punës.

5- Bashkëpunim me infermierën e institucionit për të lehtësuar takimet mjekësore të fëmijëve, pranë Qendrës Shëndetësore nr. 1 si dhe në mjekë specialistë, specifikisht 8 takime.

6- Është lehtësuar takimi i fëmijëve me prindërit biologjik, specifikisht 40 takime. Ruajtja e komunikimit me prindërit biologjik/birësues nëpërmjet telefonit si dhe realizimi i intervistave përgjatë interesimeve/vizitave të prindërve.

7- Përpjekje për ribashkim të fëmijës së institucionalizuar pranë IPSH Vlorë në kuadër të procesit të DeInstitucionalizimit. Realizimi i takimeve me nënën e fëmijës E.V. në bashkëpunim me punonjësit e SHMFF Vlorë, për të orientuar mbi procedurën dhe detyrimet e saj prindërore për të finalizuar ribashkimin. (Ribashkimi nuk u arrit për shkak të problemeve sociale të nënës, e cila nuk bëri përpjekje reale për ribashkim).

8- Organizimi i festave dhe datëlindjeve të fëmijëve në bashkëpunim me drejtoreshën, stafin psiko-social të institucionit, edukatorët dhe kujdestaret.

9- Plotësimi i RVNE-ve dhe planeve individuale të kujdesit për 13 fëmijë, në bashkëpunim me stafin e institucionit, plotësuar në frekuencë 6 mujore.

10- Bashkëpunim me stafin psikosocial të IPSH-së Vlorë për të realizuar evidencën 4 mujore drejtuar Shërbimit Social Shtetëror.

11-Bashkëpunim me stafin psiko-social për plotësimin e evidencave mbi gjendjen sociale të fëmijëve të akomoduar në IPSH-në Vlorë drejtuar Komitetit Shqiptar të Birësimit në kuadër të birësimit të tyre. (Realizuar në frekuencë mujore për secilin fëmijë.)

12- Monitorim i konsumimit të vakteve ushqimore nga fëmijët e akomoduar pranë IPSH-së Vlorë.

13- Dokumentim ditor i forcës së fëmijëve ku specifikohet numri i tyre i përgjithshëm, ndarja sipas grupmoshave si dhe kuota ditore për secilën grupmoshë.

Në aspektin e **fushës shëndetësore** janë realizuar të gjitha analizat dhe vaksinimet për secilin fëmijë në afatet e mirëpërcaktuara sipas nevojave që fëmijët kanë shfaqur. Këto të realizuara edhe nga mbështetja e mjekut të institucionit i cili ka një kontratë pune të pjesshme Nr. 10745. Përsa i përket gjendjes shëndetësore të fëmijëve, aktualisht janë 2 fëmijë me mjekim ditor për shkak të diagnozës Epilepsi. Mjekimi është i udhëzuar dhe i dokumentuar nga mjeku specialist dhe menaxhohet nga infermieri i Institucionit në bashkëpunim me kujdestaret. Gjendja shëndetësore e fëmijëve ka qënë relativisht e mirë.

Në kuadër të parandalimit të përhapjes së pandemisë COVID-19, është realizuar procesi i vaksinimit për të gjithë stafin i cili është pajisur me çertifikatat e vaksinimit Covid-19.

Shtëpia e foshnjes Vlorë gjatë vitit 2022 vazhdon të jetë në fazë pilotimi të shërbimit në kuadër të zbatimit të planit të deinstitutionalizimit, ku SHMFF-ja në bashkëpunim me Institucionin tonë kryejnë vlerësimet e fëmijëve dhe familjeve potenciale për rikthim në familje, zhvillojnë mbledhjet e SVK-ve në të cilat diskutohet për dinamikën dhe ecurinë e akomodimit të fëmijëve pa përkujdesje prindërore.

Në fillim të vitit numri i fëmijëve ka qënë 14, gjatë vitit ka pasur këto lëvizje:

Numri		
-------	--	--

1	Rikthime në familje biologjike	-
2	Transferuar në Sarandë	2
3	Birësime	3
4	Hyrje	-

Gjatë vitit 2022 gjithashtu është punuar për të realizuar kërkesat për mirëqënien e fëmijëve. Kapaciteti i fëmijëve në institucion është 30 fëmijë, aktualisht janë 11 fëmijë. Janë plotësuar nevojat duke zbatuar me përpikmëri buxhetin e aprovuar nga Bashkia Vlorë si dhe Sh. S. Sh Tiranë:

Për 8 mujorin e vitit 2022 është kjo gjendje sipas situacionit:

Spektori ekonomik në bashkëpunim me thesarin ka raportuar dhe informuar Sh.S.Sh dhe Bashkinë mbi : statistikat, evidencat mujore, të ardhurat, realizimin e rregjistrave të prokurimit etj.

Përsa i përket ushqimit, ai është korrekt në lidhje me kuotën ushqimore të përcaktuar për secilin rezident duke zbatuar një menu sipas grupmoshave të përcaktuara në udhëzim.

Spektori ekonomik këtë 8 mujor ka punuar për përgatitjen e Projektbuxhetit, si të Sh S Sh dhe të Bashkisë sipas kërkesave dhe nevojave të institucionit .

Qendra e Zhvillimit PAK

Qendra e Zhvillimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, Vlorë si një institucion rezidencial i cili funksionon në përputhje me standartet dhe legjislacionin në fuqi për këtë target grup, edhe këtë vit ka organizuar aktivitetin e saj në përputhje me misionin dhe objektivat e vendosura.

Misioni i kësaj qendre është zbatimi i politikave sociale me synim : Ofrimin e Shërbimeve cilësore, të qëndrueshme dhe në përputhje me standartete e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Personat me Aftësi të Kufizuara duke qënë gjithnjë në koherencë me legjislacionin në fuqi me qëllim rritjen e cilësisë së jetës , nxitjen e pavarsisë, përfshirjes dhe respektimit të dinjitetit të rezidentëve si dhe integrimin e tyre në komunitet në mënyrë sa më të natyrshme, nëse kjo e fundit është e mundur.

Qendra e Zhvillimit për Persona me Aftësi të Kufizuara **gjatë vitit 2022 ka synuar të realizojë Objektivat si më poshtë :**

- Rrisë cilësinë e shërbimit që ju ofrohet rezidentëve në drejtim të riaftësisimit fizik dhe mendor të këtyre të fundit.
- Nxitja dhe zbatimi i programeve aktive me qëllim krijimin e një proçesi sa më natyral të integritit të rezidentëve në komunitet.
- Krijimi i netëork-ve efektiv me Institucione, Organizata jofitimprurëse, Subjekte Juridike dhe private të cilat promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e këtij target-grupi.

Realizimi i Programeve edukativo-pedagogjike dhe riaftësisimit të personave me aftësi të kufizuara.

Detyrat :

- Ofrimi dhe krijimi i kushteve të favorshme dhe cilesisë për të jetuar dhe mësuar në bazë të programeve të riaftësisimit.
- Perpilimi i programeve të edukimit dhe të integritit në sajë të bashkëpunimit të

dukatoreve, specialistëve, monitorimi i të clave behet nga Drejtoria

- Zbatimi i legjislacionit dhe Standarteve
- Hartimi i programeve per trajnimin dhe formimin e stafit.
- Administron dhe menaxhon buxhetin e caktuar.
- Raporton dhe informon Sh.S.SH dhe Bashkine, Vlore mbi: statistikat dhe evidencat mujore, te ardhurat, transferimet e klienteve, raporte te realizimit te planeve mujore.
- Mban lidhje korrekte per cdo problem me Bashkinë Vlore dhe SH.S.SH.

Aktualisht, eshte duke u punuar per perfundimin e ketij projekti.

Deinstitutionalizimi dhe kthimi në familje të rezidentëve.

Aktualisht në Qendrën tonë marrin shërbim 30 rezidentë, prej të cilëve 21 përfitues janë mbi moshën 21 vjecare, 15 janë të braktisur me vendim gjykatë dhe 6 janë më interesim familjar. Shërbimi Social Shtetëror udhëzon që Qendrat Rezidenciale të ofrojnë kujdes dhe shërbim për rezidentët deri në moshën 21 vjec si dhe të kryhen të gjitha procedurat për kthimin në familje të personave me interesim. Konkretisht janë kryer të gjitha kërkesat dhe procedurat ndaj Shërbimit Social Shtetëror dhe Rajonal për sistemimin e këtyre rezidentëve, por situacionet social-ekonomike të familjeve të tyre nuk i plotesojnë kushtet për deinstitutionalizimin e këtyre përfituesve.

1. Problematika e sjelljeve të rezidentëve.

Duke marrë në konsideratë diagnozat mjekësore, moshën në rritje si dhe mbivendosjen e çrregullimeve psikiatrike në këta rezidentë, shumë prej përfituesve nuk paraqiten pozitiv ndaj ndërhyrjeve pedagogjike dhe planeve të zhvillimit, duke ndikuar ndikuar negativisht në mbarëvajtjen e punës.

Realizimet e objektivave

1. Realizimet në sektorin social dhe pedagogjik

Ne drejtim te ketyre sektoreve qellimet, objektivat dhe aktivitetet per vitin 2022 kane qene te orientuara ne lidhje me moshen ne rritje te rezidentevete veshtiresive qe ata paraqesin nevojave dhe kerkesave te tyre ne lidhje me trajtimin e aftesise se kufizuar dhe te zhvillimit te tyre ne perputhje me kerkesat dhe plotesimin e standarteve te vendosura.

Ne nivel pedagogjik per vitin 2022 duke vleresuar fillimisht nevojat kerkesat dhe vete rezidentet brenda institucionit eshte hartuar nje projekt pilot duke organizuar aktivite okupacioni ne baze te trajnimeve speciale te edukatoreve te orientuara ne aktivite specifike. Qe do te thote se tashme jane shtuar aktivite paraprofesionale ne mini atelie pune si: *punime me leter dhe plastike, punime leshi, punime me rruaza, me materiale te riciklueshme, punime ne piktore, aplikacione-prodhim piktura te ndryshme.*

Aktivitet ne Qender jane zhvilluar normalisht madje kete vit mund te permendim se ka patur nje rritje ne nivelin e organizimit te aktiviteve do te permendja ketu aktivitetet me rastin e 20 Majit "Dites Kombetare te Femijeve Jetim " te cilat u shtrine ne nje kohe prej 1 jave dhe ishin nga me te larmishmet. Kjo jave shenoj nje angazhim total nga stafi i Qendres por edhe nje perfshirje dhe sensibilizim te konsiderueshem nga komuniteti. Duke vazhduar me 1 Qershorin, aktivite te ndryshme gjate veres, ditete e festave kalendarike, 3 Dhjetori dhe festat e fundvitit, te cilat ishin jo vetem te larmishme por edhe nga me te vecantat per rezidentet te cilet u perfshine ne aktivite

inegruese si me komunitetin, institucione, po ashtu edhe me subjekte te vecante te cilet kane dhene kontribultin e tyre ne menyren qe ata mundeshin.

Gjatë muajit tetor, Shoqata “Auris” ne vazhdimesi te vitit te kaluar ka mundësuar disa orë arti pikturave, ne dite te ndryshme me piktorë të ndryshëm vlonjat duke përfshirë rezidentët në realizimin e pikturave.

Gjatë muajit Tetor është realizuar një shëtitje në Detin Jon me mjetet lundruese të mundësuar nga Shoqata Arbëreshe “I Kastrioti”.

Dita Ndërkombëtare e AK është realizuar pranë Pallatit të Kongreseve, Tiranë, e finalizuar me një ekspozitë me punimet e rezidentve.

Realizimi i objektivave pedagogjike

- Plotësimi i fishave të vlerësimit të AK, për të përcaktuar nevojat dhe prioritetet e ndërhyrjes
- Hartimi, plotësimi i planeve individuale të zhvillimit.
- Rishikimi dhe rivlerësimi i nevojave te rezidenteve persa i perket moshes dhe tipologjise se veshtiresise qe ata paraqesin duke i orientuar aktivitetet ne ato paraprofesionale.
- Hapja e 2 mini- atelieve te punes ate te hekurosjes si dhe ate te krijimtarise me materiale te ndryshme sipas specifikave te rezidenteve.

2. Ecuria shëndetsore e përfituesve

Gjatë 2022, persa i përket gjendjes shëndetsore të rasteve, aktualisht janë 19 përfitues me mjekim ditor për shkak të crregullimeve psikiatrike apo neurologjike. Mjekimi është i udhëzuar dhe dokumentuar nga mjeku specialist dhe menaxhohet nga infermieri i institucionit. Janë realizuar të gjitha ekzaminimet e udhëzuara nga mjeku.

Ushqimi eshte korrekt ne lidhje me kuoten ushqimore te percaktuar per secilin rezident dhe mund te vleresohet nje menu brenda parametrave normal persa i perket kalorive duke perfshire aty edhe moshen dhe dieten e rezidenteve.

Gjendja shëndetsore e rezidenteve ka qenë relativisht e mirë duke patur parasysh këtu kategorinë e personave, problemet dhe vështirësitë që ata kanë. Në periudha të ndryshme të vitit janë shfaqur viroza të cilat janë trajtuar si në individ po ashtu edhe kur rastet kanë qenë kolektive. Gadishmeria dhe dispozicioni i mjekeve ka qene shume i kënaqshëm dhe korrekt.

Eshtë bërë në menyrë korrekte vaksinimi i rezidenteve sipas kalendarit të vaksinimit si dhe kontrollet rutine persa i perket planifikimit nga ana e infermieres në lidhje me kontaktimin me mjekët përkatës.

Vlen të theksohet që përgjatë muajit Dhjetor, 2022, pothuajse të gjithë rezidentët kanë shfaqur siptoma të gripit me temperaturë të lartë dhe për këtë arsye është kërkuar ndihma e NJVKSH për tamponimin e tyre

Sektori i Sherbimit Higjieno- Sanitar

Nga kontrollet vazhdueshme ne kete sektor eshte evidentuar se Institucioni paraqet nje higjene te pergjithshme shume te mire kjo ne mirembajtjen e ambjenteve te brendshme dhe te jashtme te instiucionit konform rregullave dhe standarteve higjieno sanitare.

Risqet dhe vështirësitë

Për vetë natyrën dhe tipologjinë e Institucionit si Qendër Zhvillimi dhe të personave që marrin sherbime në të, duke patur parasysh *moshën* në rritje të rezidenteve dhe thellimin e disa individeve ne gjendjen dhe problemet e tyre mund te themi se kjo mbetet një nga vështirësitë kryesore të ketij institucioni.

Disa nga rezidentet kanë në këtë qëndër mbi 20 vjet dhe nuk mund të qendrojne me në këtë institucion. Por nga ana tjetër duke qenë në një paqartësi në lidhje me lëvizjen apo zhvendosjen e

tyre drejt një institucioni tjetër, jo vetëm që kjo sjell edhe probleme duke bllokuar kapacitetin pritës të Qendrës.

Kërkesat e vazhdueshme për të integruar edhe fëmijë të tjerë pranë kësaj qendre mbeten të pa ezauruara për shkak të kapacitetit të percaktuar.

Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social

Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social në Bashkinë Vlorë gjatë vitit 2022 është përballur me mjaft sfida të pranishme dhe të vazhdueshme, por edhe me modele pozitive sa i takon bashkëpunimit të rrjetit tashmë të konsoliduar të shërbimeve sociale në Bashkinë e Vlorës. Shërbimet sociale janë një zinxhir tejet kompleks, por eksperiencia dhe mbështetja e vazhdueshme e Kryetarit të Bashkisë e kanë krijuar tashmë imunitetin për të realizuar objektivat e kësaj Drejtorie. Kështu është hartuar dhe miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak një Plan të mirëfilltë Social me objektiva të qarta, të matshëm dhe të realizueshëm. Gjatë këtij viti është realizuar nisja e fushatës për kujdestarinë alternative profesjoniste pranë SHMFF, shërbimit më të ri të ngritur në kuadër të planit të deinstitucionalizimit, duke i shtuar shërbimeve sociale në bashkinë Vlorë një hallkë tjetër të rëndësishme ndërveprimi.

Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social në bashkinë e Vlorës ka në fokus tek shërbimet e kujdesit shoqëror nevojat sociale në rritje të kategorisë së grupeve në vështirësi ekonomike për të gjithë komunitetin, të jenë të mbuluara me shërbime ekzistuese dhe shërbime të reja sociale, për të qënë sa më pranë qytetarëve sipas modeleve dhe praktikave më të mira bashkëkohore. Shërbimet ofrohen në përputhje me standartet dhe kornizën ligjore të shërbimeve sociale duke u bazuar në qasjen me personin në qendër, duke ngritur një sistem të balancuar shërbimesh sociale të cilat do të kenë në fokus target grupet në nevojë, duke synuar një mbulim më të mirë të nevojave të tyre, një mbulim më të plotë me shërbime të tjera të kujdesit shoqëror, nëpërmjet zhvillimit të mëtejshëm të shërbimeve ekzistuese dhe ndërtimit të shërbimeve të reja.

Çdo muaj Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social paraqet Projekt-Vendimin e fondit të kushtëzuar 6% me fonde të deleguara nga buxheti i shtetit dhe Projekt-Vendimin me të ardhurat e bashkisë ku trajtohen familje me probleme të thella sociale të cilat nuk janë përfituese të sistemit dixhital por në bazë të kriterëve specifike të miratuara në Këshillin e Bashkisë çdo fillim viti, përfitojnë me të njëjtën vlerë monetare si skema dixhitale dhe konkretisht :

Numri i familjeve përfituesve në vështirësi ekonomike nga të ardhurat e bashkisë ka qënë afërsisht rreth 35 familje në muaj me një fond prej 1.524.800 Leke.

Bazuar në V.K.M. 159 datë 12.03.2022 gjatë vitit 2022 u aplikua mbeshtetje financiare nga Qeveria në masën 3.000 leke për një periudhë 3-mujore si pasoje e ndikimit në ekonomi të luftes në Ukrainë. Nga kjo ndihme e dhënë nga qeveria përfituan 688 familje me një fond 5.886.000 leke ndihme ekonomike nga sistemi dixhital dhe 16 familje me një fond 135.000 leke përfituese nga buxheti i kushtëzuar i 6% .

Familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike nga **fondi i kushtëzuar 6%** për vitin 2022 janë trajtuar 16 familje me një fond 481.886 Leke.

Në skemën e ndihmës ekonomike prioritet janë përfitueset kryefamiljare gra 232 persona, familje që janë të komunitetit rom 31, familje të cilat kanë në përbërje të tyre P.A.K 81, jetim deri në moshën 18 vjeç - 19 persona, familje me trinjakë -2 familje, viktimat të dhunës 24 familje, fëmijë që janë me shërbim kujdestarie të gjyshërve ose të afërmeve të tyre – 6 dhe fëmijë me aftësi të kuafizuar 2.

Pagesat për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar kanë vazhduar pa ndërprerje edhe për këta personat qeveria ka aplikuar mbështetjen financiare nga ndikimi i luftes në Ukrainë, për një periudhë 3-mujore (prill.maj.qershor)sipas ketyre të dhenave:

Emërtimi	P.A.K + kujdestarë		Tetraplegjik+ kujdestarë		Verbëri kujdestari		Invalid		Total	
	Nr.	000/Lekë	Nr.	000/Lekë	Nr.	000/Lekë	Nr.	000/Le kë	Nr.	000/Lekë
P.A.K	1948	170274	574	93.971	663	74511	2407	63165	5592	401.922
v.k.m-159 prill-2022									1906	17.283
										419.205

Njësia për Çështjet e Dhunës në Familje Janar-Dhjetor 2022

Nga Koordinatori Vendor I Dhunës në Familje për periudhën Janar-Shtator 2022 janë trajtuar gjithësej **143 raste**, vendime gjykate, lëshuar në formën e Urëdhrave të Menjëhershëm Mbrojtjeje dhe Urdhëra Mbrojtjeje.

Këto raste dhune janë menaxhuar në bashkëpunim me Ekipin Teknik Ndërdisciplinar dhe në koordinim të përmirësuar mes aktorëve të këtij grupi, ku janë marrë edhe masat për katëse për mbështetjen e plotë të viktimave.

Rastet janë menaxhuar në bashkëpunim me koordinatorin vendor dhe me antarët e Ekipit Teknik Ndërsektorial, duke u ofruar shërbime ligjore dhe psikologjike falas, shërbime këshillimi për burrat e dhunshëm, rastet e pajisura me UM janë trajtuar me Ndhimë ekonomike në masën 9,000 në bazë të VKM Nr.868,datë 29.12.2021, ku gjatë vitit 2022, kanë nisur të trajtohen **mbi 35 raste viktimave të dhunës në familje në masën 9000 lek në muaj** në baze të kohëzgjatjes së afatit të vendimit të gjykatës, duke kryer monitorimet në bashkëpunim me policinë vendore Vlorë, ndërmjetësim për punësim, informim dhe këshillim mbi të drejtat që ka një viktimë dhune në bazë të ligjit përkatës.

Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve Janar-Shtator 2022

Për periudhën Janar-dhjetor 2022, janë menaxhuar në total **38 raste të mbartura të cilat vazhdojnë të marrin shërbime sociale dhe 58 raste të reja të fëmijëve në nevojë për mbrojtje sipas problematikave dhe vlerësimeve social-ekonomike të familjes për monitorim të rastit, për marrjen e përgjegjësisë prindërore nga prindi në rastin e fëmijëve të riatdhesuar, për regjistrim në shkollë etj.** Vizitat në familje kanë pasur karakter kryesisht vlerësues mbi situatën sociale-ekonomike të familjes dhe janë kryer në varësi të problematikave të cilat kanë patur rastet. Edhe për vitin 2022 me vendim këshilli bashkiak janë **përfshirë 21 fëmijë për frekuentim kopshti dhe çerdhe nga të ardhurat e fondit të bashkisë**. Këta fëmijë janë pjesë e familjeve me probleme specifike socio-ekonomike, fëmijë të viktimave të dhunës në familje.

Pjesëmarrja e anëtarëve të GTN gjithashtu ka qenë e rregullt.

Menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë përmbrojtje dhe i rasteve të dhunës në familje është realizuar me staf mjaft të reduktuar.

Shërbimet Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjet - SHMFF

Aktivitetet për periudhën Janar-Dhjetor 2022

Arritjet kryesore më të rëndësishme gjatë këtij viti, gjatë procesit të ngritjes dhe pilotimit të Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen janë si më poshtë vijon:

Përfituesit (specifiko nr, gjinia, grupmosha, kategoria)	Nr.	Gjinia	Grupmosha	Kategoria	Nr.
	141	72- F 69- M	0-18 vjeç → 43 18-25 vjeç → 1 25-40 vjeç → 38 40-60 vjeç → 45 60 < vjeç → 14	Fëmijëve të institucionalizuar dhe familjeve të tyre	1
				Familjeve në nevojë për shërbime shoqërore	141
				Fëmijëve në rrezik institucionalizimi	19
				Familjeve kujdestare dhe fëmijëve të vendosura në to	0
				Të moshuarit	14
<ul style="list-style-type: none"> • 28 familjeve u janë ofruar mbështetje direkte me paketa ushqimore, higjieno sanitare dhe didaktike. • Fëmijë dhe të rritur kanë përfituar nga shërbimet psiko sociale të mëposhtëme: <ul style="list-style-type: none"> - Parandalim i institucionalizimit të fëmijëve(19 fëmijë) - shërbimi i kujdesit në familje; (2 raste) - Asistencë dhe shoqërim i familjeve në institucione arsimore, shëndetësore, shoqërore për të përfituar nga shërbimet e nevojshme.(28 familje) - Regjistrimi i fëmijëve në qendrën shëndetësore për të vijuar me tej me kontrollet rutinë dhe kalendarin e vaksinimit sipas moshës së fëmijës. (10 fëmijë) - Asistim dhe shoqërim i rasteve për të bërë regjistrimin e fëmijëve në çerdhe, kopsht apo shkollë sipas nevojës. (10 fëmijë) - Ofrim i mbështetjes psikologjike për prindërit dhe fëmijët në mjedisin e SHMFF apo në familje. (13 Familje) - Asistencë në mbledhjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe aplikimin për përfshirejn e skemës së ndihmës ekonomike. (6 familje) - Kryerja e vizitave në familje dhe identifikimi i nevojave. (28 raste) 					

- Hartimi i 4 plane fuqizimi dhe monitorimi dhe 2 plane kujdesi ne familje.
- Lobim në komunitet dhe kisha / sigurim nga komuniteti i veshmbathjeve, mobilievetj.

R2. Shërbimet e specializuara kanë nisur të ofrohen si Kujdestaria në familje (2 familje) dhe Klasat e Prindërimit(modul i përfunduar për 6 prindër) ndërkohë gama e shërbimeve të tjera të specializuara si psikoterapeutë, fizioterapist, mësues mbështetës, logoped etj, do të pasurohet gjatë vitit 2022.

R.3 20 familje janë mbështetur dhe u janë ofruar sesione këshillimi mbi prindërimin pozitiv duke nxitur krijimin e marrëdhënieve më pozitive dhe kushteve më të përshtatshme të cilat kanë ndikuar drejtëpërdrejtë në mirëritjen e fëmijëve.

R.4 28 familje kanë përfituar nga shërbimet e integruara. Shërbime të integruara përfshijnë fuqizimin individual, ekonomik dhe administrativ ku përmendim, asistencë dhe shoqërim i familjeve në institucione arsimore, shëndetësore, shoqërore për të përfituar nga shërbimet e nevojshme, ofrim i mbështetjes psikologjike për prindërit dhe fëmijët në mjedisin e SHMFF apo në familje, ofrimi i asistencës për prindërit gjatë plotësimit të dokumentacionit për bonus qeraje dhe ndjekja e procedurave në vijim, asistencë në mbledhjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe aplikimin për përfshirje në skemës së ndihmës ekonomike, ofrim i mbështetjes direkte me paketa ushqimore, higjieno sanitare dhe didaktike, ofrim i kujdestarisë në familje dhe në klasat e prindërimit etj.

R.5 Është bërë prezantimi i modelit të Kujdestarisë Alternative Profesioniste (KAP) me përfaqësues të institucioneve shtetërore, organizatave, administratorët e Rajoneve 1.2.3.4.5 dhe administratorët e njësive administrative Shushicë, Orikum , Qendër dhe Novoselë. Ndërkohë është vijuar puna me dy familje që plotësojnë kriteret për të ofruar kujdestarinë alternative dhe janë duke përfunduar dosjet e aplikimit.

Është ngritur në bashki Komisioni Multidisiplinar për Vlerësimin e Familjeve Kujdestare Alternative sipas Udhëzimit Nr.394, datë 9.5.2019.

DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE TURIZMIT

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit është përgjegjëse për mirëadministrimin e çdo çështje që lidhet me hartimin e planeve dhe programeve strategjike për qytetin e Vlorës, në fushën e zhvillimit ekonomik vendor dhe turizmit, nëpërmjet organizimit dhe përmirësimit të shërbimeve mbështetëse, informuese, promovuese dhe këshilluese për nxitjen dhe zhvillimin e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe rrjetit të tregtisë e tregjeve publike, hartimin e programeve të posaçme të nxitjes së zhvillimit ekonomik dhe ofrimit të informacionit dhe asistencës për investitorët e huaj. Kjo ka bërë që krahas promovimit që i bën turizmit ministria përkatëse dhe qeveria si dhe vetë operatorët turistik kontributi i Bashkisë të jetë i ndjeshëm në këtë drejtim. Pjesë e rëndësishme e këtij procesi është edhe evidentimi i statistikave përkatëse për treguesit e matjes së rritjes së treguesëve në këtë aktivitet ,disa nga të cilat janë;

Gjatë muajit Korrik 2022, numri i netë qëndrimeve gjithsej është rritur me 14,9 %, në krahasim me muajin Korrik 2021. Numri i netë qëndrimeve të vizitorëve rezident të cilët janë akomoduar në ka shënuar rritjen më të lartë me 41,2 %.

Në muajin Korrik 2022, numri më i lartë i netë qëndrimeve është realizuar:

- sipas rajoneve në “Rajonin e Jugut“ (34,4 %);
- sipas zonave të afërsisë me bregdetin në “Zonat Bregdetare” (84,1 %);
- sipas llojit të strukturave akomoduese në “Hotele dhe akomodime të ngjashme” (91,8 %);

Turistet e huaj qe kane vizituar vendin tone kane qene te ndryshem:

Rezident, 37,2 %; Kosovë (XK), 16,2 %; Poloni (PL), 6,3 %; Itali (IT), 4,3 %; Gjermani (DE), 4,3 %; Maqedonia e Veriut (MK), 4,0 %; Bota të pa specifikuar (ËRL_NAL), 27,7 %; Jo-rezident, 62,8 %

- Veprimtaritë Turistike Të Certifikuara Dhe Licensuara

Gjatë muajit Maj 2022 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka certifikuar struktura të reja, sipas kategorive : 10 “Hotel”; 1 “Motel” 2 “Fjetje dhe Mëngjes” dhe ka klasifikuar struktura akomoduese me 5 yje që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht “brand name”. Gjithashtu gjatë muajit Maj është certifikuar dhe një strukturë agroturizmi paraprake.

Gjatë muajit Maj, janë certifikuar dhe udhërrëfyes turistik, të cilët e çojnë në 326 numrin e udhërrëfyesve lokalë dhe kombëtare.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka pajisur me certifikat operatori I turizmit detar 5 subjekte deri në Maj 2022.

- Agjencit Turistike Dhe Operatorë Turistike Të Licensuara Nga Qkb

Gjatë muajit Maj janë licensuar 6 operator turistik dhe 5 agjenci udhëtimi nga Qendra Kombëtare e Bisnesit. Më poshtë gjeni tabelën me numrin e Agjencive dhe Operatorëve Turistik:

- Turizmi Kulturor Në lidhje me vizitorët në institucionet e kulturës për muajin Maj 2022 vihet re njëritje e numrit të vizitorëve. Kështu kjo rritje është 3 herë më shumë se viti 2021.

Më poshtë po japim tabelën e vizitueshmërisë së institucioneve të kulturës

EMËTIMI I INSTITUCIONIT	Janar - Maj 2022	Qershor 2022	Korrik 2022
-------------------------	------------------	--------------	-------------

MUZEU I PAVARSISË VLORE	541	161	349
KALAJA E KANINËS	242	120	190
PARKU ARKEOLOGJIK AMANTIA	269	50	25
PARKU ARKEOLOGJIK ORIKUM	470	127	109
KALAJA PORTOPALERMOS	1020	1650	3000

Nr i vizitoreve ne vlore gjatë vitit 2022 eshte mbi 250 mijë

Drejtoria e Infomacionit

Drejtoria e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun ka kryer në vijimësi detyrat bazuar në Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Administratës së Bashkisë dhe Ligjit Nr. 119/2014 “ Për të drejtën e informimit”.

Prej periudhës Janar - Dhjetor 2022, pranë Drejtorisë së Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun janë realizuar detyrat e mëposhtme:

Për Drejtorinë e Urbanistikës, janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, për planin e përgjithshëm vendor, kopje dokumentacioni të sistemit e-leje etj.

Për Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, për shpronësime, për vërtetime kufitarësh, për inventarin e pronave të paluajtshme.

Për Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, për leje transporti, për leje parkimi, për leje taksish, për rinovim leje karburanti, për zhvarrime, leje promocioni, autorizime të ndryshme. Janë marrë kërkesa të qytetarëve për bonus qiraje (subvencionimi i qirasë), për privatizim objekti, për banesat me kosto të ulët nga projekti i subvencionimit të interesave të kredive nga buxheti i shtetit, për sistemim ambjenti, për ndricim si dhe kërkesa për dokumentacion.

Për sa i përket programit për përfitimin e subvencionimit të qirasë dhe për banesat me kosto të ulët nga projekti i subvencionimit të interesave të kredive nga buxheti i shtetit është bërë njoftimi nga ana e Drejtorisë sonë në stendën e Bashkisë, në media dhe në faqen e ëeb-it.

Për Drejtorinë e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, për verifikim leje ndërtimi, për kopje dokumentacioni, ankesa për cënim prone, ndërtime pa leje.

Për Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion në lidhje me buxhetin, konfirmime dokumentesh.

Për Drejtorinë Juridike, janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion.

Për Drejtorinë e të Ardhurave Vendore janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, për rishikim të taksave vendore, për shfrytëzim të hapësirës publike përpara biznesit, dorëzim të fletëve të regjistrimit të subjekteve hoteliere.

Për Sektorin e pyjeve dhe kullotave, janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, për fragment harte si dhe autorizim për ndërhyrje në fondin pyjor.

Për Drejtorinë Burimeve Njerëzore, janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, për kopje dokumentacioni nga arkiva, aplikime për punësim dhe vërtetime.

Për Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social, janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, kërkesa dhe ankesa mbi ndihmën ekonomike.

Për Këshillin Bashkiak janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, për tituj nderi, për emërtim rruge .Për Rajonet janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacione të ndryshme dhe ankesa të ndryshme për hapje rruge, lirim hapësire dhe probleme infrastrukturore nëpër banesa.

Për Zyrën e Gjendjes Civile janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion.

Për Policinë Bashkiake janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion dhe kërkesë ankesa për cënim prone etj.

Për Drejtorinë e Emergjencave Civile janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion dhe kërkesa në raste fatkeqësish natyrore.

Për Drejtorinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi janë marrë kërkesa të qytetarëve për rinovim certifikate nga MZSH.

Eshtë ndjekur korrespondenca duke përpiluar konfirmime të shkresave të ardhura nga institucione të ndryshme si:

Zyra Përmbartimore Private, Publike, Shpallje të Gjykatave, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorive të Doganave, si dhe korrespondenca elektronike nëpërmjet sistemit të qarkullimit të dokumenteve të nënshkrimit elektronik (e-albania), për dokument shoqërues kundrejt institucionit.

Eshtë kryer shpallja dhe publikimi i akteve të ndryshme të institucionit, njoftime të drejtorive të ndryshme si shpronësime, njoftime vendim me gjobë, njoftime për mbledhjen e Këshillit, njoftime për konsultim publik, vendimet e Këshillit të Bashkisë si dhe akte të tjera me interes të gjerë publik etj.

Përsa i përket numrit të kërkesave të regjistruara në regjistrin e posaçëm, sipas ligjit Nr.119/2014 “ Për të drejtën e informimit” , të cilat publikohen dhe përditësohen cdo tre muaj në faqen zyrtare të Autoritetit Publik në rubrikën “ Transparenca” si dhe është implementuar regjistri elektronik i kërkesave për informacion, i cili është i aksesueshëm nga qytetarët për dërgim të kërkesave për informacion në portalin Pyet shtetin.al dhe që monitorohet cdo ditë nga ana e Drejtorisë është si më poshtë :

Për periudhën janar-dhjetor janë regjistruar kërkesa për informacion 28 (njëzetë e tetë) prej të cilave 17 (shtatëmbëdhjetë) kanë marrë përgjigje.

Përsa i përket numrit të kërkesë/ankesave të depozituara pranë Drejtorisë së Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun për periudhën kohore *Janar – Dhjetor* 2022 nga ana e qytetarëve është si më poshtë:

1. Në muajin Janar numri i kërkesave është 131 (njëqind e tridhjetë e një)
2. Në muajin Shkurt numri i kërkesave është 177 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë)
3. Në muajin Mars numri i kërkesave është 241 (dyqind e dyzet e një)
4. Në muajin Prill numri i kërkesave është 283 (dyqind e tetëdhjetë e tre)
5. Në muajin Maj numri i kërkesave është 228 (dyqind e njëzetë e tetë)
6. Në muajin Qershor numri i kërkesave është 185 (njëqind e tetëdhjetë e pesë)
7. Në muajin Korrik numri i kërkesave është 197 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë)
8. Në muajin Gusht numri i kërkesave është 205 (dyqind e pesë)
9. Në muajin Shtator numri i kërkesave është 229 (dyqind e njëzetë e nëntë)
10. Në muajin Tetor numri i kërkesave është 187 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë)
11. Në muajin Nëntor numri i kërkesave është 166 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë)
12. Në muajin Dhjetor numri i kërkesave është 152 (njëqind e pesëdhjetë e dy).

Numri total i kërkesave është 2381 (dymijë e treqind e tetëdhjetë e një) dhe numri total i përgjigjeve është 190 (njëqind e nëntëdhjetë).

Puna e vazhdueshme e Drejtorisë së Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun, është komunikimi me qytetarët dhe bashkëpunimi me të gjitha drejtoritë e Bashkisë Vlorë sipas problematikave për realizimin në kohë të kërkesave.

Referuar tabelave më lartë ku janë pasqyruar shpenzimet sipas çdo programi konstatohet se, edhe pse fondet financiare kanë qënë ne dispozicion disa tregues të shpenzimeve nuk janë realizuar sipas planifikimit fillestar. Kjo ka ndodhur për arsye të ndryshme objektive dhe subjektive por në shumë raste nuk është varur nga puna e Administratës së Bashkisë.

Ndër të tjera, trajtuam edhe më lartë është rrjedhojë e miratimit me vonesë të buxhetit të vitit 2022 gjë që ndikoi në vonesa në realizimin e të gjitha procedurave të prokurimit. Ndikim të rëndësishëm kishte edhe dështimi i procedurave të prokurimit për shka të ndryshimit të cmimeve në mënyrë të menjëhershme.

Kjo jo vetëm për bashkinë por edhe për njësitë në varësi sidomos për investimet nga grandit specifik si F.N.ZH, Uitja dhe kullimi, Arsimi, Shërbimi pyjor e tēj .Gjithashtu edhe një pjesë e fondeve të planifikuara sipas kërkesës së donatorëve për N.M.M nuk u përdorën pasi për arsye që nuk varehin nga Bashkia Land fill-i Serishtës nuk filloi nga puna.

Me subjektin e kontraktuar për shërbimin e pastrimit në qytetin e Vlorës janë bërë gjitha përpjekjet për të dakortësuar situacionet e punimeve sipas volumeve të punës të realizuara në fakt. Në fakt subjekti nuk ka pranuar me pretendimin se i ka kryer volumet e punës sips parashikimi në kontratë, madje i është drjtuar me kërkesë padi Gjykatën Administrative Vlorë proces i cili ka filluar dhe aktualisht është duke u zhvilluar. Kjo ka bërë që jo vetëm detyrimet e periudhës korrik-dhjetor 2022 por edhe muajtë e parë të vitit 2023 nuk janë paguar për shërbimin e pastrimit për qytetin e Vlores.

Në kushte të tilla në vijim kërkohet që nga ana jonë gjatë nënshkrimit të kontratve të sipërmarrjes të vlerësohen me përgjegjësi maksimale detyrimet e subjekteve të kontraktuara.

Nisur nga sa parashtruar më lartë Administrata e Bashkisë në vijim do të ketë parasysh që në planifikimin e të ardhurave të marrë në konsideratë të ardhurat e realizuara në fakt nga të gjitha burimet me qëllim që planifikimi i tyre të jetë sa më real. Ndërkohë për shpenzimet do të kryhet nja analizë më e detajuar me qëllim që ato të jenë efektive për ofrimin e shërbimeve në qytet. Veçanërisht vëmendje do ti kushtohet planifikimit të investimeve dhe realizimit në kohë të procedurave të prokurimit me qëllim që në të ardhmen të mundësohet realizimi i plotë i tyre. Në funksion të këtyre që trajtuam më lartë kërkohet që edhe vendimarrja e këshillit të jetë e tillë që procedurat përkatëse të miratohen në kohë pasi gjate vitit 2022 është konstatuar se kjo vendimarrje duhet të ishte më racionale.

Konceptoi: A.Veizaj Zv.Kryetare e Bashkisë

D.Zeraj Drejtor i D.F.B.K

S.Haxhiraj Drejtore D.J

A.Shiko Drejtore D.A.V

L.Brinja Drejtore D.B.Nj

Z.Selamani Drejtor D.I.Z.P

KRYETARI
Dritan LELI

SHQIPËRIË - REPUBLIKA E SHQIPËRIË - BASHKIA